**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE**

**DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

# STRATEGJIA KOMBËTARE
# E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT

PRIORITETET E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË ZBATIM TË PLANIT TË VEPRIMIT

KONFERENCA E PARË MINISTRORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

LIGJI PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE

Tiranë, Shtator 2006

*Mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri*

# *Tabela e Lëndës*

Letër nga Koço Barka, Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
dhe Ambasadori Pavel Vacek, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ........ 04

**Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara** ........ 06

- *Kapitulli I* - Përcaktimet, Parimet dhe Objektivat ........ 08
- *Kapitulli II* - Analiza e Situatës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri ........ 12
- *Kapitulli III* - Kuadri Ligjor ........ 15
- *Kapitulli IV* - Fushat e Veprimit ........ 22
- *Kapitulli V* - Strukturat e Raportimit dhe Monitorimit ........ 28

**Plani Kombëtar i Veprimit** ........ 32

**Prioritetet e Institucioneve Shtetërore në zbatim të Planit të Veprimit** ........ 46

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ........ 48
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës ........ 54
- Ministria e Shëndetësisë ........ 59
- Ministria e Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit ........ 63
- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve ........ 65
- Ministria e Brendshme ........ 66
- Ministria e Drejtësisë ........ 70
- Bashkia Tiranë ........ 71
- Rekomandime ........ 74

**Konferenca e Parë Ministrore për Personat me Aftësi të Kufizuara** ........ 76
**Ligji për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore** ........ 87
**Falenderim** ........ 99

## Një Strategji për rritjen e shanseve dhe përmirësimin e jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara

Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, e plotësuar me prioritetet qeveritare, kurorëzon me sukses dialogun shumëvjeçar ndërsektorial midis shoqërisë civile dhe Qeverisë së Shqipërisë. Ky dialog, kishte si qëllim kryesor krijimin e besimit reciprok dhe ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët përkundrejt zbatimit të strategjisë së parë kombëtare në fushën e aftësive të kufizuara. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ishin në qendër të këtij procesi. Hartimi, rishikimi dhe aktualizimi i strategjisë u mbështetën nga Prezenca e OSBE në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara u hartua për të hedhur bazat e përmirësimit të jetës së personave me aftësi të kufizuara në fushën e kujdesit social dhe mjekësor, në fushën e arsimit, kulturës, sportit, punësimit, informimit, transportit, si dhe përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në jetën publike.

Dokumenti i Strategjisë, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave të datës 7 janar 2005, u hartua nga një grup pune ndërministror, i cili bashkëpunoi me një spektër të gjerë organizatash aktive në fushën e aftësisë së kufizuar. Prezenca e OSBE në Shqipëri, me kontributin e Komisionerit të Lartë për Çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara, të Republikës Federale të Gjermanisë, mundësoi konsulencën e nje eksperti gjerman gjatë procesit të hartimit të strategjisë.

Strategjia e Personave me Aftësi të Kufizuara është një platformë afatgjatë masash që synojnë përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Ajo reflekton parimet e njohura të barazisë, mosdiskriminimit, përfshirjes dhe vetëvendosjes së personave me aftësi të kufizuara dhe bazohet në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të OKB, Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social si dhe ligjet dhe strategjitë sektoriale për trajtimin e PAK.

Më 12 dhjetor 2005, Qeveria, i dha një shtysë të mëtejshme procesit të zbatimit të Strategjisë, nëpërmjet krijimit të Këshillit Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar. Krijimi i Këshillit Kombëtar përfaqëson një arritje madhore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. Këshilli Kombëtar drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe ka në përbërjen e tij Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, të Shëndetësisë, Drejtësisë, Turizmit, Transportit, Telekomunikacionit dhe Punëve Publike, si dhe Ministrin e Punëve të Brendshme. Pjesëmarrja në Këshill e përfaqësuesve të shoqërisë civile e shndërron atë në një model të bashkëpunimit midis shtetit dhe shoqërisë civile. Këshilli Kombëtar është një forum unik i cili mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në vendimmarrjen sektoriale.

Në kuadrin e Këshillit Kombëtar, ngritja e Sekretariatit Teknik për Aftësinë e Kufizuar në Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përbën një element të mëtejshëm, tejet të rëndësishëm, për zbatimin e Strategjisë. Sekretariati Teknik ka për detyrë monitorimin e progresit të objektivave të Strategjisë nga sektorët përgjegjës, mbledhjen e të dhënave në fushën e Aftësisë së Kufizuar, koordinimin e punës me pikat e kontaktit në ministritë e linjës, pushtetin vendor dhe me shoqërinë civile, si dhe mbështetjen e zbatimit të politikbërjes së Këshillit Kombëtar.

Ky botim i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara është plotësuar me prioritetet e qeverise sipas detajimit të planveprimit për vitin 2006. Ky plan veprimi i azhornuar bazohet në vlerësimin e zbatimit të Strategjisë përgjatë vitit 2005, i cili u mbështet nga OSBE. Plani i veprimit është një instrument i dobishëm për planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë në vazhdimësi. Natyrisht vendosmëria dhe vullneti për zbatimin e kësaj Strategjie do të përcaktojnë edhe kurorëzimin me sukses të saj.

Disa nga elementët e rinj që sjell Strategjia janë: kalimi gradual nga pagesat në kesh drejt ofrimit të mundësive të riaftësimit, formimit profesional dhe punësimit për personat me aftësi të kufizuara; transformimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime komunitare si në qendra ditore, shërbim në shtëpi, apo njësi shërbimesh të lëvizshme; përshtatja e infrastrukturës në funksion të jetesës pa barriera, etj. Këto elementë të Strategjisë synojnë përmirësimin e jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën e komunitetit dhe zhvillimin e tij.

Plani i Veprimit ngarkon me detyra dhe përgjegjësi konkrete ministritë, strukturat rajonale, si dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe parashikon rritjen e rolit të shoqërisë civile, si dhe përfshirjen e donatorëve, si partnerë dhe monitorues të zbatimit të kësaj Strategjie.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit që kontribuan në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe duke shpresuar për bashkëpunim të mëtejshëm në procesin e zbatimit të saj, paraqesim botimin e këtij dokumenti, i cili u mundësua nga Prezenca e OSBE në Shqipëri.

**Koço BARKA**
Ministër i Punës, Çështjeve Sociale
dhe Shanseve të Barabarta

**Pavel VACEK**
Ambasador
Kyetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE**

**DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

# STRATEGJIA KOMBËTARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Shtator 2006

# Kapitulli I
# Përcaktimet, Parimet dhe Objektivat

## Përcaktimi i ri i Aftësisë së Kufizuar

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara, me konceptin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara si dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), termi "person me handikap" është zëvendësuar me termin "Person me Aftësi të Kufizuara" (individualisht) dhe "Persona me Aftësi të Kufizuara" (në nivel shoqëror).

Që tani e tutje "Persona me Aftësi të Kufizuara" janë ata persona tek të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shume se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore.

Ky përcaktim, i cili i përmbahet propozimit të OBSH, nuk bazohet në mungesa reale apo të supozuara. Në qendër të vëmendjes vendoset pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Një ndryshim nga kushtet normale do të thotë humbje ose kufizime në lidhje me strukturat fizike, mendore apo psikologjike, të cilat janë të pranishme në moshën përkatëse. Aftësia e Kufizuar ekziston në rast se dëmtimi çon në një kufizim, i cili ndikon në pjesëmarrjen në një ose disa fusha të jetës. Kriteri i zgjatjes prej gjashtë muajsh të kufizimit përjashton parregullsitë e përkohshme, të cilat nuk konsiderohen si aftësi e kufizuar, por nuk përjashton ndërhyrjet e menjëhershme që janë të nevojshme në rastet individuale për shmangien e saj. Kjo ka të bëjë në veçanti me fëmijët, tek të cilët është verifikuar aftësia e kufizuar apo rreziku i mundshëm i aftësisë së kufizuar.

## Parimet Themelore të Strategjisë

*Parimi i të Drejtës Civile, Barazisë dhe Mosdiskriminimit* do të thotë që personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë; ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe llojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë; ata nuk duhet të diskriminohen në asnjë fushë të jetës shoqërore. Kjo përfshin ndihmën sociale që i lejon personat me aftësi të kufizuara të jetojnë me dinjitet. Nëse këto parime shkelen, do të ndërmerren veprime ligjore.

*Parimi i Vetëvendosjes* vjen nga përqasja me të drejtat civile dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara, duhet të ndërtohet. në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë të aftë të vendosin vetë. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale.

Ky parim gjithashtu parashikon që çdo masë në lidhje me rehabilitimin duhet të ndërmerret në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuar. Ai/ajo nuk duhet të trajtohet asnjëherë pa pëlqimin e tij/saj.

*Parimi i Përfshirjes, Pjesëmarrjes dhe Mundësive të Barabarta* thekson se personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë, ku ata jetojnë, prandaj nuk kanë pse të integrohen, sepse zotërojnë të njëjtat të drejta si njerëzit e tjerë. Ata kanë përfitime që i lejojnë ata të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku përfshihet rehabilitimi mjekësor, pjesëmarrja në jetën në komunitet dhe në punë. Jetesa pa pengesa është një kusht i rëndësishëm për pjesëmarrje.

*Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë* do të thotë që ndërtesat dhe shërbimet e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe vizuale të shërbimeve informative dhe të komunikimit dhe mjediset e tjera të krijuara konsiderohen pa pengesa (pa barriera), nëse ato zakonisht përdoren nga personat me aftësi të kufizuar, pa vështirësi të veçanta dhe si rregull pa ndihmën e të tjerëve.

*Parimet e Parandalimit, Identifikimit dhe Trajtimit të Hershëm* kanë të bëjnë me një numër masash që ndërmerren për të evituar sa të jetë e mundur shfaqjen e aftësisë së kufizuar dhe sëmundjeve kronike në të gjitha grupmoshat dhe në të gjitha fushat e jetës. Në këtë aspekt fusha me rëndësi janë mbrojtja e shëndetit, siguria në punë, parandalimi i aksidenteve dhe mbrojtja e mjedisit. Këto parime gjithashtu përfshijnë parandalimin e aftësisë së kufizuar përgjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet masave siç janë imunizimi etj. Kjo reflekton intuitën që sa më herët të identifikohet në fëmijëri një parregullsi, aq më i mirë dhe i shpejtë do të jetë parandalimi i aftësisë së kufizuar ose trajtimi i suksesshëm i saj. Kjo vlen për të gjitha grupmoshat.

*Parimi i Rehabilitimit* qëndron në bazë të procesit, i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ai ka të bëjë me masat që merren për parandalimin, mënjanimin, lehtësimin apo kompensimin e një aftësie të kufizuar, për parandalimin e përkeqësimit e saj, për nevojën për një kujdes afatgjatë dhe mundësimin e jetës normale për personat me aftësi të kufizuara.

*Parimi i Qëllimshmërisë* parashikon ndihmën që duhet t'i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuar dhe personave që kanë rrezik të bëhen të tillë, pavarësisht nga shkaku i aftësisë së tyre të kufizuar, edhe nëse përgjegjësia për këtë ndihmë mbahet nga fondet e dhëna nga institucione të ndryshme.

**Objektivat**

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara është të sigurojë një përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Standardet e OKB mbi Mundësitë e Barabarta.

*Objektivi 1: Inkurajimi dhe edukimi për një shoqëri që mundëson pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.*

- Të mundësohet që personat me aftësi të kufizuara të shërbejnë si specialistë në sektorët e tyre.
- Të njihen dhe të vlerësohen arritjet e personave me aftësi të kufizuara.
- Të përfshihen pikëpamjet e personave me aftësi të kufizuara në debatet etike dhe bioetike.
- Të inkurajohet debati i vazhdueshëm mbi çështjet e aftësisë së kufizuar në Shqipëri.

*Objektivi 2:Realizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.*

- Të sigurohet informacion i plotë për sa u përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet arsimimi i personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të njohin të drejtat e tyre, të njohin diskriminimin dhe të jenë avokatë të vetvetes.
- Të edukohen agjencitë përgjegjëse për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve, për të drejtat e prindërve me aftësi të kufizuara.

- Të rishikohet legjislacioni mbi të drejtat e njeriut në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e përmirësimit dhe forcimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.
- Të shqyrtohet, e nëse është e nevojshme, të mbështet përmirësimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Të shqyrtohet niveli i aksesit që kanë personat me aftësi të kufizuara për të pasur një mbrojtje të pavarur dhe të identifikohen mungesat në dispozitat e shërbimeve.
- Të vlerësohen arritjet e Shqipërisë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

*Objektivi 3: Sigurimi i arsimit optimal për personat me aftësi të kufizuara.*

- Të sigurohet që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për shkollë për arsye të aftësisë së kufizuar.
- Të mbështetet zhvillimi i komunikimit efikas duke krijuar mundësinë për arsimim në gjuhën e shenjave në shqip, teknologjitë e komunikimit dhe mjetet ndihmëse të komunikimit.
- Të mundësohet që mësuesit dhe edukatorët e tjerë të kuptojnë nevojat e mësimit nga studentët me aftësi të kufizuar.
- Të sigurohet që studentët me aftësi të kufizuara, familjet, mësuesit dhe edukatorët e tyre të kenë qasje të mjaftueshme në burimet e disponueshme në mënyrë që të mund të plotësojnë nevojat e tyre.
- Të përmirësohet përgjegjësia e shkollimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, të përmbushet detyrimi që ata kanë për nevojat e studentëve me aftësi të kufizuar.
- Të promovohet krijimi i një mjedisi arsimor të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që të plotësohen nevojat për arsimimin e PAK.

*Objektivi 4: Sigurimi i mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik për personat me aftësi të kufizuara.*

- Të sigurohet mundësi arsimimi dhe trajnimi i personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të rriten kapacitetet e tyre individuale për punësim.
- Të inkurajohen personat me aftësi të kufizuara për të parë mundësinë e trajnimit dhe të punësimit të tyre si dhe të marrin pjesë në zhvillimin e mundësive mbështetëse për të arritur këto qëllime.
- Të njihen punëdhënësit për mundësitë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet informacion për mundësitë e karrierës, mënyrave si të krijojnë të ardhura dhe për ndihmën e nevojshme që duhet t'u jepet personave me aftësi të kufizuara.
- Të shqyrtohen mundësitë e motivimit afatgjatë për të rritur mundësitë e trajnimit, punësimit dhe zhvillimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Të inkurajohet rritja e mundësive për punësim duke njohur nevojat e ndryshme të njerëzve me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të njëjtat kushte punësimi, të drejta dhe privilegje, si gjithë të tjerët, duke përfshirë dispozitat për pagesë minimale për punë me prodhimtari të krahasueshme.
- Të sigurohen shërbimet e komunikimit, burimet dhe mundësi për vende pune.
- Të inkurajohen organizatat që të zgjedhin persona me aftësi të kufizuara si anëtarë të tyre.
- Të sigurohet që nevojat e personave me aftësi të kufizuar të merren parasysh në zhvillimin më fleksibël të përfitimeve financiare, për të lehtësuar punësimin, trajnimin dhe formimin e tyre profesional.
- Të rishikohen dispozitat e mbështetjes financiare në mënyrë që të sigurohet një standard i pranueshëm jetese.

*Objektivi 5: Promovimi i një shërbimi publik të përgjegjshëm dhe transparent ndaj personave me aftësi të kufizuara*

- Të krijohen mekanizma për të siguruar që të gjitha politikat qeveritare dhe legjislacioni për PAK të jenë në përputhje me qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Të përshtatet sektori publik i trajnimit / formimit profesional në mënyrë që të sigurohet që zhvillimi dhe shpërndarja e shërbimit të jetë në përputhje më Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Të sigurohet që të gjitha agjencitë qeveritare t"i trajtojnë personat me aftësi të kufizuara me dinjitet dhe respekt.
- Të përmirësohet cilësia e informacionit që ekziston dhe të orientohen të interesuarit se ku mund të sigurojnë informacione e shërbime të tjera dhe si mund t'i përfitojnë ato.
- Të krijohet një sistemi i përshtatshëm për metodat e komunikimit dhe informacionit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që vendndodhja dhe ndërtesat e agjencive qeveritare dhe ato të shërbimeve publike të jenë të përdorshme prej tyre.

*Objektivi 6: Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara për një jetë cilësore në komunitet .*

- Rritja e mundësive të personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet duke pasur mundësi për zgjedhje cilësore banimi.
- Mbështetja e personave me aftësi të kufizuar që banojnë në zona rurale, për të jetuar në komunitetin e tyre duke u siguruar ofrimin e një shërbimi të përmirësuar.
- Mbështetje e zhvillimit të komunikimit të pavarur për personat me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që njerëzit e me aftësi te kufizuar të kenë akses në shërbimet shëndetësore brenda komunitetit të tyre.
- Të sigurohet transport publik i përdorshëm për PAK në mënyrë që të mënjanohen pengesat në lëvizjen e tyre.
- Të inkurajohet heqja e pengesave në ndërtime, në mënyrë që të lehtësohet lëvizja në ndërtesat, hapësirat publike dhe sistemet e transportit.

*Objektivi 7: Mbledhja dhe përdorimi i informacionit lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe çështjet e Aftësisë së Kufizuar.*

- Të nxitet dhe të krijohen mundësi për punë kërkimore duke marrë parasysh nevojën për studime mbi çështjet e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar në zhvillimin dhe monitorimin e kërkimeve mbi çështjen e aftësisë së kufizuar si dhe të nxiten personat me aftësi të kufizuara të paraqesin përvojat e tyre në kontekstin e këtij kërkimi.
- Të mblidhet informacion sa më i gjerë rreth aftësisë së kufizuar nëpërmjet vëzhgimeve dhe programeve kërkimore.
- Të realizohen dhe shfrytëzohen studimet mbi aftësinë e kufizuar dhe analiza e të dhënave mbi të për të përmirësuar politikat e punës, shërbimit, zhvillimit dhe monitorimit të situatës së saj në Shqipëri.

## Kapitulli II
## Analiza e Situatës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri

### Të dhënat statistikore

Të dhënat dhe njohuritë statistikore për pozitën e personave me aftësi të kufizuara janë të pakta. Aktualisht ato reduktohen në numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet kryesore të aftësive të kufizuara, të cilat vlerësohen dhe përcaktohen nga komisione të veçanta specialistësh, pagesat në para që jepen nga buxheti i shtetit, si dhe disa shërbime mbështetëse që ofrohen në qendra rezidenciale dhe në komunitet.

Aktualisht nuk ka të dhëna mbi strukturën gjinore të personave me aftësi të kufizuara, për aftësitë e kufizuara pas moshës së pensionit, të dhëna lidhur me situatën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Niveli i punësimit të PAK është tepër i ulët. Vetëm 2,275 nga 9,533 persona me aftësi të kufizuara të aftë për punë kanë pasur mundësinë e punësimit.

*Numri i personave me aftësi të kufizuara sipas kategorive:*

| **Lloji i PAK** | **Gjithësej** | **Qytet** | **Fshat** | **Kujdestarë** |
|---|---|---|---|---|
| **I. PAK të lindur ose të berë të tille deri në moshën 21 vjeç** | *44794* | *19669* | *25125* | *7288* |
| *a) mendorë, ndijorë, fizikë* | *35547* | *15166* | *20381* | *3593* |
| *b)të verbër* | *8621* | *4197* | *4424* | *3142* |
| *c) para dhe tetraplegjikë* | *626* | *306* | *320* | *553* |
| **II. Invalidet** | **30250** | **26274** | **3976** | **1462**[2] |
| *a) të punës* | *29676*[1] | *25904* | *3772* | *1500* |
| *b) të luftës* | *574* | *370* | *204* | |
| **Gjithsej** | **75044** | **45934** | **29101** | **8788** |

Aktualisht evidentohen 75,044 persona me aftësi të kufizuara[1]. Këtu përfshihen vetëm ata persona me aftësi të kufizuara që janë komisionuar dhe përbëjnë objekt përfitimi. Në fakt numri i personave me aftësi të kufizuara është më i lartë. Kështu në grupin e parë, përfshihen 44,794 persona që janë bërë të paaftë para moshës 21 vjeç dhe ky kufizim i aftësive nuk iu ka ardhur nga puna, sepse, sipas legjislacionit në fuqi, nuk trajtohen personat që janë bërë të tillë pas moshës 21 vjeç.

*Sipas shkakut të humbjes së aftësisë për punë:*

- 3,289 persona me aftësi të kufizuara janë të aksidentuar në punë apo me sëmundje profesionale, prej te cilëve 26,2% kanë humbur plotësisht aftësinë për punë, ndërsa 73,8 % kanë humbur pjesërisht aftësinë për punë.
- 26,378 persona kanë pësuar një aftësi të kufizuar për shkak të një sëmundjeje të përgjithshme.

1. Të dhënat janë marrë nga statistikat e 6-mujorit të parë të vitit 2003
2. 1462 invalidë që kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë një pagesë 15% të bazës së vlerësuar më shumë

*Sipas shkallës së humbjes së aftësisë për punë invalidët e punës ndahen :*

- 888 invalidë janë të paaftë dhe kanë nevojë për kujdestari,
- 14,527 invalidë janë te paaftë për punë,
- 9,533 invalidë kanë humbur pjesërisht aftësinë për punë,
- 4,728 invalidë të punës kanë plotësuar moshën per pension pleqërie, por në bazë të ligjit nr.7703, dt.11.05 1993 "Për Sigurimet Shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", neni 62, kanë përzgjedhur pensionin e invaliditetit, i cili i favorizon për përfitimet, që rrjedhin nga Statusi i Invalidit të Punës.

Krahas pensionit të invaliditetit dhe të të drejtave të përfitimeve nga Statusi i Invalidit, invalidët e punës përfitojnë edhe nga statuse të tjera. Kështu:

- 30,250 përfitojnë shtesë mbi pension nga Statusi i Invalidit (VKM nr. 204, dt 16.4.2004 "Për masën dhe kriteret për përfitimin e paaftësisë nga personat me statusin e invalidëve të punës" nga ose 9,812 ose 33,1% e numrit të tyre të përgjithshëm, që përfitonin nga VKM nr. 381, dt. 20 05.1996)
- 1,935 përfitojnë nga statusi i te verbrit.
- 258 përfitojnë nga Statusi i Paraplegjikut dhe Tetraplegjikut
- 328 janë të pajisur me mjete lëvizëse dhe përfitojnë rimbursim karburantesh.

Gjatë 10 vjetëve të fundit janë rritur pensionet e invaliditetit në qytet dhe më pak në fshat. Rritja e pensioneve të invaliditetit në qytet në raport me ato të fshatit, shpjegohet me përfshirjen në skemën e sigurimit të popullsisë rurale të aftë për punë. Periudha për të cilën ata paguajnë kontribute si bujq privatë njihet periudhë sigurimi në marrëdhënie pune me shtetin, e për rrjedhojë, pensioni i invaliditetit jepet nga puna në sektorin shtetëror.

**Rekomandime**

- Duhet të merren masa konkrete për mbledhjen e të dhënave të besueshme lidhur me numrin dhe tipologjitë e aftësisë së kufizuara në Shqipëri.
- Këto të dhëna duhet të jenë të ndara sipas gjinive.

**Vlerësimi i aftësisë së kufizuar**

Aftësia e kufizuar në Shqipëri vlerësohet nga komisione të veçanta të specializuara, në përbërje të të cilëve ka specialistë të disiplinave të ndryshme, si: mjekë pediatër, okulistë, psikiatër etj.
Komisionet që vlerësojnë PAK janë: Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, (KMCAP), Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë (KMPV). Këto komisione janë në varësinë e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (ISSH dhe SHSSH) dhe veprojnë në bazë të marrëveshjeve dhe rregulloreve te miratuara në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë është në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe realizon komisionimin e grupeve të personave me aftësi të kufizuara të ndarë sipas grupeve:

Grupi 1 janë personat me aftësi të kufizuara të lindur ose që janë bërë të tillë deri në moshën 21 vjeç;
Grupi 2 përfshin personat e aksidentuar, të sëmurë me sëmundje profesionale dhe të përgjithshme të bërë gjatë punës, kur kanë qenë të siguruar.
Një grup tjetër janë invalidët e luftës.

KMCAP vlerëson invalidët e punës me invaliditet të plotë, kur nga aksidenti ose shkaqe që lidhen me punën, kanë humbur me shumë se 67 % të aftësisë për punë dhe të pjesshëm, kur kjo humbje është 33%- 65%.

Kur personat me aftësi të kufizuara të të dy grupeve, sipas vlerësimit te Komisionit, nuk janë në gjendje të kujdesen për veten, ata kanë të drejtë te zgjedhin një kujdestar, i cili paguhet për shërbimet ndaj personit. Invalidët e paaftë për punë që kanë nevojë për kujdestar, përfitojnë vetëm shtesë mbi pensionin në masën 15% dhe nuk kanë të drejtë të zgjedhin kujdestar apo t'u paguhet kujdestar.

Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë ka degët e tij të lëvizshshme në 26 rrethe për të plotësuar nevojat për vlerësimin e grupeve me aftësi te kufizuar ne nivel lokal. KMCAP epror është i vendosur në Tiranë dhe shqyrton te gjitha ankesat e qytetareve për KMCAP lokale.

Personat me aftësi të kufizuara në shikim (të verbrit) vlerësohen nga një komision i veçantë, i cili vepron në Tiranë. Të verbrit përfitojnë pension sipas kontributit të derdhur gjatë viteve të punës, një pagesë të veçantë për shkak të verbërisë dhe mbështetjen me kujdestar, kur e kanë të nevojshëm, si dhe lehtësi të tjera në telekomunikacion.

Sipas aftësisë së kufizuar, PAK grupohen në:

- ndijorë, me AK dëgjimore dhe pamore;
- fizikë, persona me AK motore si paraplegjikët .
- mendorë, persona me çrregullime mendore ose sëmundje mendore kronike.

Ndonëse baza ligjore, statuset e veçanta etj. kanë krijuar mundësinë për të ofruar mbështetje në para apo shërbime, numri i PAK që përfitojnë trajtime mund të jetë më i lartë se sa ata që mbështeten nga programet sociale.

- ka përcaktime jo të plota për aftësinë e kufizuar,
- ka ende qëndrime dhe mentalitete nga ana e familjarëve për të mos i deklaruar PAK,
- ka mungesa në legjislacion dhe mos njohje të tij nga PAK ose familjarët e tyre, sidomos në zonat rurale dhe veçanërisht në zonat e thella,
- ka mjaft PAK që bëhen të tillë gjatë punës të pasiguruar, (puna e zezë)
- pensionistët nuk evidentohen në tërësinë e tyre nga komisionet.

**Rekomandime**

- Në bazë të parimit të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta dhe të vetëvendosjes kërkohet që mjediset e KMCAP duhet të sigurojnë hyrjen e lirë dhe pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet në përbërjen e KMCAP-së pjesëmarrja e një përfaqësuesi të shoqatave të PAK, si edhe e drejta e ankimimit.
- Personat e vlerësuar si PAK duhet të kenë të drejtën të njihen me dokumentacionin e vlerësimit të tyre. Ata kanë të drejtë të marrin fotokopjet e vlerësimit të tyre. Komisionet duhet t'u japin të gjithë informacionin e nevojshëm personave me AK, sipas natyrës së aftësisë së tyre të kufizuar (p.sh. të verbrit duhet të kenë mundësinë ta marrin dokumentacionin në shkrimin brail.)
- Duhet të merren masa për sensibilizimin e personave të vlerësuar lidhur me legjislacionin në fuqi dhe të drejtat e tyre.
- Vlerësimi i rregullt vjetor i aftësisë së kufizuar nuk duhet të përqendrohet më tepër se ç'është e nevojshme në aftësinë e kufizuar në vetvete dhe në aspektin mjekësor të saj, duke lënë mënjanë masat e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.

## Kapitulli III
## Kuadri Ligjor

Kuadri ligjor për përmirësimin e statusit shoqëror dhe ekonomik, i cili ka për qëllim të ofrojë garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, është duke u përmirësuar gradualisht. Kjo vjen si rezultat i ndikimit të vetë personave me aftësi të kufizuara, presionit të ushtruar nga grupet e komunitetet dhe organizatat që mbrojnë dhe përfaqësojnë të drejtat dhe interesat e tyre. Përmirësimi vjen gjithashtu si rezultat i rritjes së nivelit ekonomik të vendit dhe ndërgjegjësimit publik; ajo reflekton vullnetin e qeverisë shqiptare për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që t'i përfshijë ato në komunitetin ku ato jetojnë.

Mbështetja ekonomike e personat me aftësi të kufizuara ka ardhur duke u rritur. Në vitin 2003 buxheti për pagesën direkte për ta dhe për shërbimet në qendrat rezidenciale ka qenë 4.2 miliardë lekë, kurse për vitin 2004 buxheti për personat me aftësi të kufizuara kapi shifrën 4.7 miliardë lekë. Megjithatë, deri tani shërbimet që kanë pasur për qëllim rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara kanë qenë të pamjaftueshme dhe me karakter afatshkurtër. Pavarësisht nga arsyet ekonomike, fondet shtetërore që kanë mbuluar Aftësinë e Kufizuar kanë qenë modeste. OJF-të janë përpjekur të ofrojnë disa shërbime rehabilituese, si dhe tipologji të reja shërbimesh. Me gjithë përpjekjet e bëra, shërbimet e ofruara janë të shkëputura dhe jo të integruara.

Qeveria e Shqipërisë mbështet organizatat në shërbim të personave me aftësi të kufizuara dhe i konsideron ato palë në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore, politikave dhe programeve rreth këtij grupi.

Për më tepër Qeveria e Shqipërisë njeh domosdoshmërinë e reformave institucionale në funksion të zhvillimit të një sistemi përfshirës për Aftësinë e Kufizuar në mënyrë që legjislacioni në fuqi të marrë parasysh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kualifikimi dhe sensibilizimi i burimeve njerëzore përgjegjëse në qeveri është gjithashtu një çështje mbi të cilën autoritetet do të përqendrojnë vëmendjen dhe do të zhvillojnë projekte konkrete.

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë njeh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kështu Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 25 garanton të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara; në kreun V të Kushtetutës, ku parashtrohen Objektivat Sociale, në nenin 59, pika e) dhe pika f) nënvizohet "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private, synon: e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës."; neni 52, pika 1 nënvizon: "Kushdo ka te drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas nje sistemi të caktuar me ligj".

Personi që mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj".

Neni 49 mbi punësimin e barabartë parashikon: "Çdo njeri ka të drejtë të sigurojë jetesën nëpërmjet një punë të ligjshme që ai/ajo ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai/ajo është i/e lirë të zgjedhë profe-

sionin, pozicionin e punës dhe gjithashtu sistemin e kualifikimit për profesionin. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore". Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, sipas mundësive të tyre, parashikohet në statutet e grupeve të personave me aftësi të kufizuara, siç janë invalidët e punës, të verbrit, personat para dhe tetraplegjikë dhe aktet nënligjore që zbatohen për ta.

**Invalidët e punës**

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 "Mbi Statutin e Invalidëve të Punës", i ndryshuar më ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995 "Mbi disa ndryshime të ligjit nr. 7889", datë 14.12.1994 dhe Ligjin nr. 7821, datë 26.12.2000, ligji nr. 9143, datë 16.10.2003 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994".

Statuti i invalidit të punës parashikon shërbimet e mëposhtme:
100% rimbursim të trajtimit mjekësor për invalidët e plotë dhe 50% për ata që kanë humbur pjesërisht aftësinë për punë. Dispozita mbi mjetet lëvizëse parashikon përjashtimin e invalidëve nga taksat direkte dhe ato doganore për pajisje të ndryshme rehabilituese, duke përfshirë automjetet, shërbimi i transportit publik është falas, ndërsa transporti privat është 50% të vlerës.

Ligji parashikon kompensim të faturës së dritave dhe koston minimale për ushqim për personat me statusin e invaliditetit, të cilët kanë qenë të punësuar më parë. Pensioni i invaliditetit ka një pagesë shtesë prej 2000 ose 3000 lekësh për kategorinë e invaliditetit të pjesshëm ose të plotë dhe rimbursohet me 4000 lekë për karburantin.

Pension invaliditeti në fshat
Në rast se invalidi jeton në fshat, masa e pensionit është 2980 lekë + kompensim shtesën në shumën prej 200 lekë = Total:3180 lekë. Ky nivel përfitimi mbetet i njëjtë edhe kur personi me aftësi të kufizuara ndryshon vendbanimin.

**Veteranët e Luftës**

Ligji Nr. 7663 dt. 21.01.1993 "Për statusin e invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë" trajton me përfitime veteranët e luftës sipas grupeve te invaliditetit në varësi të pasojave të plagosjes apo gjymtimit.
Ata marrin shtesë pagese përveç pensionit të invaliditetit ose mesatares së pensionit të invaliditetit në rast se nuk kanë pension, që gjen zbatim sipas grupit të invaliditetit.

Invalidët e grupit të parë gëzojnë të drejtën për një përkujdesës, që paguhet nga strukturat e qeverisjes vendore. Përveç kësaj, ata marrin barna dhe trajtim mjekësor falas. Kur është e nevojshme, invalidët e luftës trajtohen në klinika jashtë vendit. Atyre u ofrohet transport urban falas dhe transport interurban me gjysëm çmimi.

**Të verbrit**

Ligji 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" rregullon vlerësimin e aftësisë për të parë, integrimin në jetën normale dhe parashtron kushte normale për jetesë dhe punë si dhe kushte favorizuese për trajtim mjekësor.

Përveç ligjit ekzistojnë: VKM Nr.227, datë 18.06.1997 "Për marrjen e statusit të të verbrit" për vlerësimin e aftësisë për të parë, VKM Nr. 671, datë 15.12.2000 "Për ngritjen e komisionit mjekësor të të verbërve" pranë SHSSH, VKM Nr. 83, datë 26.02.2001 "Për tarifat telefonike", për energjinë elektrike, VKM Nr. 632, datë 21.11.2001 "Për përfitimet nga enti kombëtar i banesave" japin trajtim të veçantë lidhur me strehimin, Udhëzime të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për trajtimin ekonomik dhe shërbimet.

Pagesa minimale për të verbrit është 6400 lekë. Aktualisht ka 8715 të verbër që marrin shërbimet e sipërpërmendura. Ata klasifikohen sipas shkallës së përfitimeve që marrin:

- 8235 të verbër përfitojnë 100% të pagesës për aftësi të kufizuar (6800 lekë)
- 408 të verbër përfitojnë 150% të pagesës për aftësi të kufizuar
- 45 të verbër përfitojnë 200% të pagesës për aftësi të kufizuar
- 27 të verbër përfitojnë 300% të pagesës për aftësi të kufizuar, kur vazhdojnë shkollat e larta.

Aktualisht, 3451 të verbër marrin kujdestar që paguhet me 6800 lekë në muaj.

Të verbrit marrin shërbimet e mëposhtme, që nuk varen nga të ardhurat familjare: transport urban falas, 50% ulje të transportit privat bashkë me kujdestarinë, tarifa telefonike të nivelit të parë dhe 700 impulse pa TVSh dhe duhet të paguajnë vetëm 20% të faturës mujore telefonike. Të verbrit përjashtohen nga taksat doganore për makinat e tyre dhe kur janë të vetë-punësuar, paguajnë vetëm gjysmën e taksave. Ata paguajnë vetëm 20% të faturës së energjisë elektrike në muaj. Grupi i parë përfiton falas 1 dhomë. Përshtatjet e mjedisit bëhen me fonde nga shteti.

Shteti po financon për ngritjen e një qendre për rehabilitimin e të verbërve. Në vitin 2003 dhe 2004 janë akorduar nga 10 milionë lekë për investim

**Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë**

Ligji Nr. 8626, dt 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe në zbatim të tij VKM Nr. 31, datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", VKM Nr. 83, datë 26.02.2001 "Për tarifat telefonike dhe energjisë elektrike", VKM Nr. 387 "Për përjashtimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga taksat dhe tarifat" dhe VKM Nr. 687, datë 15.12.2000 rregullojnë të gjitha përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara para dhe tetraplegjikë.

Nga Ligji Nr 8026 përfitojnë vetëm invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që vuajnë nga sëmundje të shpinës si pasojë e një aksidenti dhe rregullon vlerësimin e tyre nga komisionet mjekësore (KMCAP) si dhe trajtimin. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët që përfitojnë nga ky status janë invalidë të punës dhe si të tillë gëzojnë edhe të drejtat si invalidët e punës. Për rrjedhojë, këta persona marrin një pagesë shtesë prej 11 450 lekë në muaj. Pagesa totale mujore është 18 250 lekë. Për kujdestarët marrin 6 800 lekë në muaj.

Përfitojnë: mjekimet falas dhe shërbime në banesë, udhëtim falas me mjete shtetërore, 50% të biletës në mjetet private së bashku me kujdestarin.

Për trajtimin e paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve është parashikuar të sigurohen dhoma të veçanta, si dhe barna falas e shërbim në shtëpi. Tarifa favorizuese për telefonin dhe energjinë elektrike janë të krahasueshme me ato të të verbërve. Dispozita të mëtejshme rregullojnë përjashtimin e këtyre personave me aftësi të kufizuara nga 11 lloj taksash dhe nga taksat doganore për importimin e pajisjeve për përdorim vetjak. Gjithashtu ata marrin rimbursim të kostove për blerjen e karburantit ose vajit lubrifikant dhe përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar.

**Legjislacioni i ndihmës ekonomike dhe i shërbimeve të përkujdesit shoqëror**

Pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike që u jepet personave me aftësi të kufizuara fizike, mendore dhe ndijorë, të lindur ose që janë bërë të tillë nga aksidente deri në moshën 21 vjeç, të verbrit, invalidët e punës para- dhe tetraplegjikë rregullohet nga Ligji nr. 7710, dt. 18.05.1993 "Për

ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", dhe një sërë aktesh nënligjore, siç janë: VKM nr 307, datë 24.05.1994 "Për shërbimin e përkujdesit shoqëror", VKM nr. 311, datë 11.07.1994, VKM nr. 311, 11.7.1994 "Për përfitimin e paaftësisë" me disa ndryshime në VKM nr. 457, datë 21.8.1995 dhe VKM nr.304, datë 27.6.2002 dhe Udhëzimet e Ministrit të MPCS, VKM nr. 510, dt 24.11.1997 "Për kriteret e vendosjes në institucionet e përkujdesit shoqëror", VKM nr 786, 26.11.2003 "Për institucionet e përkujdesjes", si publike ashtu edhe private, si dhe për pagesën e nxënësve dhe studentëve me aftësi të kufizuar. Nxënësit e shkollave të mesme marrin 200% të pagesës minimale, studentët marrin 300%. Kujdestari merr 5000 lekë në rast se familja nuk ka të ardhura.

Në vend ekzistojnë 7 institucione rezidenciale publike, ku trajtohen rreth 1000 persona. Kostoja mesatare mujore për një person është 26000 lekë e siguruar nga fondet e buxhetit të shtetit. Veç këtyre institucioneve janë ngritur edhe nga OJF-të .

### Sistemi i sigurimeve shëndetësore

Ligji nr. 7880, dt. 13.10.1994 "Për sigurimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" mbron personat që kanë kontribuar në skemën e sigurimit shëndetësor përpara pësimit të aftësisë së kufizuar.

### Shëndeti mendor

Ligji nr. 8092, dt. 21.03.1996 "Për shëndetin mendor", mbron personat me aftësi të kufizuara mendore.

### Legjislacioni i Punësimit

Kodi i punës ndalon çdo lloj diskriminimi në punësimin dhe trajnimin profesional të njerëzve me aftësi të kufizuara. Ata kanë të drejtën të punojnë në punë të përshtatshme sipas vlerësimit të Komisionit Mjekësor të Vlerësimit që përcakton aftësinë e tyre për punë. Sipas Kodit të Punës, punëdhënësi duhet të ofrojë punë të përshtatshme dhe lehtësi për personat me aftësi të kufizuara. Orët e punës për personat me aftësi të kufizuara reduktohen në 6 orë në ditë.

Ligji nr. 7995, dt. 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", siguron dhe mbështet punësimin, këshillimin dhe kualifikimin profesional për personat me aftësi të kufizuara. Neni 15 parashikon që subjektet që kanë të punësuar 25 punonjës, një prej tyre duhet të jetë me aftësi të kufizuar në gjendje të punojë.

Punëdhënësi mund të zgjedhë të punësojë një person me gjendje të rënduar në vend të pesë personave me aftësi pjesërisht të kufizuara. Çdo punëdhënës, i cili nuk përmbush këto kuota punësimi për personat me aftësi të kufizuara, do t' i paguajë Fondit Kombëtar të Punësimit një shumë të barabartë me pagën minimale për çdo person me aftësi të kufizuara që duhet të kishte punësuar. Neni 16 parashikon elementë nxitës për punëdhënësit e personave me aftësi të kufizuara: "Punëdhënësi i personave me aftësi të kufizuara mund të kërkojë subvencione nga Zyra e Punës për pajisje të përshtatshme për personin me aftësi të kufizuara. Pagesa për njerëzit me aftësi të kufizuara përjashtohet nga tatimet siç përcaktohet nga Vendimet e Këshillit të Ministrave."

Neni 15 i këtij ligji, për arsye të ndryshme, nuk ka gjetur zbatim. Në vend mbizotërojnë bizneset e vogla me më pak se 25 punonjës, nuk ekzistojnë sanksionet dhe praktikat për zbatimin e duhur të ligjit në fjalë dhe deri tani nuk janë gjetur ende mekanizma alternativë. Gjithashtu, për zbatimin e ligjit është i nevojshëm sensibilizimi i shoqërisë, autoriteteve tatimore dhe punëdhënësve.
Janë bërë përpjekje për krijimin e bizneseve të mbrojtura për punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Organizuar nga OJF-të dhe mbështetur financiarisht nga Shteti, janë marrë disa nisma për

prodhimin e mjeteve të lëvizjes nga vetë njerëzit me aftësi të kufizuara. Ka disa nisma të suksesshme për punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuar dhe grupeve të tjera në nevojë; megjithatë duhet të sigurohet vazhdimësi në këtë drejtim dhe të promovohet punësimi për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji nr. 8872, dt. 29. 03. 2002, "Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë", përfshin rregulla për trajnimin dhe formimin profesional, dhe personat me aftësi të kufizuara janë ndër përfituesit kryesorë të këtij ligji. Personave me aftësi të kufizuara ky ligj u siguron mundësinë e përgatitjes profesionale falas në qendrat publike dhe me pagesë në kurset private.

**Arsimimi**

Ligji nr. 7952 "Për sistemin arsimor parauniversitar", datë 21.06.1995, njeh të drejtën për arsim për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga statusi i tyre social, kombësia, gjuha, gjinia, feja, raca, përkatësia politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik.
Ky ligj parashikon hapjen e shkollave ose klasave të posaçme si dhe kualifikimin e personelit për të punuar me persona me aftësi të kufizuara. Në këtë linjë, në Vlorë u hap një degë e posaçme për kualifikimin e personelit arsimor të specializuar. Personat me aftësi të kufizuara mund të studiojnë në shkolla normale, në klasa të posaçme pranë shkollave normale apo në shkolla të posaçme publike.

Institucionet speciale kombëtare përmbushin 80% të nevojave për këtë lloj shkollimi dhe në rrethe 2% për shkollim ditor. Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore publike është falas, nëse kjo është dëshira e prindërve dhe zgjedhja e duhur profesionale. Shteti ndërmerr masa për të garantuar kushtet e domosdoshme për integrimin gradual të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla normale. (Neni 40)

Aktualisht, 760 fëmijë ndjekin klasa të posaçme. Ekzistojnë dy institucione kryesore që mbulojnë nevojat e fëmijëve me humbje të shikimit dhe dëgjimit, që përmbushin afërsisht 80-90% të kërkesës. Sa për institucionet e tjera të specializuara, ato mbulojnë më pak se 2% të kërkesave për trajtim.

Ministria e Arsimit, në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, ka bërë punë të lavdërueshme në sensibilizimin e shkollave për të pranuar fëmijë me aftësi të kufizuar në klasa normale. Sidoqoftë, shkollave u mungon infrastruktura bazë dhe vetë mësuesit nuk kanë trajnimin e duhur për të mbështetur këtë proces.

**Transporti dhe jetesa pa barriera**

Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor", dhe Udhëzimi i Ministrit nr. 1649, datë 16.08.1999 sigurojnë lehtësi për njerëzit me aftësi të kufizuara në përdorimin e transportit. Ata gëzojnë të drejtën e përdorimit falas të transportit urban dhe çmime të reduktuara për transportin ndërurban.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 25.6.2004 "Për një shtesë në VKM nr 722, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së urbanistikës" ndihmon për të hequr barrierat për personat me aftësi të kufizuara. "Rregullat dhe normat urbanistike për personat me aftësi të kufizuara", përpunuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe organizatat e shoqërisë civile detyron me ligj që të gjitha aktivitetet ndërtuese të shmangin barrierat për njerëzit me aftësi të kufizuar.

**Rekomandime**

- Siç u përshkrua në këtë kapitull, kuadri ligjor lidhur me personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri është i shpërndarë. Lind nevoja e studimit të legjislacionit ekzistues dhe për të parë mundësinë e nxjerrjes së një ligj të unifikuar mbi statuset e veçanta të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë.

- Ky studim duhet të ndërmerret nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, si ministria kryesuese në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile për çështje të personave me aftësi të kufizuara.

- Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të informohen mbi të drejtat dhe privilegjet që gëzojnë. Qeveria dhe institucionet joqeveritare duhet të bashkohen për të koordinuar masat për ndërgjegjësimin e publikut dhe të botojnë vazhdimisht broshura informative, në të cilat të përmblidhen, në një gjuhë të kuptueshme, të gjitha të drejtat, pagesat, rimbursimet dhe shërbimet.

- Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Kartën e Rishikuar Sociale Evropiane, por ka lënë mënjanë ratifikimin e Nenit 15. Rekomandohet që, në këtë kontekst, të jepet një shenjë e qartë ndaj Këshillit të Evropës se Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka vullnetin për zbatimin e politikës së mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes.

***I. Pensioni mujor për Invaliditetin e plotë:***

| | |
|---|---|
| a. Nga një sëmundje e përgjithshme:<br>- masa e pensionit<br>- 5% të pensionit bazë për çdo fëmijë në ngarkim, por jo me shumë se 20% sipas ligjit nr. 7703, dt. 11.05.1993 (neni 39)<br>- kompensim për një person në ngarkim<br>- kompensim për energjinë elektrike<br>- për ndryshimin e çmimit të bukës<br>- shtesë paaftësie sipas VKM 204, dt.16.4.2004<br>• **Gjithsej** | 7266 lekë<br><br>1120 lekë<br>414 lekë<br>350 lekë<br>150 lekë<br>3000 lekë<br>**12 300lekë** |
| b. Nga një sëmundje profesionale apo aksident | 1**2300**lekë |
| c. Për invaliditetin e plotë nga një sëmundje e përgjithshme që ka nevoje për përkujdesje<br>Invalidi përfiton:<br>- masa e pensionit<br>- shtesë për përkujdesje<br>- kompensim për fëmijët në ngarkim<br>- kompensim për një person në ngarkim sipas VKM nr. 310, dt 24.04.1992<br>- kompensim për energjinë<br>- kompensim për çmimin e bukës<br>- shtesë sipas VKM nr.204<br>• **Gjithsej** | 7266 lekë<br>1600 lekë<br>1120 lekë<br>414 lekë<br>350 lekë<br>150 lekë<br>3000 lekë<br><br>**13 900 lekë** |

***II. Pensioni mujor për invaliditetin e pjesshëm***

| | |
|---|---|
| a. Për invaliditetin e pjesshëm nga sëmundje të përgjithshme (gr IV), invalidi përfiton sipas neni 37 këto të ardhura:<br>- masa e pensionit<br>- kompensimi i energjisë<br>- kompensimi i çmimit të bukës<br>- një person në ngarkim<br>• **Gjithsej** | 3633 lekë<br>350 lekë<br>150 lekë<br>414 lekë<br>**4547lekë** |
| b. Për invaliditetin e pjesshëm si rezultat i një aksidenti a sëmundjeje profesionale në punë invalidi përfiton edhe një shtesë sipas VKM 204, dt 16.4.2004<br>• **Gjithsej** | 4547 lekë<br>2000 lekë<br>**6547 lekë** |

## Kapitulli IV
## Fushat e Veprimit

Analiza e politikave aktuale në fushën e aftësisë së kufizuar në Shqipëri nxjerr në pah dy sfida kryesore:

1) Përmirësimin e politikave koherente, të cilat duhet të harmonizohen me standardet ndërkombëtare.
2) Zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Është e vetëkuptueshme se realizimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale në Shqipëri ka nevojë për një proces afatgjatë dhe shumëdimensional, suksesi i të cilit varet në masë të madhe nga përpjekjet e administratës shqiptare dhe të shoqërisë civile në Shqipëri.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë shpreh angazhimin e saj të plotë për të punuar në vazhdimësi përkundrejt dy sfidave kryesore të përmendura më lart, duke shprehur njëkohësisht gatishmërinë për të shfrytëzuar përvojën dhe kontributin e OJF-ve të këtij sektori.

Objektivi themelor i të gjithë këtyre politikave duhet të jetë përmirësimi i konsiderueshëm i kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet arritjes së rezultateve afatgjata në përfshirjen e tyre në shoqëri si qytetarë që ushtrojnë të drejtën e vetëvendosjes, dhe që gëzojnë të drejtat e plota civile dhe njerëzore.

Për këto arsye, Qeveria e Shqipërisë dhe përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara kanë vendosur të përqendrojnë përpjekjet e tyre në fushat primare të:

1) Përshtatshmërisë ndërtimore,
2) Shërbimeve për aftësinë e kufizuar,
3) Arsimimit, punësimit, trajnimit profesional,
4) Ngritjes së kapaciteteve,
5) Punës kërkimore dhe kuadrit ligjor.

Qëllimet dhe parimet e strategjisë të përshkruara në kapitullin II do të zbatohen në të gjitha politikat dhe projektet, duke vënë në plan të parë të drejtën e vetëvendosjes së personave me aftësi të kufizuara.

Rritja e përfshirjes shoqërore të personave me aftësi të kufizuara do të zhvillohet paralelisht me procesin e ndërgjegjësimit të shoqërisë, gjë që do të rezultojë në përfshirjen e të gjithë shoqërisë në këtë proces.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të një strukture efektive monitorimi dhe raportimi, e cila do t'u mundësojë të gjitha palëve të përfshira në proces, duke futur këtu edhe donatorët ndërkombëtarë, të matin progresin në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

### Jetesa pa barriera

Ndërtimi i një mjedisi pa barriera është padyshim një çështje kyçe për mundësitë e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët e jetës sociale, duke përfshirë integrimin e tyre në të gjitha fushat e arsimimit dhe punësimit.
Si Këshilli i Evropës, ashtu edhe Bashkimi Evropian vitet e fundit janë përqendruar mbi këtë çështje dhe përpjekjet e tyre kanë çuar në një sërë zgjidhjesh, duke përfshirë përkufizimet, standardet dhe masat për jetesën pa pengesa dhe projektim universal. Kombet e Bashkuara e kanë parashtruar gjithashtu këtë parim në rregullat standarde të Kombeve të Bashkuara.

Ndërtesat dhe mjediset e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe pamore të informacionit, lehtësitë e komunikimit dhe mjediset e tjera do të konsiderohen pa pengesa, nëse ato janë të arritshme dhe të shfrytëzueshme nga personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të zakonshme, pa vështirësi të veçanta, si rregull, pa ndihmë e të tjerëve.

Jeta pa pengesa është një parakusht për gëzim të plotë dhe të barabartë të të drejtave civile dhe për shfrytëzim të lirë të të gjitha shërbimeve në mënyrë të barabartë me të gjithë shtetasit e tjerë. Qeveria shqiptare dhe të gjitha palët e interesuara do të mbajnë parasysh këtë gjë në hartimin e legjislacionit të ardhshëm dhe standardeve për përshtatshmërinë e mjedisit.

Për rrjedhojë, heqja e pengesave pamore dhe fizike në jetën e përditshme të njerëzve me aftësi të kufizuara do të jetë vetëm një pikënisje. Përpjekjet e para për heqjen e barrierave për njerëzit me aftësi të kufizuar, siç u tha më sipër, tashmë janë ndërmarrë. Miratimi në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve në Rregulloren e Urbanistikës" është një hap i rëndësishëm.

Heqja e barrierave për personat me aftësi të kufizuara do të synojë:

1. Përfshirjen e tyre në jetën shoqërore, duke pasur parasysh kushtet aktuale të infrastrukturës publike në Shqipëri, e cila përbën pengesën më të madhe për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e përditshme, si dhe në pjesëmarrjen e tyre në arsimim, punësim dhe formim profesional.

2. Sjellja e personave me aftësi të kufizuara "në vëmendje" të shoqërisë të shihet si një faktor i rëndësishëm në procesin e rritjes së vetëdijësimit në shoqëri; ajo do të hedhë bazat për një ndjeshmëri më të madhe të ligjvënësve dhe të të mbarë shoqërisë.

Masat që do të merren[1]:

- Ndërtimi i strukturave për të mundësuar njerëzit me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në të gjithë sektorët e jetës sociale-ekonomike dhe kulturore. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pjesëmarrjes së tyre në jetën politike, veçanërisht në pjesëmarrjen në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore, meqë pjesëmarrja është një e drejtë e domosdoshme civile që e gëzojnë njerëzit me aftësi të kufizuara.
- Heqja e pengesave për informacionin, komunikimin dhe transportin si dhe vendosja e standardeve, duke mbajtur parasysh se e drejta për informim është një e drejtë legjitime publike e të gjithë shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Për rrjedhojë, njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë të drejtën të marrin informacionin për të gjitha shërbimet në shkrimin Brail, në gjuhën e shenjave ose në gjuhë të kuptueshme për ta.
- Çështjet e aftësisë së kufizuar të futen si një element i detyrueshëm në programet mësimore, si në profesionet arkitekturë, projektim-ndërtim-teknologji, media, shkenca sociale etj.

**Shërbimet**

Projekt-Ligji i ri "Për Ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore" që do të miratohet së shpejti në Kuvend, institucionalizon praktikat e përdorura në vendet e zhvilluara, në të cilët shërbimet sociale realizohen pranë komuniteteve dhe organizatat e shoqërisë civile ofrojnë një spektër të gjerë shërbimesh për personat me aftësi të kufizuara në nivel komuniteti. Pushteti vendor i kontrakton

1. Realizimi i masave jepet i detajuar në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ku institucionet përgjegjëse marrin detyrat, përgjegjësitë dhe afatet e tyre.

këto shërbime tek OJF-të e specializuara sektoriale dhe i kontrollon ato. Ky sistem hedh hapat e parë në Shqipëri, në sajë të angazhimit të administratës shtetërore, për shfryrjen e aparatit të nëpunësve buxhetorë me qëllim reduktimin e deficitit publik. Nga ana tjetër, ligji i ri për Ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore vë në pah vlerësimin e administratës shqiptare ndaj shërbimeve të ofruara nga organizatat e vetë personave me aftësi të kufizuara.

Sistemi i shërbimeve për aftësinë e kufizuar që po krijohet në Shqipëri është pasojë e zhvillimeve nëpër të cilat po kalon e gjithë shoqëria shqiptare. Sidoqoftë, do të vazhdojnë të mbeten përgjegjësi e Qeverisë politikat për ofrimin e të gjitha llojeve të shërbimeve shëndetësore. Për këtë arsye, autoritetet qendrore dhe vendore do të përcaktojnë prioritetet e veta për përmirësimin e sistemeve të parandalimit të hershëm të aftësisë së kufizuar, si dhe për përmirësimin e shërbimeve mjekësore dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara.

Në vendet e Evropës Perëndimore zhvillimet e fundit të politikave për aftësinë e kufizuar priren drejt përcaktimit të buxheteve individuale për personat me aftësi të kufizuara, të cilat u mundësojnë këtyre të fundit zgjedhjen e shërbimeve më të përshtatshme për ta.

Qeveria shqiptare do të synojë të ndjekë këtë objektiv, i cili bazohet në realizimin e parimit të vetëvendosjes. Megjithatë, situata ekonomike e pjesës më të madhe të familjeve të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri bart me vete rrezikun e përdorimit të parave të këtyre buxheteve individuale për aftësinë e kufizuar jo në drejtim të blerjes së shërbimeve të nevojshme, por në drejtim të plotësimit të buxhetit bazë të familjes. Për këtë arsye, në kuadrin afatmesëm dhe afatshkurtër, prioritet i qeverisë do të jetë dhënia e shërbimeve të kualifikuara duke pasur gjithnjë parasysh nevojat e vetë personave me aftësi të kufizuara.Qeveria shqiptare dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara do t'i kushtojnë rëndësi të veçantë dhënies së shërbimeve të kujdestarisë në nivel komuniteti. Garantimi i nivelit të lartë të këtyre shërbimeve do të jetë një çështje e cila do të trajtohet me përgjegjësi. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën të vendosin lidhur me kujdestarinë e përshtatshme për ta, ndonëse në legjislacionin e sotëm theksohet se kujdestari zgjidhet prej tyre.

Rëndësi e veçantë do t"i jepet krijimit të qendrave ditore me baza komunitare dhe shërbimeve nëpër shtëpi, të cilat me kalimin e kohës do të jenë llojet më të përdorura të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Shërbimet sociale cilësore do të vendosen në fokus të përpjekjeve për zbatimin e kësaj strategjie. Në nivelin vendor do të synohet krijimi i qendrave të shërbimit social komunitar, të cilat do të realizojnë shërbime këshillimi, kujdestarie, rehabilitim dhe integrimi, ku personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre do t'u ofrohet këshillimi lidhur nevojat individuale dhe ndërdisiplinore të tyre dhe në të ardhmen personat me aftësi të kufizuara të trajtohen nëpërmjet planeve individuale të rehabilitimit dhe pjesëmarrjes.

Personeli i qendrave të ardhshme të ofrimit të shërbimeve social duhet të jetë i kualifikuar në fushën e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara dhe me formim ndërdisiplinor. Koncepti i krijimit të një rrjeti kombëtar qendrash shërbimi social është në thelb të kësaj strategjie. Gjithashtu merret parasysh ideja e krijimit të njësive të lëvizshme, të cilat do të plotësojnë nevojat personave me aftësi të kufizuara në zonat rurale. Ndërtesat e këtyre qendrave duhet të ndodhen në afërsi apo brenda ndërtesave të komunave. Duhet

të ndërmerren masat e nevojshme që të garantohet përshtatshmëria ndërtimore e tyre.

Në bazë të filozofisë së dhënies së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara është që shërbimet duhet të ndjekin individin dhe jo e kundërta. Aktualisht kjo filozofi e shërbimit përdoret nga disa shoqata të aftësisë së kufizuar me rezultate të mira. Iniciativa shtetërore nuk duhet t'i zëvendësojë këto lloj shërbimesh, por t'i plotësojë dhe t'i përmirësojë ato. Gjatë krijimit të qendrave të shërbimit, rëndësi e veçantë i duhet dhënë punësimit të personave me aftësi të kufizuara në këto qendra.

**Punësimi**

Papunësia tek njerëzit me aftësi të kufizuara në Shqipëri konsiderohet si një prej problemeve të tyre kryesore. Njerëzit me aftësi të kufizuara rrallëherë shohin mundësi të fitojnë vetë jetesën e tyre dhe të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Nevoja për integrimin e tyre pa kompromis të në sferën e punësimit është në përputhje të plotë me përparësitë e vendosura nga Bashkimi Evropian: Plani i Veprimit i Komisionit Evropian për promovimin e mundësive të barabarta dhe luftën kundër diskriminimit vendos një theks të veçantë mbi punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara në vitin 2003. Vendet e punës duhet të parashikohen pa pengesa dhe duhet të përshtaten në përputhje me nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara. Ata duhet të mbështeten edhe për ngritjen e biznesit të tyre.

Pavarësisht nga Ligji Nr. 7995 "Për nxitjen e punësimit" datë 20.09.1995, duhet të bëhen përpjekje më efektive për të integruar njerëzit me aftësi të kufizuara në tregun e punës. OJF-të duhet të luajnë rolin e tyre dhe duhet të marrin mbështetje jo vetëm nga donatorët, por edhe nga vetë Qeveria Shqiptare. Kjo ka nisur tashmë nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, që mbështet disa projekte punësimi të OJF-ve.

OJF-të shqiptare që punojnë me aftësinë e kufizuar kanë kontribuar deri tani në mënyrë të konsiderueshme me ekspertizën e tyre për të trajnuar njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për të mbështetur integrimin e tyre në tregun e punës. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se ndërtimi i kapaciteteve në institucionet shtetërore duhet të ketë për synim mbështetjen e mundësive, që Agjensia Shtetërore e Punësimit të jetë më efikase në sjelljen e njerëzve me aftësi të kufizuara në forma të hapura ose alternative të punësimit. Madje, Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të krijonte një bashkëpunim më të ngushtë me OJF-të që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale duhet të marrë masa konkrete për të siguruar zbatimin efektiv të Ligjit ekzistues "Për nxitjen e punësimit."

Meqë vetë njerëzit me aftësi të kufizuara shpesh kanë mangësi në kualifikim dhe mjeshtëri, si pasojë e përjashtimit nga sistemi i arsimimit dhe i përgatitjes profesionale, është e rëndësishme të bëhen përpjekje më të madha në këtë sektor, duke u nisur nga kopshtet, duke vijuar me të gjitha nivelet e shkollimit universitar dhe përgatitjen profesionale, duke mundësuar njerëzit me aftësi të kufizuar të ndërtojnë kapacitetin e tyre në mënyrë të barabartë.

OJF-të duhet të mbështeten më shumë nga Qeveria në përpjekjet e tyre për të ofruar trajnim profesional për njerëzit me aftësi të kufizuar, por vetë qeveria shqiptare është gjithashtu e vetëdijshme për detyrimin për të ofruar trajnim profesional për njerëzit me aftësi të kufizuar në programet e tyre të trajnimit.

Synimi është krijimi i një sistemi të integruar kopshtesh dhe shkollash të nivelit fillor dhe të mesëm. Ministria e Arsimit është duke punuar tashmë për një politikë në vijueshmëri mbi arsimimin inte-

grues, duke përmirësuar kurrikulat shkollore, duke ngritur klasat e integruara deri duke përfshirë mënjanimin e pengesave dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore.

Heqja e pengesave fizike në shkolla, universitete dhe qendra të trajnimit profesional është një hap i rëndësishëm, por ai përbën thjesht një parakusht të domosdoshëm për zbatimin e konceptit të integrimit në procesin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimimit, studimit dhe trajnimit. Duke pasur parasysh gjendjen e arsimit në Shqipëri, një sistem miks i shkollave të integruara dhe shkollave të posaçme, do të konsiderohej zgjidhja më e mirë afatshkurtër. Si qeveria shqiptare ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile duhet të bashkëpunojnë ngushtë për ndërtimin e një sistemi arsimor, ku shkollat e integruara do të përbëjnë normën e arsimimit të PAK.

Nevojat e veçanta të të gjithë kategorive të njerëzve me aftësi të kufizuar do të plotësohen në klasa të veçanta në këto shkolla vetëm kur konsiderohet e nevojshme. Jeta sociale në vetvete dhe të gjitha veprimtaritë kulturore do të duhet të zhvillohen mbi baza të integruara. Për të ngritur nivelin e personelit që punon në fushën e aftësisë së kufizuar, një objektiv madhor duhet të jetë edhe hartimi dhe zbatimi i programeve për mësues të shkollave, mjekë, arkitektë, punonjës socialë, psikologë, etj., ku të përfshihen njohuri për Aftësinë e kufizuar.

Ligji i përmendur është një përpjekje e lavdërueshme, që parashikon që nga 25 punonjës, 1 duhet të jetë person me aftësi të kufizuar në gjendje të punojë. Sidoqoftë, pas këtij ndryshimi në vitet '90 të, ndërmarrjet e mëdha pothuajse pushuan së ekzistuari dhe bizneset e vogla normalisht kanë më pak se 25 punonjës.

**Ngritja e Kapaciteteve**

Ngritja e kapaciteteve në fushën e aftësisë së kufizuar është pika e mëtejshme kyçe e kësaj strategjie. Njohuritë e punonjësve të administratës shqiptare lidhur me legjislacionin në fuqi mbi aftësinë e kufizuar janë fragmentare. Nga ana tjetër, edhe në OJF-të e aftësisë së kufizuar ka mungesa njohurish mbi legjislacionin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Për arritjen e këtij qëllimi është i nevojshëm realizimi i një sërë trajnimesh dhe shkëmbim përvojash nga praktikat e mira të punës të vendeve të tjera. Ekziston nevoja e konsultimit me ekspertë nga vendet me përvoja të përparuara në fushën e politikave të aftësisë së kufizuar.

Strategjia përcakton nevojën e trajnimit të kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimit ndaj tyre. Projektet e përfshira në planin afatshkurtër i veprimit të kësaj strategjie përfshijnë trajnime për avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me aspektet ligjore të aftësisë së kufizuar.

**Kuadri ligjor dhe puna kërkimore**

Në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor lidhur me personat me aftësi të kufizuara, i cili rregullon komisionimin dhe legjislacionin mbi pagesat, të drejtat dhe shërbimet e tyre. Megjithatë, analiza e situatës aktuale ka treguar se legjislacioni ka natyrë fragmentare, gjë që kushtëzon mungesën e njohurive të plota mbi të si në nivel shtetëror, ashtu edhe midis vetë personave me aftësi të kufizuara.

Për këtë arsye, zhvillimi i një kuadri ligjor koherent lidhur me aftësitë e kufizuara është njëri nga prioritetet e kësaj strategjie.

Me qëllim harmonizimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare bazuar në parimet e parashtruara në kapitullin 1, ekziston nevoja e një studimi të përgjithshëm të kuadrit ekzistues legjislativ, statistikor dhe institucional.
Për të njohur personat me aftësi të kufizuara me të drejtat e tyre, struktruat shtetërore, të përfshira në \ këtë strategji, në bashkëpunim me OJF-të e aftësisë së kufizuar të publikojnë herë pas here në broshura, të gjitha shërbimet, të drejtat ligjore dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht nga projektet e renditura në vijim sipas fushave të ndërhyrjes, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të japë shenja të qarta përkundrejt komunitetit ndërkombëtar, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian duke pohuar qëllimin e saj për zbatimin e një politike të avancuar mosdiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufizuar, në kuadër të së cilës ajo do të:

- Ratifikojë nenin 15 të Kartës së Rishikuar Sociale Evropiane (RESC).
- Krijojë një kuadër të qëndrueshëm ligjor duke vendosur parimin e mosdiskriminimit të PAK në përputhje me Kushtetutën shqiptare. Gjithashtu, në bashkëpunim me shoqërinë civile të studiohet legjislacioni ekzistues dhe të synohet hartimi i një ligji shqiptar mbi mundësitë e barabarta, sa më parë që të jetë e mundur.
- Bashkëpunojë në mënyrë aktive në procesin në zhvillim e sipër të hartimit të Konventës së Përgjithshme dhe Integrale të OKB mbi mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë komunikimin me vendet anëtare të BE.
- Shkëmbejë në mënyrë të vazhduar përvojat me OJF-të sektoriale të aftësisë së kufizuar, me anë të konsultimeve midis tyre, ministrisë së linjës dhe MPJ lidhur me zhvillimet e konventës së OKB.

## Kapitulli V
## Struktura e Monitorimit dhe Raportimit

### 1. Këshilli Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar:

(Ngritur me Urdhërin e Kryeministrit nr. 196, dt. 12.12.2005)

**Anëtarët:**

Zëvendëskryeministri (Kryetar i Këshillit)

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Brendshem

Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë, i Shoqatës Kombëtare të të Verbërve të Shqipërisë, i Shoqatës Kombëtare të Invalidëve Para e Tetraplegjikë, dhe i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e PAK.

**Shpeshtësia e takimeve**

(sipas mandatit të Këshillit Kombëtar): të paktën 3 herë në vit

**Detyrat:**

- Politikëbërja e për Aftësinë e Kufizuar në nivel kombëtar, bazuar në Plan-Veprimin e Strategjisë.
- Garantimi i përfshirjes së dimensionit të Aftësisë së Kufizuar në politikat e institucioneve.
- Rekomandime për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me Aftësinë e Kufizuar.
- Hartimi i raportit përmbledhës mbi gjendjen e Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri [1]

**Nevojat:** Hartimi i statutit të Këshillit Kombëtar

---

1 Raporti i dorëzohet Kuvendit të Shqipërisë si organi më i lartë i përfaqësimit demokratik në vend. Raporti publikohet dhe u dërgohet të gjitha institucioneve qeverisëse dhe joqeveritare në Shqipëri, si edhe donatorëve ndërkombëtarë. Gjatë 3 viteve të para të zbatimit të strategjisë raporti jepet çdo vit. Më pas raporti jepet çdo dy vjet.

**2. Sekretariati Teknik:**

(Ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr. 40, dt. 23.03.2006)

**Anëtarët:**

Tre të punësuar me kohë të plotë pranë strukturave të MPÇSSHB, drejtuesi i Sekretariatit është person me aftësi të kufizuara

**Autoriteti i linjës:**

Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta

**Në varësi:**

Koordinatorët e ministrive

**Nevojat:**

Përshkrimet e punës, Statuti, Mandati, dhe Rregullorja e punës së sekretariatit teknik.

Ngritje kapacitetesh:

- Në të gjitha aspektet e aftësisë së kufizuar me theks mbi shërbimet dhe zgjidhjet ligjore, përshtatshmërinë mjedisore, punësimin, arsimimin dhe kualifikimin profesional për AK
- Menaxhimin e projekteve, menaxhimin e zyrës, menaxhimin e teknologjisë së informacionit.

**Detyrat:**

- Mbledhja e informacionit nga ministritë e linjës, njësitë vendore, qarku / bashkitë / komunat, përpunimi dhe shpërndarja e informacionit
- Mbajtja e marrëdhënieve me pikat e kontaktit nëpër ministritë e linjës
- Mbajtja e marrëdhënieve me OJF-të e AK të përfaqësuara në Këshillin Kombetar të Aftësisë së Kufizuar dhe Këshillin Administrativ të Shërbimit Social Shtetëror (SSSH)
- Mbajtja e marrëdhënieve me 12 zyrat rajonale të SSSH
- Përgatitja e takimeve të Këshillit Kombëtar dhe Këshillit Administrativ të SSSH
- Raportimi për Këshillin Administrativ të SSSH

### 3. Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror

**Anëtarët:**

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, (kryetar) Drejtori i Shërbimit Social Shtetëror (zëvendëskryetar) , Drejtori i ISSH, Drejtori i SHKP, Zv.Ministri i Brendshëm, (ish-qeverisjes vendore) zv.Ministri i MASH, përfaqësues i drejtorisë së buxhetit i MF, përfaqësues nga Shoqatat e AK, i cili zgjidhet me votim nga rrjeti i shoqatave të AK.

**Në varësi:**

Sekretariati teknik, pikat e kontaktit në ministri

**Detyrat:**

- Mbikqyr zbatimin e Strategjisë Kombëtare
- I jep rekomandime Këshillit Kombëtar
- Jep direktivat e punës dhe përgjigjet për mbikqyrjen e punës së Sekretariatit teknik
- Jep direktivat e punës për 12 zyrat rajonale të SSSH
- Jep direktivat e punës për njësitë e pushtetit vendor

**Nevojat:**

Rregullore pune, rutina e mbledhjeve[2], procedurat e votimit[3], organizimi i përzgjedhjes së 3 OJQ-ve që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar[4]; procedurat dhe praktikat e raportimit në Këshillin Kombëtar[5].

### 4.Pikat e Kontaktit në Ministritë e Linjës

**Anëtarët:** Një person i përzgjedhur si pikë kontakti nëpër ministritë e mëposhtme: MASH, MSH, MD, MTKRS, MPPTT, MB.

**Autoriteti i linjës:** Sekretariati teknik

**Në varësi:** Sipas VKM të gjithë departamentet e ministrive përkatëse

**Nevojat:**

- Kritere për përzgjedhjen, hartimi i përshkrimit të punës
- Ngritje kapacitetesh:
- Në fushën e aftësisë së kufizuar që prek punën në ministrinë përkatëse
- Menaxhimin e projekteve, Menaxhimin e zyrës, Menaxhimin e teknologjisë së informacionit

---

**2.** Raportimi realizohet në mënyrë të rregullt çdo dy muaj të paktën 10 ditë përpara mbledhjes së Këshillit Administrativ.

**3.** Gjatë dy viteve të para të zbatimit të Strategjisë, Këshilli Administrativ mblidhet 6 herë në vit. Pas dy vitesh, Këshilli ka të drejtë të rishikojë rutinën e mbledhjeve. Këshilli Administrativ duhet të mblidhet 3 javë përpara mbledhjes së Këshillit Kombëtar.

**4.** Institucionet qeveritare dhe ato joqeveritare të përfaqësuara në Këshill kanë të drejtë vote. Çdo institucion ka të drejtën e një vote

**5.** OJQ-të rajonale duhet të jenë OJQ që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të merren me aftësinë e kufizuar në mënyrë ndërsektoriale dhe të kenë një përvojë pune jo më pak se 5-vjeçare në fushën e aftësisë së kufizuar.

**Detyrat:**

- Informon sekretariatin teknik
- Informon zëvendësministrin përkatës në Këshillin Administrativ të SSSH
- Mban kontakte me njësitë e pushtetit lokal nën vartësi të ministrisë
- Mban kontakte pune me OJQ-të e përfaqësuara në Këshillin Administrativ

**5. Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror**

**Anëtarët:** Stafi i zyrave rajonale, 1 person nga qendrat e shërbimit social per PAK.

**Nevojat :**

- Kriteret e përzgjedhjes, Përshkrimet e Punës
- Ngritje kapacitetesh
- Në fushën e AK
- Menaxhim Projektesh
- Menaxhim Zyre
- Teknologji Informacioni

**Detyrat:**

- Zbatimi i Strategjisë në nivel rajonal
- Dhënia e shërbimeve për PAK (sipas programit të SSSH)
- Administrimi i pagesave për PAK
- Raportimi i rregullt për Sekretariatin Teknik dhe ministrisë përkatëse të linjës

**6. Njësitë e Pushtetit Vendor**

**Anëtarët:** 12 Qarqet, 36 Bashki, 373 Komuna: 1 pikë kontakti për AK
**Varësi linje:** Zyrat rajonale të SSSH, Pikat e kontaktit në Ministri, Sekretariati Teknik
**Nevojat:** Kritere përzgjedhjeje dhe përshkrime pune

**Ngritje kapacitetesh:**

- Në të gjitha aspektet e aftësisë së kufizuar me theks mbi shërbimet dhe zgjidhjet ligjore, përshtatshmërinë mjedisore, punësimin, arsimimin dhe kualifikimin profesional për AK, menaxhimin e projekteve, zyrës dhe kontakteve, menaxhimin e teknologjisë së informacionit

**Detyrat:**

- Zbatimi i Strategjisë
- Raportimi tek zyrat rajonale të SSSH
- Kujdesi për publikun dhe orientimi i tij
- Mbledhje të rregullta konsultative me OJQ-të e PAK

## *Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara*

- *Jetesa pa barriera*
- *Shërbimet*
- *Arsimimi, punësimi dhe kualifikimi profesional*
- *Ngritja e kapaciteteve*
- *Legjislacioni dhe puna kërkimore*

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| ***I. Përshtatshmëria e mjedisit*** | | | | |
| 1. Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike e të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1. Të zbatohen parametrat e përshtatshmërisë në 10% të apartamenteve të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit nga Enti Kombëtar i Banesave. | 2005 - 2007<br>2007 - 2014 (çdo vit) | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Në planifikimin e fondeve publike (infrastrukturë e objekte sociale - rrugë e mjedise publike, në insitucionet shëndetësore, në shërbimeve publike, në shkollat e të gjitha niveleve etj.) të përfshihen edhe fonde për elementë ndërtimorë që garantojnë heqjen e barrierave (nënkalime, panduse, ashensorë, vendqëndrime, parapete etj.) | 2007 - 2014 | MPPTT, Njësitë e PV, MSH, MASH, MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | a)Në planifikimin e fondeve publike (në infrastrukturë e objekte sociale) të përfshihen edhe fonde për elementë ndërtimorë që garantojnë heqjen e barrierave për projektin pilot "Tirana pa barriera". | 2005 - 2007 | MPPTT,<br>Bashkia e Tiranës | Buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë së Tiranës, donatorë |
| | b) Shtrirja e këtij projekti edhe ne bashkitë e tjera. | 2007 - 2015 | MPPTT, NJPV | Buxheti i shtetit, i NjPV, donatorë |
| | c) Përshtatja ndërtimore e mjediseve spitalore të Tiranës dhe pajisja e tyre me aksesorë lehtësues për PAK. 82.8 milionë lekë. | 2005 - 2010 | MSH | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë |
| | ç) Çdo spital në nivel rajonal apo bashkie të sigurojë dhe të kompletojë mjedise të përshtatura sipas standardeve europiane, për trajtimin e PAK. | 2005 - e në vazhdim | MSH, NJPV | Buxheti i shtetit, i NjPV, donatorë |
| | d) Përshtatshmëria e mjedisit të 8 Qendrave Publike të Formimit Profesional. | 2005 - 2007 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | e) Përshtatshmëria e mjediseve të 100 shkollave dhe 90 kopshteve. | 2004 - 2014 | MASH, NJPV,MB/NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, NJPV, donatorë, |
| | ë) Pershtatja e mjediseve publike, qendrave te votimit, etj., për të siguruar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të PAK në jetën shoqërore. | 2005 e në vazhdim | MB, NJPV | Buxheti i shtetit, i NJPV, OJF-ve, donatorë |
| | 1.3 Përshtatshmëria e mjeteve të transportit, duke filluar nga transporti urban në Tiranë dhe në në transportin hekurudhor. | 2006 e në vazhdim | MPPTT | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, |
| | 1.4 Sigurimi i sinjalistikës së përshtatur për persona me aftësi të kufizuar të pari dhe të dëgjuari. | 2007 e në vazhdim | MPPTT, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë |

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2.Të përdoren teknologjitë moderne për eleminimin gradual të barrirave informuese për personat me aftësi të kufizuara. | 2.1 T'i jepet mbështetje prodhimit të librave me zë dhe botimeve me brail si lloji bazë i literatures për të verbërit, duke përfshirë literature teknike, artistike dhe ligjore. | 2005 e në vazhdim | OJF, SHVSH | OJF, donatorë |
| | 2.2 Në të gjitha fushat e shërbimeve publike (gjatë trajtimit të çështjeve zyrtare), personave me aftësi të kufizuar t'u jepet akses në komunikimin e përditshëm. | 2005 e në vazhdim | OJF | OJF, donatorë |
| | 2.3 Të bashkëpunohet me median elektronike që emisionet informative të jepen edhe në gjuhën e shënjave. | 2005 e në vazhdim | OJF | Donatorë |
| ***II. Fusha e sherbimeve*** | | | | |
| 1.Të sigurohet parandalimi i AK, ne faza sa më të hershme, nëpërmjet diagnostikimit të hershëm, trajtimit të çrregullimeve emocionale dhe te sjelljes se femijëve 0-6 vjeç si dhe depistimit. | 1.1 Ngritja e ekipeve multidisiplinare për hartimin e programeve për parandalimin e hershëm të AK, identifikimin e hershëm të çrregullimeve emocionale e të sjelljes nëpërmjet depistimit të AK, vlerësimin dhe trajtimin (rehabilitim dhe riintegrim) e tyre.. | 2004-2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Ngritja e laboratorit të biokimisë molelukare dhe gjenetikës për diagnozën prenatale në spitalin obsetrik-gjinekologjik. | 2004-2005 | MSH | OJF, Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |
| | 1.3 Fuqizimi i laboratorit të gjenetikës mjekësore pranë departamentit të pediatrisë. | 2004 e vazhdimisht | MSH, ISKSH, shoqatat. | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |
| | 1.4 Studime, kërkime dhe masa për minimizimin e rrezikut të AK të lindur. Përgatitja e buletineve dhe materialeve me karakter divulgativ për mirërritjen e fëmijëve. | 2 herë në vit | MSH, MASH | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet perkatese publike e private i sherbimeve per PAK, ne perputhje me grupmoshat dhe nevojat per rehabilitim dhe integrim. | 2.1 Ngritje e shërbime të reja të përkujdesjes, si: ditore, në familje, strehëza, me synim që PAK të qëndrojnë sa më pranë mjedisit familjar ose në mjedise të ngjashme me familjen. | 2005 - 2006 e vazhdimisht | MPCS/SSHS, ISSH, NJPV, | Buxheti i shteti dhe i NJPV, donatorë, OJF |
| | 2.2 Pilotim i modeleve të reja të shërbimeve dhe vleresim i efektshmërise dhe shtrirjes së tipeve të ndryshme të shërbimeve per PAK. | 2004 (pilotim), 2007 | MPÇS/SHSSH, NJPV<br>MSH, NJPV, OJF, Bashkia e Tiranës | Buxheti i shtetit, B.B, donatorë, OJF,<br>Buxheti i NJPV, bashkia e Tiranës<br>Buxheti i shtetit, donatorë, BB, OJF |
| | 2.3 Hartim i rregulloreve dhe standardeve te shërbimeve për PAK, duke theksuar të drejtën e klientëve për të marrë shërbime të përshtatshme, respektimin e dinjitetit, ruajtjen e aftësive, etj. | 2004 - 2005 | MPÇS/SHSSH | Buxheti i shtetit, NJPV<br>Donatorë, OJF |
| | 2.4 Rishikim i kritereve dhe rregulloreve te institucioneve rezidenciale publike, për PAK dhe te moshuar, per te parashikuar masa për PAK të rëndë të cilëve nuk u sigurohet shërbimi pranë familjes. | 2005 - në vazhdimësi | MPÇS, NJV, OJF | Buxheti i NJPV |
| | 2.5 Të përcaktohen tarifa të diferencuara për shërbimet publike ndaj PAK. | 2005 - 2006 | NJPV | Buxheti i shtetit, NJPV, OJF, donatorë |
| | 2.5 Vendosja e shërbimit të këshillimit psiko-social në 36 shkolla dhe plotësimi i të gjitha shkollave me këtë shërbim. Plotësimi i shkollave me infrastrukturen e nevojshme per fëmijë me nevoja të veçanta. | 2004 - 2006 | MASH, Drejtorite Arsimore, OJF | Buxheti i shtetit, NJPV, OJF, donatorë |
| 3. Sigurim i mundësive territoriale, financiare dhe fizike për kujdesin mjekësor thelbësor për PAK në gjendje të rëndë | 3.1 Rishikim i sigurimit të mjeteve dhe medikamenteve mjekësore dhe shpërndarjes se tyre për PAK në gjendje të rëndë. Të përcaktohet dhe institucionalizohet një buxhet me vete për PAK. | 2004 - 2008 | MSH, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.2 Rishikim i kurrikulave të mjekut të familjes, në të cilat të përfshihen programe për PAK në gjendje të rëndë. | Cdo vit | MSH, ISKSH | Buxheti i shtetit, i ISKSH,donatorë |
| | 3.3 Percaktim i rrugëve dhe mjeteve për të mbuluar kostot shtesë për trajtimin mjekësor të PAK në gjendje të rëndë (sidomos ata me AK mendore). | Cdo vit | MSH, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |

***Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara***

| **Objektivat** | ***Masat*** | ***Afatet kohore*** | ***Institucioni zbatues*** | ***Mbulimi financiar*** |
|---|---|---|---|---|
| 4. Zbutja dhe riaftësimi i kufizimeve funksionale, fizike, psikike, sociale dhe ekonomike që vijnë nga aftësitë e kufizuara, aksidentet apo sëmundjet për të siguruar integrimin e PAK ne jeten e familjes dhe komunitetit. | 4.1 Hartimi dhe zbatimi i një program të qartë kombëtar për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve riaftësuese, për shtrirjen graduale në të gjithë territorin e vendit dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. | Sipas një plani të veçantë 2005 deri 2015 | MSH, MPÇS | MSH, donatorë, OJF |
| | 4.2 Krijimi dhe praktikimi i një sistemi akreditimi për ecurinë e qendrave të kujdesit të hershëm, qendrave rehabilituese, trainuese dhe ritrajnuese për secilin grup të personave me aftësi të kufizuara. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS | Buxheti i shtetit, i ISKSH, donatorë |
| | 4.3 Krijim i strukturave nga qendra në bazë, përfshirë dhe njesite vendore, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e sherbimeve te përshtatshme per ta. | 2005 e në vazhdim | MPÇS, MSH, MPVD NJPV, MASH | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |
| 5. Informimi i PAK, ekspertëve, kujdestarëve, personelit të shërbimit dhe familjarëve për pajisjet teknike dhe mjetet teknologjike që përdoren nga PAK dhe plotësimi i nevojave të tryre me këto mjete.. | 5.1 Sigurimi dhe plotësimi i PAK me pajisje standarde për AK dhe mjete kompesuese didaktike për fëmijë dhe nxënësit me AK në shkolla, qendra shërbimesh etj. | 2005 e në vazhdim | MPÇS, SHSSH, ISSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 5.2 Stimulim i botimit të broshurave me informacion për mjetet moderne në shërbim të PAK. Hapje e ekspozitave dhe panaireve me mjete per AK. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 5.3 Promovim i ngritjes dhe zhvillimit te qendrave të specializuara informuese dhe këshilluese, që merren me pajisjet teknike dhe përshtatjen e produkteve standarde mbi bazën e specializimit nga subjektet publike dhe jopublike. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| 6.Shpërndarja e shërbimeve nën kujdesin e njësive të qeverisjes vendore, sipas ligjit të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore, politikave sociale dhe nevojave të PAK. | 6.1 Të krijohen ose të përshtaten struktura nga qendra në bazë, duke përfshirë edhe organet e pushtetit vendor, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve sociale për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 6.2 Kujdestaria dhe kujdesi për një person të afërt të bëhet alternativa e vërtetë kundrejt kujdesit institucional për PAK të rëndë. Përgatitje dhe trainim i kujdestarëve per të verbrit dhe personat qe nuk dëgjojne. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 6.3 Të promovohet zhvillimi i qendrave të kujdesit të përkohshëm në mënyrë që të reduktohet kërkesa për kujdes rezidencial. | 2010 | MSH, MPCS, MASH, OJF, NJPV | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |

| Objektivat | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| ***III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe formimi profesional*** | | | | |
| 1. Përmirësimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për punësimin e PAK. | 1.1.Studimi i gjendjes së punësimit të PAK dhe punësimi i tyre në raport me nevojat e tregut të punës. | 2004 e në vazhdim | MPÇS | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 1 2. Nxitje dhe mbështetetje per krijimin e vendeve të mbrojtura të punës për PAK dhe sigurim i lëvizjes se tyre në vende pune në tregun e hapur të punës. | 2004 e në vazhdim | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë, sektori privat |
| | 1.3 Reformimi i përfitimeve të PAK dhe skemave të pensioneve për të shmangur konfliktet me politikat aktive të tregut të punës. | 2005 e në vazhdim | MPÇS, ISSH | Buxheti i shtetit |
| | 1.4 Ngritja e qendrave speciale për punësimin e personave me AK. | 2007 | MPÇS, OJF | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |
| | 1.5 Të gjenden mjetet dhe rrugët për zbatimin e legjislacionit dhe politikat ekzistuese në fushën e punësimit për integrimin e PAK në shoqëri nëpërmjet punësimit dhe formimit profesional për të detyruar punëdhënësit për zbatimin e detyrimit ligjor për punësimin e PAK dhe lehtësitë që ata përfitojnë | 2004 - 2005 | MPÇS, SHKP | Buxheti i shtetit |
| 2. Përmirësimi i politikave dhe programeve për trajnimin dhe formimin profesional të PAK | 2.1.Rishikimi i sistemit të rehabilitimit dhe formimit profesional për personat me aftësi të kufizuar duke patur parasysh evoluimin dhe kërkesat e tregut të punës. | 2005 e në vazhdim | MPÇS | MPÇS, SHKP |
| | 2.2 Zhvillimi i mundësive për punësimim, këshillim dhe shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me punëdhënësit. | 2005 e në vazhdim | MPÇS | MPÇS, SHKP |

## *Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara*

| Objektivat | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| 3. Të sigurohet mundësia e arsimimit për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke i dhënë prioritet arsimit gjithpërfshirës. | 3.1 Hartimi i një kurrikuli të ri të shkollës së zakonshme, që favorizon proceset gjithëpërfshirëse; | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit |
| | 3.2. Përgatitja e një paketë me udhëzime praktike, materiale didaktike dhe standarde integruese në ndihmë të shkollave; 500 000 lekë. | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.3 Hartimi i një akti normativ, që rregullon punën me PEI-në (plani edukativ i individualizuar) dhe saktëson procedurat e pranimit dhe të vlerësimit fillestar e në proces të nxënësve me nevoja të veçantë. | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.4 Krijimi në shkollë i mjediseve burimore për punë më specifike me grupe fëmijësh; | 2004 e në vazhdim | Drejtoritë arsimore | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.5 Përmirësime ligjore, lidhur me ngarkesën e mësuesit dhe vlerësimin e tij financiar; | 2005 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit |
| | 3.6 Përgatitje buletinesh dhe materialesh të tjera ndihmëse për mësuesit dhe prindërit; | 2005 e në vazhdim | MASH, Drejtoritë arsimore, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.7 Regjistrimi me prioritet i këtyre të rinjve në shkollat e mesme profesionale. | 2004 e në vazhdim | MASH, Drejtoritë arsimore, | Buxheti i shtetit |
| 4. Të përmirësohet dhe modernizohet procesi mësimor edukativ në shkollat speciale. | 4.1 Hartimi dhe zbatimi i programeve speciale integruese që ofrojnë një përgatitje më të mirë sociale dhe praktike të nxënësve (shtimi i veprimtarive praktike); | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 4.2 Sigurimi i lehtësirave , si transport, etj. për fëmijët me Ak nga zonat më të largëta për të ndjekur shkollat speciale. | 2006 - 2010 | MASH/DA, NJPV, MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 4.3 Krijimi i shërbimeve të reja për kategori të veçanta fëmijësh që nuk trajtohen (shërbime për fëmijët autistë etj.). | 2006 e në vazhdim | MASH, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |

*Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara*

| Objektivat | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| 5. Krijimi dhe shtrirja graduale e shkollave e kopshteve te integruara. | 5.1 Të pilotohet ngritja e 12 kopshteve dhe 12 shkolla integruese në gjashtë qytete, qendra qarku, ku ka universitete. | 2004 - 2006 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 5.2. Të plotësohen të gjitha qytetet dhe rrethet e mëdha me kopshte dhe shkolla të integruara, duke arritur në 100 shkolla dhe 90 kopshte të integruara. | 2006 - 2014 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 6. Krijimi dhe shtrirja graduale e shërbimeve psikopedagogjike dhe psikosociale në shkollat e integruara dhe në kopshtet | 6.1 Të krijohen struktura të shërbimeve psikopedagogjike e psikosociale pranë shkollave, duke patur në përbërje 1 psikolog, 1 punonjës social dhe 2-3 mësues me kohë të pjesshme dhe më pas të arrihet në shërbime të qëndrueshme duke filluar nga qytetet e mëdha (qendra rajonale), ku ka universitete. | Në dy vitet e para, duke filluar nga shtatori 2003 (2003 - 2005):<br>Deri në 5 vjet (2003-2008) | MASH<br>MASH | Buxheti i shtetit, donatorë<br>Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 6.2 Krijimi edhe i 7 qendrave të reja, duke mbuluar, kështu, të gjitha rajonet e vendit (13). 2 000 000 lekë në një vit | Në fund të 10 vjetëve (2003-2013): | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 7. Të sigurohet mbështetje për tërheqjen e PAK në veprimtaritë kulturore e sportive dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. | 7.1 Të evidentohet numri i PAK që përfitojnë nga lehtësirat që ofrohen në fushën e kulturës dhe të sporteve. nevojave për organizimin e veprimtarive në këto fusha | 2005 - 2006 | MKRS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 7.2 Të parashikohet një buxhet i vecantë që të mundësojë zbatimin e ligjit për subvensionimin e aktiviteteve kulturore, artistike e sportive për PAK dhe organizatat e tyre. | 2005 - 2006 | MRKS, NJPV | Buxheti i shtetit, i njësive vendore, donatorë |
| | 7.3 Sigurimi i financimit të programeve sportive publike të përbashkëta, për personat me dhe pa AK. | Çdo vit | MRKS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, i njësive vendore, donatorë |
| | 7.3 Të ketë një kalendar të veçantë për veprimtaritë sportive të PAK dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. | Sipas kalendarit vjetor | MRKS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, i njësive vendore, donatorë |

## *Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara*

| Objektivat | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| ***IV. Ngritja e kapaciteteve*** | | | | |
| 1. Të ngrihet kapaciteti i strukturave që punojnë me aftësinë e kufizuar nëprmjet ngritjes së strukturave të reja, përmirësimit të nivelit të strukturave ekzistuese dhe rritjes së kapaciteteve të stafeve. | 1.1. Të ngrihet një strukturë monitorimi për Strategjinë Kombëtare të PAK. | 2005 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Krijimi dhe konsolidimi i strukturave të reja rajonale për vlerësimin multidisiplinar (fizike, mjekësore dhe sociale) të PAK. | 2005 | MPÇS, SHSSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Ngritja e një qendre të ekspertizës mjekësore pranë drejtorisë së Përgjithshme të ISSH dhe modernizimi i drejtorive rojonale. (0.5 milion EURO). | 2005 e në vazhdim | MPÇS, ISSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.5 Të ngrihen kapacitetet profesionale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit nga qendra në nivel rajonal, nëpërmjet :<br>a) Trajnimit për mbështetje psiko-sociale dhe profesionale për stafet e Qendrave të formimit profesional.<br>b) Të hapen kurse të formimit profesional për përgatitjen e profesionistëve për sektorët e riaftësimit fizik, shoqëror, psikologjik e profesional të PAK | 2005-2006 | MPÇS, SHKP | Buxheti i shtetit, donatorë |
| ***V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit*** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve socile, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të mundësohet ngritja e një institucioni shtetëror të veçantë në mbrojtje të të drejtave të PAK. | 2006 | MPÇS | MPÇS |
| | 1.2 Të bëhet një studim për të gjithë legjislacionin që mbulon problemet e aftësisë së kufizuar, krahasuar me standardet dhe konventat ndërkombëtare. | 2005 -2006 | MSH, MASH, MKRS, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Të synohet hartimi i një ligji integral për aftësinë e kufizuar. | 2006 | MPCS, MSH, MASH , MKRS, MB, MD, MF, MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.4 Të përfshihet në Ligjin "Për urbanistikën" që po hartohet, një nen që garanton pasqyrimin në projekte integrimin normal dhe të garantuar të PAK në shoqëri. | 2005 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| | 1.5 Të përmirësohet legjislacioni ekzistues për transportin, ku të merren në konsideratë heqja e barrierave në transport për PAK. | 2006 e në vazhdim | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.6 Të përcaktohen standarde teknike për mjetet e transportit publik duke patur parasysh përshtatshmërinë e të gjitha tipeve të transportit për PAK në levizje dhe orientim. | 2006 e në vazhdim | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.7 Të rishikohet Kodi Rrugor dhe ligjet që kanë të bëjnë me kushtet teknike për përdorimin e automjeve, të modifikohen rregulloret dhe udhëzuesit teknikë për projektimin e rrugëve publike duke u bazuar në kërkesën dhe nevojat e PAK për një ambjent pa-barriera. | 2006 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.8 Të hartohet manual projekti që të japë udhëzime për vendosjen e lehtësirave në rrugë publike për PAK. Në aktet nënligjore, qoftë ato të amenduara apo ato të konceptuara nga fillimi. | 2005 - 2007 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 2. Të lehtësohen procedurat e trajtimit të PAK nëpërmjet përmirësimeve ligjore. | 2.1 Të përgatitet legjislacioni përkatës që përcakton standardet teknike për pajisjet e PAK si dhe standardet e pajisjeve didaktike për fëmijët, nxënësit dhe institucione shkollore. | 2006 | MASH, MPÇS, ISSH, SHSSH, MSH | Buxheti i i shtetit, buxheti vendor, ISSH |
| | 2.2 Të përmirësohet legjislacioni që përjashton nga detyrimet doganore pajisjet që përdoren nga PAK duke i klasifikuar si produkte të ngarkuara me TVSH-në më të ulët. | 2004 - 2005 | MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| | 2.3 Të sigurohet baza ligjore për financimin e trajnimit të kujdestarëve të PAK të rëndë dhe të studiohet mundësia e siguracionit për kujdestarët | 2006 | MPÇS, SHSSH, NJPV, ISKSH | Buxheti i i shtetit, buxheti vendor, ISSH |
| | 2.4 Të sigurohet një kuadër ligjor për shtrirjen minimale të shërbimeve falas apo me pagesë të pjesshme të shoqëruesit që lexon, shërben si guidë apo digjitalizues për të verbërit dhe shërbimeve të interpretuesve të gjuhës së shenjave dhe shërbimeve të artikulimit për personat që nuk dëgjojnë. | 2007 | MPÇS, SHSSH, NJPV, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2. 5. Të përmirësohet legjislacioni që përkrah me fonde dhe mjete të tjera logjistike OJF të personave me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive për të ngritur dhe ofruar shërbime riaftësimi. | 2006 e në vazhdim | OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2.6 Të sigurohet baza ligjore që Televizioni Publik të transmetojë një buletin ditor lajmesh prej 5-minutash në gjuhën e shenjave me një përkthyes në ekran. | 2006 e në vazhdim | OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 3. Sigurimi i informacioneve, të dhë-nave për numrin e personave me aftesi te kufizuara, llojet e AK, situatën social-ekonomike, programet mbështetese, shërbimet etj. | 3.1 Krijimi dhe rifreskim i të dhenave statistikore për PAK. | 2005 | MPÇS, MSH, INSTAT, MPVD/NJPV, OJF-të Institucionet akademike | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.2 Realizimi i studimeve periodike për PAK, llojet e AK, shërbimet ekzistuese, nevojat etj. | Çdo vit | INSTAT, MPCS, MSH, Observatori, OJF-të e AK. | Buxheti i shtetit, buxheti i njësive vendore, donatorë |
| | 3.3 Krijimi i regjistrit të PAK, regjistrimi i PAK. | Rregjistrimi i ardhshëm | INSTAT, MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |

***Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara***

| Objektivat | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| 4 Mbështetje e programeve të kërkimit rreth çështjeve ekonomike, sociale, pjesëmarrjes etj, qe prekin jeten e PAK dhe familjeve të tyre, llojet e AK, frekuencën, përshtatshmerinë dhe efikasitetin e programeve ekzistuese | 4.1 Krijimi i një data-base për gjendjen social-ekonomike dhe shëndetësore të:<br>- të sëmurëve me hemofili.<br>- të sëmurëve me kancer. | 2005 - 2006 | MPÇS, OJF-të | Institucionet, donatorë, OJF-të |
| | 4.2 Studime rreth llojit të AK, frekuencës, përhapjes gjeografike dhe masave për mbështetjen e tyre. | 2005 - 07, afatgjatë 2015 | MSH, OJF-të | Donatorë, OJF |
| | 4.3 Zhvillim i terminologjise dhe kritereve për studime kombetare në fushen e AK. Hartimi i një fjalori terminologjik për AK. | 2004 - 2005 | Institutet, OJF-të | Donatorë, OJF-të |
| | 4.4 Publikimi i Listës se Aftësive të Kufizuara dhe Kategorizimin e tyre lidhur me kufizimet potenciale të mundësive sociale. | 2006 e në vazhdim | MASH, MPÇS, MSH, MB, NJPV, Institutet, OJF-të | Buxheti i shtetit, Donatorët, OJF-të |
| 5. Pergatitja dhe shperndarja sistematike e informacionit, ne nivel kombetar, rajonal e lokal, per AK. Sigurimi i aksesit te PAK, ne kete informacion | 5.1 Botimi i broshurave periodike me materiale në ndihmë të PAK dhe strukturave që trajtojnë ata, për rehabilitimin dhe integrimin; përmbledhje të legjislacionit me interes për PAK; të drejtat dhe liritë e tyre etj. | 1 herë në vit vazhdimisht | Strukturat shtetërore, OJF-të, MEDIA | Donatorë, OJF, Media |
| 6. Mbeshtjetje e programeve te edukimit kundër diskriminimit të PAK, | 6.1 Bashkëpunim me MEDIA-n për të ndërtuar një strategji të transmetimit të problematikes se AK, duke krijuar edhe alternativa për akses informacioni për PAK me probleme dëgjimi (gjuha e shenjave, titrat, orare të veçanta për problemet e AK, të drejtat e tyre, si një formë ndërgjegjësimi për MEDIA-n dhe publikun. | 2005 e në vazhdim | Strukturat shtetërore, OJF-të, Media | Donatorë, OJF, Media |
| | 6.2 Promovimi dhe inkurajimi i inisiativave të PAK. Organizimi i një panairi vjetor dhe panaireve rajonale me punime të PAK. | Çdo vit | NJQV, OJF-të | Donatorë, buxheti i NJ/V, OJF |
| | 6.3 Cmimi vjetor i nderit për institucionin më të mirë që punon me PAK, si vlerësim i punës ne dobi të PAK. | Çdo vit | MPÇS | Buxheti i shtetit |

## Parathënie për ribotimin e vitit 2006

Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara është dokumenti më gjithpërfshirës, i hartuar nga Qeveria Shqiptare në fushën e Aftësisë së Kufizuar. Kjo Strategji u realizua në mbylljen e Dekades Europiane dhe Botërore 1993-2003 të Aftësisë së Kufizuar.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara filloi si nismë e organizatave që mbrojnë të drejtat e PAK dhe ofrojnë shërbime për ta. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara organizoi dhe mbështeti Grupimin e Shoqatave të grupeve dhe problematikave të ndryshme të Aftësisë së Kufizuara për të analizuar gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, bazuar në këndvështrimin e Rregullave Standarte të Kombeve të Bashkuara për Barazinë e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Raporti dhe rezultatet e kësaj analize iu dërguan Qeverisë me kërkesën për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara (SKPAK).

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 85, dt. 19.06.2003, u ngrit një Grup Ndërministror për hartimin e Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky grup, i cili u drejtua nga Ministria e Punes dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, kishte në përbërje të tij përfaqësues të ministrive që hartojnë dhe zbatojnë politika që ndikojnë jetën e PAK, institucioneve në varësi si dhe përfaqësues të organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar.

Proçesi i hartimit të Strategjisë u mbështet nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, e cila ofroi konsulencën e një eksperteje ndërkombëtare në fushën e aftësisë së kufizuar, përfaqësuese e Zyrës së Komisionerit Federal për Çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara të Republikës Federale të Gjermanisë.

Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 8, dt. 7.01.2005. Ajo synon përmirësimin e kushteve të jetës të personave me aftësi të kufizuar, përmes arsimimit, punësimit, shërbimeve mbështetëse dhe mënjanimit të çdo pengese që i përjashton nga politikat gjithëpërfshirëse të shoqërisë dhe që iu mohon të drejtat e tyre njerëzore.

Strategjia përmban objektiva dhe veprime për mos diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara dhe për të promovuar shanse të barabarta për të marrë pjesë në zhvillimin social të vendit.

Kjo Strategji përcakton politikat, sipas kapacitetit të ekonomisë kombëtare, për të minimizuar disavantazhet shoqërore dhe pabarazitë që lindin për shkak të aftësisë së kufizuar, për t'i bërë personat me aftësi të kufizuara, anëtarë të dobishëm dhe produktivë të shoqërisë.

Strategjia planifikon masat për akses të PAK në mjedis dhe informacion; për kujdesin shëndetësor; punësimin dhe formimin professional; shërbimet e përkujdesit shoqëror; arsimimin; transportin; planifikimin dhe zhvillimin rajonal dhe veprimtari të tjera me qëllim që personave me aftësi të kufizuara t'iu jepen mundësi të barabarta për të vetvendosur dhe për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore.

Këto masa janë në përputhje me objektivat e përgjithshme të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe duhet të realizohen sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimin të kësaj Strategjie.

Ajo nënvizon nevojën për harmonizimin ligjor në përputhje me standardet e përcaktura në dokumentet e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian.

Strategjia udhëhiqet nga filozofia se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta themelore, ashtu si të gjithë qytetarët e tjerë. Ndaj ata duhet të kenë shanse të barabarta pjesëmarrjeje në jetën shoqërore.

***Ky dokument:***

1. Përshkruan situatën reale të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri duke nënvizuar prirjet dhe duke përcaktuar objektivat dhe politikat për përmirësimin e kësaj situate.
2. Përcakton politikat qeveritare dhe koordinimin e aktiviteteve te institucioneve shtetërore, individëve dhe organizatave të tjera që punojnë në fushën e Aftësisë së Kufizuar dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
3. Përfaqëson vullnetin e të gjitha palëve të përfshira në mënyrë që të harmonizohet politika shqiptare mbi personat me aftësi të kufizuara brenda kuadrit ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian.
4. Synon përmirësimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në fushën e jetesës pa barriera, të arsimimit, të shërbimeve, të punësimit, të legjislacionit, etj.
5. Bashkërendon masat e saj me qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), duke mundësuar kështu një monitorim nga një strukture dypalëshe.
6. Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara ishte përgjigja që Qeveria Shqiptare i bëri Thirrjes së Grupimit të Shoqatave të Aftësisë së Kufizuara, për të realizuar një kornizë politikash dhe masash dhe për zbatimin e tyre, duke marrë përgjegjësi institucionale dhe duke parashikuar buxhetet e rolet përkatëse në mbështetje të zbatimit të këtyre përgjegjësive.

***Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara përfshin:***

1. Parimet themelore dhe objektivat,
2. Analizën e situatës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri,
3. Fushat kryesore të ndërhyrjes,
4. Planin e Veprimit,
5. Strukturën e monitorimit dhe raportimit.

Plani i Veprimit përfshin objektivat specifike dhe masat konkrete për realizimin e tyre, afatet kohore dhe institucionet përgjegjës si dhe mbështetësit financiarë.

***Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara u shërben :***

1. Institucioneve qendrore, që kanë marrë përgjegjësi, kanë parashikuar afate kohore dhe buxhete për realizimin e masave konkrete për objektivat e caktuara në Strategji.
2. Administratës rajonale dhe lokale, strukturave përkatëse në qarqe, bashki, komuna si dhe drejtorive të arsimit, shëndetësisë, etj, për të bërë prezente përgjegjësitë e marra nga institucionet dhe që do të zbatohen nga administrata vendore në kuadrin e proçesit të decentralizimit.
3. Organizatave që punojnë në fushën e të drejtave të PAK.
4. Organizatave që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar për të nxitur procesin e zbatimit të Strategjisë duke ofruar njëkohësisht edhe bashkëpunim dhe përfshirje për fusha të veçanta
5. Donatorëve, për të orientuar prirjet e tyre në zbatim të objektivave e fushave kryesore të Strategjise.
6. Medias së shkruar dhe elektronike, si aleat dhe njëkohësisht oponent në vijueshmërinë e proçesit të zbatimit të Strategjisë.

Proçesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare të Pesonave me Aftësi të Kufizuar, ishte i hapur dhe demokratik dhe në Strategji u përfshinë dhe u reflektuan, të gjitha mendimet e aktorëve përgjegjës e përfitues, duke vënë në dispozicion të tyre të gjithë kohën dhe hapësirat e nevojshme për rekomandime për përmirësime. SKPAK do të shërbejë si një instrument që do të ndihmojë për ndryshimin e qëndrimit dhe mentalitetit të individëve, organizatave dhe institucioneve shtetërore për të krijuar barazi sociale për personat me aftësi të kufizuar.

Për realizimin e kësaj Strategjie kërkohet nga pushteti qëndror, pushteti vendor, OJF-të, vetë personat me aftësi të kufizuara si dhe nga shoqëria në tërësi, të angazhohen në mënyrë aktive për zbatimin e saj.
Eshtë e natyrshme që proçesi i zbatimit të SKPAK dhe monitorimi që do të ushtrohet mbi të do të diktojnë ndryshime e përmirësime të vazhdueshme duke iu përgjigjur ritmeve të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe në mënyrë të veçantë, zhvillimeve në fushën e aftësisë së kufizuar.

Riformulimi i Planit të Veprimit, me prioritete të vitit 2006 dhe i ndarë sipas institucioneve përgjegjëse, që do t'i bashkëlidhet këtij ribotimi, bëhet në mbështetje të ndryshimeve dhe për të lehtësuar nxjerrjen e prioriteteve të çdo institucioni për zbatimin e SKPAK.

**Falenderojmë Prezencën e OSBE-së në Shqipëri që mundësoi ribotimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky ribotim vjen në kohën e duhur, në përputhje me kërkesat e bëra nga njësitë e qeverisjes vendore dhe institucione të tjera që kanë detyra për implementimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.**

Tiranë, Shtator 2006

## ***Plani Kombëtar i Veprimit për Personat Me Aftësi Të Kufizuara***

*Prioritetet e vitit 2006 për Institucionet Shtetërore*

*Jetesa pa barriera*

*Shërbimet*

*Arsimimi, punësimi dhe kualifikimi profesional*

*Ngritja e kapaciteteve*

*Legjislacioni dhe puna kërkimore*

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **I. Përshtatshmëria e mjedisit** | | | | |
| 1. Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike dhe të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1 Në planifikimin e fondeve publike (infrastrukturë e objekte sociale – rruge e mjedise publike, në institucionet shëndetësore, në shërbime publike, në shkollat e të gjitha niveleve ) të përfshihen edhe fonde për elementë ndërtimorë që garantojnë heqjen e barrierave (nënkalime, panduse, ashensorë, vendqendrime, parapete, etj ) | 2007 - 2014 | MPPTT, MSH, MASH, MPÇS, Njësitë e PV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Përshtatshmëria e mjedisit të 8 Qendrave Publike të Formimit Profesional. | 2005 - 2007 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| **II. Fusha e shërbimeve** | | | | |
| 1. Të sigurohet parandalimi i AK, ne faza sa më të hershme, nëpërmjet diagnostikimit të hershëm, trajtimit të çrregullimeve emocionale dhe te sjelljes se femijeve 0-6 vjeç, depistimit. | 1.1 Ngritja e ekipeve multidisiplinore për hartimin e programeve për parandalimin e hershëm të AK, identifikimin e hershëm të crregullimeve emocionale e të sjelljes nëpërmjet depistimit të AK, vlerësimit dhe trajtimit (rehabilitim dhe riintegrim). | 2004 - 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 2. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet perkatese publike e private i shërbimeve për PAK, në përputhje me grupmoshat dhe nevojat për rehabilitim dhe integrim. | 2.1 Ngritje e shërbimeve të reja të përkujdesjes, si: ditore, në familje, strehëza, me synim që PAK të qëndrojnë sa më pranë mjedisit familjar ose në mjedise të ngjashme me familjen. | 2006 e në vazhdim | MPÇS, SHSSH, ISSH, NJPV | Buxheti i shtetit dhe i NJPV, donatorë, OJF |
| | 2.2 Pilotim i modeleve te reja të shërbimeve dhe vleresim i efektshmërisë dhe shtrirjes së tipeve të ndryshme të shërbimeve per PAK. | 2004 - 2006 | MPÇS, SHSSH, NJPV, MSH, OJF, Bashkia e Tiranës | Buxheti i shtetit, BB, donatorë, OJF, Bashkia e Tiranes. |
| | 2.3 Hartimi i rregulloreve dhe standarteve te shërbimeve per PAK, duke theksuar të drejten e klientëve per të marre shërbime të përshtatshme, respektimin e dinjitetit, ruajtjen e aftesive, etj. | 2004 - 2006 | MPÇS, SHSSH | Buxheti i shtetit, B.B, donatorë, OJF |
| | 2.4 Rishikim i kritereve dhe rregulloreve të institucioneve rezidenciale publike, për PAK dhe të moshuar, për të parashikuar masa për PAK të rëndë që nuk u sigurohet shërbimi pranë familjes. | 2006 e në vazhdim | MPÇS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, NJPV Donatorë, OJF |

## *PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA*

### *Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta*

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 3. Zbutja dhe riaftësimi i kufizimeve funksionale, fizike, psikike, sociale dhe ekonomike qe vijnë nga aftësitë e kufizuara, aksidentet apo sëmundjet për të siguruar integrimin e PAK ne jeten e familjes dhe komunitetit. | 3.1 Hartimi dhe zbatimi i një programi të qartë kombëtar për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve riaftësuese, për shtrirje graduale në të gjithë territorin e vendit dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar. | Sipas një plani të veçantë 2005 deri 2015 | MSH, MPÇS | MSH, donatorë, OJF |
| | 3.2 Krijimi dhe praktikimi i një sistemi akreditimi për ecurinë e qendrave të kujdesit të hershëm, qendrave rehabilituese, trainuese dhe ritrajnuese për secilin grup të personave me aftësi të kufizuar. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS | Buxheti i shtetit, ISKSH, donatorë. |
| | 3.3 Krijim i strukturave nga qendra në bazë, përfshirë dhe njesite vendore, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e sherbimeve te pershtatshme per ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MB, MPÇS, MASH, | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |
| 4. Informimi i PAK, ekspertëve, kujdestarëve, personelit të shërbimit dhe familjarëve për pajisjet teknike dhe mjetet teknologjike që përdoren nga PAK dhe plotësimi i nevojave të tyre me këto mjete. | 4.1 Sigurimi dhe plotësimi i PAK me pajisje standarde për AK dhe mjete kompesuese didaktike për fëmijë dhe nxënësit me AK në shkolla, qendra sherbimesh etj. | 2005 e në vazhdim | MPÇS, SHSSH, ISSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatore. |
| | 4.2 Stimulim i botimit të broshurave me informacion për mjetet moderne në shërbim të PAK. Hapje e ekspozitave dhe panaireve me mjete për AK. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë. |
| | 4.3 Promovim i ngritjes dhe zhvillimit të qendrave të specializuara informuese dhe këshilluese, që merren me pajisjet teknike dhe përshtatjen e produkteve standarde mbi bazën e specializimit nga subjektet publike dhe jopublike. | 2005 e ne vazdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 5.Shpërndarja e shërbimeve nën kujdesin e njësive të qeverisjes vendore, sipas ligjit të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore, politikave sociale dhe nevojave te PAK. | 5.1 Të krijohen ose të përshtaten struktura nga qendra në bazë, duke përfshirë edhe organet e pushtetit vendor, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve sociale për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë. |
| | 5.2 Kujdestaria dhe kujdesi për një person të afërt të bëhet alternativa e vërtetë kundrejt kujdesit institucional për PAK të rëndë. Përgatitje dhe trajnim i kujdestarëve për të verbrit dhe personat që nuk dëgjojnë. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë. |
| **III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe formimi profesional** | | | | |
| 1. Përmirësimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për punësimin e PAK. | 1.1.Studimi i gjendjes së punësimit të PAK dhe punësimi i tyre në raport me nevojat e tregut të punës. | 2004 e në vazhdim | MPÇS | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë. |
| | 1 2. Nxitje dhe mbështetetje per krijimin e vendeve të mbrojtura të punës për PAK dhe sigurim i lëvizjes se tyre në vende pune në tregun e hapur të punës. | 2004 e në vazhdim | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë, sektori privat. |
| | 1.3 Reformimi i përfitimeve të PAK dhe skemave të pensioneve për të shmangur konfliktet me politikat aktive të tregut të punës. | 2005 e ne vazhdim | MPÇS, ISSH | Buxheti i shtetit |
| | 1.4 Të gjenden mjetet dhe rrugët për zbatimin e legjislacionit dhe politikat ekzistuese në fushën e punësimit për integrimin e PAK në shoqëri nëpërmjet punësimit dhe formimit profesional për të detyruar punëdhënësit për zbatimin e detyrimit ligjor për punësimin e PAK dhe lehtësitë që ata përfitojnë. | duke filluar nga 2005 | MPÇS, SHKP | Buxheti i shtetit. |
| 2. Përmirësimi i politikave dhe programeve për trajnimin dhe formimin profesional të PAK. | 2.1.Rishikimi i sistemit të rehabilitimit dhe formimit profesional për personat me aftësi të kufizuara duke patur parasysh evoluimin dhe kërkesat e tregut të punës. | 2005 e në vazhdim | MPÇS | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë. |
| | 2.2 Zhvillimi i mundësive për punësimim, këshillim dhe shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar në bashkëpunim me punëdhënësit. | 2005 e ne vazhdim | MPÇS | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë. |

**_PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA_**

**_Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta_**

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **_IV. Ngritja e kapaciteteve_** | | | | |
| 1.Të ngrihet kapaciteti i strukturave që punojnë me aftësinë e kufizuar nëpërmjet ngritjes së strukturave të reja, përmirësimit të nivelit të strukturave ekzistuese dhe rritjes së kapaciteteve të stafeve. | 1.1 Të ngrihet një strukturë monitorimi për Strategjinë Kombëtare të PAK. | 2005 - 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Krijimi dhe konsolidimi i strukturave të reja rajonale për vlerësimin multidisiplinar (fizike, mjekësore dhe sociale) të PAK. | 2005 - 2006 | MPÇS, SHSSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3. Të ngrihet kapaciteti i këtyre strukturave nëpërmjet trajnimeve, vizitave studimore, ngritjes së qendrave të specializuara. | 2005 e në vazhdim | MPÇS, SHSSH | |
| | 1.4 Ngritja e një qendre të ekspertizës mjekësore pranë drejtorisë së Përgjithshme të ISSH dhe modernizimi i drejtorive rojonale. (0.5 milion EURO). | 6 qendra në vitin 2005 | MPÇS, ISSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.5 Të ngrihen kapacitetet profesionale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit nga qendra në nivel rajonal, nëpërmjet :<br>a)Trajnim për mbështetje psiko-sociale dhe profesionale për stafet e Qendrave të formimit profesional.<br>b)Të hapen kurse të formimit profesional për përgatitjen e profesionistëve për sektorët e riaftësimit fizik, shoqëror, psikologjik e profesional të PAK. | 2005 - 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| **_V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit_** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të mundësohet ngritja e një institucioni shtetëror të vecantë në mbrojtje të të drejtave të PAK. | 2005 - 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MB, MD, MF. | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Të bëhet një studim për të gjithë legjislacionin që mbulon problemet e aftësisë së kufizuar, krahasuar me standardet dhe konventat ndërkombëtare. | 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MTKRS, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Të synohet hartimi i një ligji integral për aftësinë e kufizuar.<br>Të drejtat dhe detyrimet mund të përfshihen në legjislacionin e përgjithshëm ose të mblidhen në një legjislacion të vecantë. Legjislacioni i vecantë për PAK mund të vendoset në disa mënyra:<br>a) Krijimi i një legjislacioni qe lidhet vetëm me çështje të aftësisë se kufizuar<br>b) Përfshirja e disa çështjeve të aftësisë se kufizuar brenda legjislacionit. | 2006 | | |

## *PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA*

### *Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta*

| *Objektivat* | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| 2. Të lehtësohen procedurat e trajtimit të PAK nëpërmjet përmirësimeve ligjore. | 2.1 Të përgatitet legjislacioni përkatës që standardet teknike për pajisjet e PAK si dhe standartet e pajisjeve didaktike për fëmijët, nxënësit dhe institucione shkollore. | 2006 | MASH, MSH, MPÇS, ISSH, SHSSH | Buxheti i shtetit, buxheti vendor |
| | 2.2 Te përmirësohet legjislacioni që përjashton nga detyrimet doganore pajisjet që përdoren nga PAK duke i klasifikuar si produkte të ngarkuara me TVSH-në më të ulët. | 2004 - 2006 | MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2.3 Të sigurohet baza ligjore për financimin e trajnimit të kujdestarëve të PAK të rëndë dhe të studiohet mundësia e siguracionit për kujdestarët. | 2006 | MPÇS, SHSSH, NJPV, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 3. Sigurimi i informacioneve, të dhënave për numrin e personave me aftesi te kufizuara, (PAK), llojet e AK, situaten social-ekonomike, programe mbështetëse, sherbime etj. | 3.1 Krijimi dhe rifreskimi i të dhënave statistikore për PAK. | 2006 | MPÇS, MSH, INSTAT, MB/NJQV, OJF-të Institucionet akademike | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.2 Realizimi i studimeve periodike për PAK, llojet e AK, shërbimet ekzistuese, nevojat etj. | Çdo vit | INSTAT, MPÇS, MSH, OJF-të e AK | Buxheti i shtetit, buxheti i njësive vendore, donatorë |
| 4 Mbështetje e programeve të kërkimit rreth çështjeve ekonomike, sociale, pjesëmarrjes etj, që prekin jeten e PAK dhe familjeve te tyre, llojet e AK, frekuencën, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e programeve ekzistuese, nevojat etj. | 4.1 Publikimi i Listës se Aftësive të Kufizuara dhe Kategorizimin e tyre lidhur me kufizimet potenciale të mundësive sociale. | 2006 e në vazhdim | MASH, MPÇS, MSH, MB, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |

## *PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA*

## *Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta*

| *Objektivat* | *Masat* | *Afatet kohore* | *Institucioni zbatues* | *Mbulimi financiar* |
|---|---|---|---|---|
| 5. Përgatitje dhe shpërndarje sistematike e informacionit, në nivel kombëtar, rajonal e lokal, për AK. Sigurimi i aksesit të PAK, në këtë informacion, përmes përshtatjes. | 5.1 Botimi i broshurave periodike me materiale në ndihmë të PAK dhe strukturave që trajtojnë ata, për rehabilitimin dhe integrimin; përmbledhje të legjislacionit me interes për PAK; të drejtat dhe lirite e tyre etj. | 1 herë në vit vazhdimisht | Institucionet , OJF-të | Institucionet, donatorë, OJF-të |
| 6. Mbështjetje e programeve të edukimit kundër diskriminimit të PAK. | 6.1 Bashkëpunim me MEDIA-n për të ndërtuar një strategji të transmetimit të problematikes së AK, duke krijuar edhe alternativa për akses informacioni për PAK me probleme dëgjimi (gjuha e shenjave, titrat, orare të veçanta për problemet e AK, të drejtat e tyre, si një formë ndërgjegjësimi për MEDIA-n dhe publikun. | 2005 e në vazhdim | Strukturat shtetërore, OJF-të, MEDIA | Donatorë,OJF, Media |
| | 6.2 Promovimi dhe inkurajimi i inisiativave te PAK. Organizimi i një panairi vjetor dhe panaire rajonale me punime të PAK. | Çdo vit | NJQV, OJF-të | Donatorë, buxheti i NJPV, OJF |
| | 6.3 Cmimi vjetor i nderit per institucionin, si vleresim i punes ne dobi te PAK. | Çdo vit | MPÇS | Buxheti i shtetit |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **I. Përshtatshmëria e mjedisit** | | | | |
| 1.Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike dhe të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1 Ne planifikimin e fondeve publike (infrastrukture e objekte sociale –rrugë e mjedise publike, në institucionet shëndetësore, në shërbime publike, në shkollat e të gjitha niveleve) të përfshihen edhe fonde për elemente ndertimore që garantojne heqjen e barrierave (nënkalime, panduse, ashensorë, vendqendrime, parapete, etj ) | 2007 - 2014 | MPPTT, MSH, MASH,MPÇS, Njësitë e PV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Përshtatshmëria e mjediseve të 100 shkollave dhe 90 kopshteve. | 2004 - 2014 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë |
| **II. Fusha e shërbimeve** | | | | |
| 1.Të sigurohet parandalimi i AK, ne faza sa më të hershme, nëpërmjet diagnostikimit të hershëm, trajtimit të çrregullimeve emocionale dhe te sjelljes se femijeve 0-6 vjeç depistimit. | 1.1 Studime, kërkime dhe masa për minimizimin e rrezikut të AK të lindur. Përgatitja e buletineve dhe materialeve me karakter divulgativ për mirërritjen e fëmijëve. | 2 herë në vit | MSH, MASH | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |
| 2. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet perkatese publike e private i sherbimeve per PAK, në perputhje me grupmoshat dhe nevojat per rehabilitim dhe integrim. | 2.1 Vendosja e shërbimit të këshillimit psiko-sociale në 36 shkolla dhe plotësimi i të gjitha shkollave me këtë shërbim. Plotesimi i shkollave me infrastrukturen e nevojshme per fëmijët me nevoja të veçanta. | 2004 - 2006 (3 qendra)<br>2007 - 2009 (3 qendra)<br>2009-2010 (perfundimi) | MASH, DA, OJF | Buxheti i shtetit, NJPV, OJF, donatorë |
| 3 Zbutja dhe riaftësimi i kufizimeve funksionale, fizike, psikike, sociale dhe ekonomike qe vijnë nga aftësitë e kufizuara, aksidentet apo sëmundjet për të siguruar integrimin e PAK ne jeten e familjes dhe komunitetit. | 3.1 Krijimi i strukturave nga qendra në bazë, përfshirë dhe njësitë vendore, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve te përshtatshme per ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MB, MPÇS, MASH | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 4. Informimi i PAK, ekspertëve, kujdestarëve, personelit të shërbimit dhe familjarëve për pajisjet teknike dhe mjetet teknologjike që përdoren nga PAK dhe plotësimi i nevojave të tryre me këto mjete. | 4.1 Sigurimi dhe plotësimi i PAK me pajisje standarde për AK dhe mjete kompesuese didaktike për fëmijë dhe nxënësit me AK në shkolla, qendra sherbimesh etj. | 2005 e në vazhdim | MPÇS, SHSSH, ISSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 4.2 Stimulim i botimit të broshurave me informacion për mjetet moderne në shërbim të PAK. Hapje e ekspozitave dhe panaireve me mjete për AK. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 4.3 Promovim i ngritjes dhe zhvillimit të qendrave të specializuara informuese dhe këshilluese, që merren me pajisjet teknike dhe përshtatjen e produkteve standarde mbi bazën e specializimit nga subjektet publike dhe jopublike. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| 5.Shpërndarja e shërbimeve nën kujdesin e njësive të qeverisjes vendore, sipas ligjit të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore, politikave sociale dhe nevojave te PAK. | 5.1 Të krijohen ose të përshtaten struktura nga qendra në bazë, duke përfshirë edhe organet e pushtetit vendor, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve sociale për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 5.2 Kujdestaria dhe kujdesi për një person të afërt të bëhet alternativa e vërtetë kundrejt kujdesit institucional për PAK të rëndë. Pergatitje dhe trajnim i kujdestareve per te verbrit dhe personat qe nuk degjojnë. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe formimi profesional** | | | | |
| 1.Të sigurohet mundësia e arsimimit për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke i dhënë prioritet arsimit gjithpërfshirës. | 1.1 Hartimi i një kurrikuli të ri të shkollës së zakonshme, që favorizon proceset gjithëpërfshirëse; | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit |
| | 1.2. Përgatitja e një pakete me udhëzime praktike, materiale didaktike dhe standarde integruese në ndihmë të shkollave; 500 000 lekë. | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Hartimi i një akti normativ, që rregullon punën me PEI-në (plani edukativ i individualizuar) dhe saktëson procedurat e pranimit dhe të vlerësimit fillestar e në proces të nxënësve me nevoja të veçantë. | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.4 Krijimi në shkollë i mjediseve burimore për punë më specifike me grupe fëmijësh; | 2004 e në vazhdim | DA | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.5 Përmirësime ligjore, lidhur me ngarkesën e mësuesit dhe vlerësimin e tij financiar; | 2005 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit |
| | 1.6 Përgatitje buletinesh dhe materialesh të tjera ndihmëse për mësuesit dhe prindërit; | 2005 e në vazhdim | MASH, DA | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 2.Të përmirësohet dhe modernizohet procesi mësimor edukativ në shkollat speciale. | 2.1 Hartimi dhe zbatimi i programeve speciale integruese që ofrojnë një përgatitje më të mirë sociale dhe praktike të nxënësve (shtimi i veprimtarive praktike); | 2004 - 2006 | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2.2 Sigurimi i lehtësirave , si transport, etj. për fëmijët me Ak nga zonat më të largëta për të ndjekur shkollat speciale. | 2006 - 2010 | MASH/DA, NJPV, MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2.3 Krijimi i shërbimeve të reja për kategori të veçanta fëmijësh që nuk trajtohen (shërbime për fëmijët autistë) | 2006 e në vazhdim | MASH, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006, - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 3. Krijimi dhe shtrirja graduale e shkollave e kopshteve te integruara. | 3.1 Të pilotohet ngritja e 12 kopshteve dhe 12 shkolla integruese në gjashtë qytete, qendra qarku, ku ka universitete, | 2004 - 2006 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.2 Të plotësohen të gjitha qytetet dhe rrethet e mëdha me kopshte dhe shkolla të integruara, duke arritur në 100 shkolla dhe 90 kopshte të integruara. | 2006 - 2014 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 4. Krijimi dhe shtrirja graduale e shërbimeve psikopedagogjike dhe psikosociale në shkollat e integruara dhe në kopshte | 4.1 Të krijohen struktura të shërbimeve psikopedagogjike e psikosociale pranë shkollave, duke patur në përbërje 1 psikolog, 1 punonjës social dhe 2-3 mësues me kohë të pjesshme dhe më pas të arrihet në shërbime të qëndrueshme duke filluar nga qytetet e mëdha (qendra rajonale), ku ka universitete. | Në dy vitet e para, duke filluar nga shtatori 2003 (2003 - 2005):<br>Deri në 5 vjet (2003 - 2008) | MASH<br>MASH | Buxheti i shtetit, donatorë<br>Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 4.2 Krijimi edhe i 7 qendrave të reja, duke mbuluar, kështu, të gjitha rajonet e vendit (13). 2 000 000 lekë në një vit | Në fund të 10 vjetëve (2003 - 2013) | MASH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| **V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të mundësohet ngritja e një institucioni shtetëror të vecantë në mbrojtje të të drejtave të PAK. | 2005 - 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Të bëhet një studim për të gjithë legjislacionin që mbulon problemet e aftësisë së kufizuar, krahasuar me standardet dhe konventat ndërkombëtare. | 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MTKRS, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Të synohet hartimi i një ligji integral për aftësinë e kufizuar.<br><br>Të drejtat dhe detyrimet mund të përfshihen në legjislacionin e përgjithshëm ose të mblidhen në një legjislacion të vecantë. Legjislacioni i vecantë për PAK mund të vendoset në disa mënyra:<br>a) Krijimi i një legjislacioni qe lidhet vetëm me çështje të aftësisë se kufizuar<br>b) Përfshirja e disa çështjeve të aftësisë se kufizuar brenda legjislacionit. | 2006 - 2008 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2. Të lehtësohen procedurat e trajtimit të PAK nëpërmjet përmirësimeve ligjore. | 2.1 Të përgatitet legjislacioni përkatës që standardet teknike për pajisjet e PAK si dhe standartet e pajisjeve didaktike për fëmijët, nxënësit dhe institucione shkollore. | 2006 | MASH, MSH, MPÇS, ISSH, SHSSH | Buxheti i shtetit, buxheti vendor, ISSH |
| | 2.2 Te përmiresohet legjislacioni që përjashton nga detyrimet doganore pajisjet qe përdoren nga PAK duke i klasifikuar si produkte të ngarkuara me TVSH-në më të ulët. | 2007 | MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 3. Mbështetje e programeve të kërkimit rreth çeshtjeve ekonomike, sociale, pjesëmarrjes etj, që prekin jeten e PAK dhe familjeve te tyre, llojet e AK, frekuencën, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e programeve ekzistuese, nevojat etj. | 3.1 Publikimi i Listës se Aftësive të Kufizuara dhe Kategorizimin e tyre lidhur me kufizimet potenciale të mundësive sociale. | 2006 e në vazhdim | MASH, MPÇS MSH, MB, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, Donatorë, OJF |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Shëndetësisë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **I. Përshtatshmëria e mjedisit** | | | | |
| 1. Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike dhe të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1 Në planifikimin e fondeve publike (infrastrukturë e objekte sociale – rrugë e mjedise publike, në institucionet shëndetësore, në shërbime publike, në shkollat e të gjitha niveleve ) të perfshihen edhe fonde për elemente ndërtimorë që garantojnë heqjen e barrierave (nënkalime, panduse, ashensore, vendqëndrime, parapete, etj ) | 2007 - 2014 | MPPTT, MSH, MASH, MPÇS, Njësitë e PV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Përshtatja ndërtimore e mjediseve spitalore të Tiranës dhe pajisja e tyre me aksesorë lehtësues për PAK. 82.8 milionë lekë. | 2005 - 2010 | MSH | Buxheti i shtetit, NJPV, donatorë |
| | 1.3 Çdo spital në nivel rajonal apo bashkie të sigurojë dhe të kompletojë mjedise të përshtatura sipas standardeve europiane, për trajtimin e PAK. | 2006 e në vazhdim | MSH, NJQV | Buxheti i shtetit, i Nj:V, donatorë |
| **II. Fusha e shërbimeve** | | | | |
| 1. Të sigurohet parandalimi i AK, ne faza sa më të hershme, nëpërmjet diagnostikimit të hershëm, trajtimit të çrregullimeve emocionale dhe te sjeljes se fëmijëve 0-6 vjeç depistimit. | 1.1 Ngritja e ekipeve multidisiplinare për hartimin e programeve për parandalimin e hershëm të AK, identifikimin e e hershem te crregullimeve emocionale e te sjelljes nepermjet depistimit te AK, vlerësimin dhe trajtimin (rehabilitim dhe riintegrim). | 2004 - 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Ngritja e laboratorit të biokimisë molelukare dhe gjenetikës për diagnozën prenatale në spitalin obsetrik-gjinekologjik. | 2004 - 2005 | MSH | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |
| | 1.3 Fuqizimi i laboratorit të gjenetikës mjekësore pranë departamentit të pediatrisë. | 2004 e vazhdimisht | MSH, ISKSH, shoqatat | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |
| | 1.4 Studime, kërkime dhe masa për minimizimin e rrezikut të AK të lindur. Përgatitja e buletineve dhe materialeve me karakter divulgativ për mirërritjen e fëmijëve. | 2 herë në vit | MSH, MASH | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Shëndetësisë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet perkatese publike e private i sherbimeve per PAK, ne perputhje me grupmoshat dhe nevojat per rehabilitim dhe integrim. | 2.1 Pilotim i modeleve te reja të shërbimeve dhe vleresim i efektshmërise dhe shtrirjes së tipeve të ndryshme të shërbimeve për PAK. | 2004 - 2007 | MPÇS, SHSSH, NJPV MSH, OJF. Bashkia e Tiranës | Buxheti i shtetit, BB, donatorë |
| | 2.2 Standarde të reja për shërbimet për PAK | 2004 - 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, BB, donatorë |
| | 2.3 Rishikimi i rregulloreve të qendrave rezidenciale | 2004 - 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, BB, donatorë |
| 3. Sigurim i mundësive territoriale, financiare dhe fizike për kujdesin mjekësor thelbësor për PAK në gjendje të rëndë | 3.1 Rishikim i sigurimit të mjeteve dhe medikamentëve mjekësore dhe shpërndarjes se tyre për PAK në gjendje të rëndë. Të përcaktohet dhe institucionalizohet një buxhet më vete për PAK. | 2004 - 2008 | MSH, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.2 Rishikim i kurrikuve te mjekut të familjes, në të cilat të përfshihen programe për PAK në gjendje të rëndë. | Cdo vit | MSH, ISKSH | Buxheti i shtetit, ISKSH, donatorë |
| | 3.3 Percaktim i rrugëve dhe mjeteve për të mbuluar kostot shtesë për trajtimin mjekësor të PAK në gjendje të rëndë (sidomos ata me AK mendore). | Duke filluar nga 2006 | MSH, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 4. Zbutja dhe riaftësimi i kufizimeve funksionale, fizike, psikike, sociale dhe ekonomike qe vijnë nga aftësitë e kufizuara, aksidentet apo sëmundjet për të siguruar integrimin e PAK ne jeten e familjes dhe komunitetit. | 4.1 Hartimi dhe zbatimi i një programi të qartë kombëtar për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve riaftësuese, për shtrirje graduale në të gjithë territorin e vendit dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. | Sipas një plani të veçantë 2005 deri 2015 | MSH, MPÇS | MSH, donatorë, OJF |
| | 4.2 Krijimi dhe praktikimi i një sistemi akreditimi për ecurinë e qendrave të kujdesit të hershëm, qendrave rehabilituese, trainuese dhe ritrajnuese për secilin grup të personave me aftësi të kufizuara. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS | Buxheti i shtetit, ISKSH, donatorë. |
| | 4.3 Krijim i strukturave nga qendra në bazë, përfshirë dhe njësitë vendore, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MB, MPÇS, MASH | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |

**PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA**

**Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Shëndetësisë**

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 5. Informimi i PAK, ekspertëve, kujdestarëve, personelit të shërbimit dhe familjarëve për pajisjet teknike dhe mjetet teknologjike që përdoren nga PAK dhe plotësimi i nevojave të tyre me këto mjete. | 5.1 Stimulim i botimit të broshurave me informacion për mjetet moderne në shërbim të PAK. Hapje e ekspozitave dhe panaireve me mjete per AK. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 5.2 Promovim i ngritjes dhe zhvillimit të qendrave të specializuara informuese dhe këshilluese, që merren me pajisjet teknike dhe përshtatjen e produkteve standarde mbi bazën e specializimit nga subjektet publike dhe jopublike. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| 6. Shpërndarja e shërbimeve nën kujdesin e njësive të qeverisjes vendore, sipas ligjit të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore, politikave sociale dhe nevojave te PAK. | 6.1 Të krijohen ose të përshtaten struktura nga qendra në bazë, duke përfshirë edhe organet e pushtetit vendor, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve sociale për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| | 6.2 Kujdestaria dhe kujdesi për një person të afërt të bëhet alternativa e vërtetë kundrejt kujdesit institucional për PAK të rëndë. Pergatitje dhe trainim i kujdestareve per te verbrit dhe personat qe nuk degjojne. | 2005 e në vazhdim | MSH, MPÇS, SHSSH, MASH, OJF | Buxheti i shtetit, OJF, donatorë |
| ***V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit*** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të mundësohet ngritja e një institucioni shtetëror të veçantë në mbrojtje të të drejtave të PAK. | 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Të bëhet një studim për të gjithë legjislacionin që mbulon problemet e aftësisë së kufizuar, krahasuar me standardet dhe konventat ndërkombëtare. | 2005 - 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Të synohet hartimi i një ligji integral për aftësinë e kufizuar. | 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MTKRS, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Shëndetësisë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2. Të lehtësohen procedurat e trajtimit të PAK nëpërmjet përmirësimeve ligjore. | 2.1 Të përgatitet legjislacioni përkatës që standardet teknike për pajisjet e PAK si dhe standartet e pajisjeve didaktike për fëmijët, nxënësit dhe institucione shkollore. | 2006 | MASH, MSH, MPÇS, ISSH, SHSSH | Buxheti i shtetit, buxheti vendor ISSH |
| 3. Sigurimi i informacioneve, te dhënave për numrin e personave me aftesi te kufizuara, (PAK), llojet e AK, situaten social-ekonomike, programet mbështetëse, shërbimet etj. | 3.1 Krijimi dhe rifreskim i të dhenave statistikore për PAK.<br><br>3.2 Realizimi i studimeve periodike per PAK, llojet e AK, shërbimet ekzistuese, nevojat etj. | 2005<br><br>Çdo vit | MPÇS, MSH, INSTAT, MB, NJQV, OJF-të Institucionet akademike<br>INSTAT, MPÇS, MSH, OJF-të e AK. | Buxheti i shtetit dhe donatorët<br><br>Buxheti i shtetit, buxheti i njësive vendore, donatorë |
| 4 Mbështetje e programeve të kërkimit rreth çeshtjeve ekonomike, sociale, pjesëmarrjes etj, që prekin jeten e PAK dhe familjeve te tyre, llojet e AK, frekuencën, përshtatshmërine dhe efikasitetin e programeve ekzistuese, nevojat etj. | 4.1 Studime rreth llojit të AK, frekuencës, përhapjes gjeografike dhe masave për mbështetjen e tyre.<br><br>4.2 Publikimi i Listës se Aftësive të Kufizuara dhe Kategorizimin e tyre lidhur me kufizimet potenciale të mundësive sociale. | 2005-07, afatgjatë 2015<br><br>2006 e në vazhdim | MSH, OJF-të, Institutet<br><br>MASH, MPÇS, MSH, MB, NJPV, OJF | Donatorë, OJF<br><br>Buxheti i shtetit, Donatorë, OJF |
| 5. Përgatitje dhe shpërndarje sistematike e informacionit, në nivel kombëtar, rajonal e lokal, për AK. Sigurimi i aksesit të PAK në këtë informacion, përmes përshtatjes. | 5.1 Botimi i broshurave periodike me materiale në ndihmë të PAK dhe strukturave që trajtojnë ata, per rehabilitimin dhe integrimin; përmbledhje te legjislacionit me interes për PAK; të drejtat dhe lirite e tyre etj. | 1 herë në vit vazhdimisht | Institucionet , OJF-të | Institucionet, donatorë, OJF-të |

**PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA**

**Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **I. Përshtatshmëria e mjedisit** | | | | |
| 1.Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike dhe të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1.Të zbatohen parametrat e pershtatshmerise në 10% te apartamenteve te ndertuara me fondet e buxhetit te shtetit nga Enti Kombetar i Banesave. | 2005 - 2007 dhe 2007 - 2014 (çdo vit) | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Ne planifikimin e fondeve publike (infrastrukture e objekte sociale – rruge e mjedise publike, ne institucionet shendetesore, ne sherbime publike, ne shkollat e te gjitha niveleve) te perfshihen edhe fonde per elemente ndertimore qe garantojne heqjqn e barrierave (nenkalime, panduse, ashensore, vendqendrime, parapete, etj ) | 2007 - 2014 | MPPTT, MSH, MASH, MPÇS, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | a) Ne planifikimin e fondeve publike ( infrastrukture e objekte sociale ) te perfshihen edhe fonde per elemente ndertimore qe garantojne heqjen e barrierave per projektin pilot "Tirana pa barriera" | 2005 - 2007 | MPPTT, Bashkia e Tiranës | Donatorë, buxheti i bashkisë së Tiranës, buxheti i shtetit |
| | 1.3 Përshtatshmëria e mjeteve të transportit, duke filluar nga transporti urban në Tiranë dhe në transportin hekurudhor. | 2006 e në vazhdim | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë, NJPV |
| **III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe formimit profesional** | | | | |
| 1.Të përmirësohet dhe modernizohet procesi mësimor edukativ në shkollat speciale. | 1.1 Sigurimi i lehtësirave , si transport, etj. për fëmijët me Ak nga zonat më të largëta për të ndjekur shkollat speciale. | 2006 - 2010 | MASH/DA, NJPV, MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i veprimit për vitin 2006 - Ministria e Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **V Fusha e legjislacionit dhe kërkimit** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të përfshihet ne Ligjin " Për urbanistiken " që po hartohet, një nen që garanton pasqyrimin në projekte dhe integrimin normal dhe të garantuar të PAK në shoqëri. | 2005 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Të përmirësohet legjislacioni ekzistues për transportin, ku të merren në konsideratë heqja e barrierave në transport për PAK. | 2005 e në vazhdim | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Të përcaktohen standarde teknike për mjetet e transportit publik duke patur parasysh përshtatshmërinë e të gjitha tipeve të transportit për PAK në levizje dhe orientim. | 2005 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.4 Të rishikohet Kodi Rrugor dhe ligjet qe kanë të bëjnë me kushtet teknike për përdorimin e automjeteve, të modifikohen rregulloret dhe udhëzuesit teknikë për projektimin e rrugëve publike duke u bazuar në kërkesën dhe nevojat e PAK për një ambjent pa-barriera. | 2006 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.5 Të hartohet manual projekti qe të japë udhezime për vendosjen e lehtësirave në rrugë publike për PAK. Në aktet nënligjore, qoftë ato të amenduara apo ato të konceptuara nga fillimi. | 2005 - 2007 | MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plan i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe arsimit profesional.** | | | | |
| 1. Të sigurohet mbështetje për tërheqjen e PAK në veprimtaritë kulturore e sportive dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. | 1.1 Të bëhet evidentimi i qartë i nevojave dhe e numrit të PAK që përfitojnë nga lehtësirat që ofrohen në fushën e kulturës dhe të sporteve. | 2005 - 2006 | MTKRS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Të parashikohet një buxhet dhe kalendar i vecantë që të mundësojë zbatimin e ligjit për subvensionimin e aktiviteteve kulturore e artistike për PAK dhe organizatat e tyre. | 2005 - 2006 | MTKRS, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Sigurimi i financimit të programeve sportive publike të përbashkëta, për personat me dhe pa AK. | Çdo vit | MTKRS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |
| **V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit** | | | | |
| 1. Mbështjetje e programeve të edukimit kundër diskriminimit të PAK. | 1.1 Bashkëpunim me mediat për të ndërtuar një strategji të transmetimit të problematikës së AK, duke krijuar edhe alternativa për akses informacioni për PAK me probleme dëgjimi (gjuha e shenjave, titrat, orare të veçanta për problemet e AK, të drejtat e tyre, si një formë ndërgjegjësimi për median dhe publikun. | 2005 e në vazhdim | Strukturat shtetërore, OJF-të, Media | Donatorë, OJF, Media |
| | 1.2 Promovimi dhe inkurajimi i inisiativave të PAK. Organizimi i një panairi vjetor dhe panaire rajonale me punime të PAK. | Çdo vit | NJQV, OJF-të | Donatorë, buxheti i NJPV, OJF |
| | 1.3 Cmimi vjetor i nderit për si vleresim i punes në dobi të PAK. | Çdo vit | MPÇS | Buxheti i shtetit |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Brendshme + Pushteti Vendor

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **I. Përshtatshmëria e mjedisit** | | | | |
| 1. Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike dhe të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1 Në planifikimin e fondeve publike (infrastrukturë e objekte sociale – rrugë e mjedise publike, në institucionet shëndetësore, në shërbime publike, në shkollat e të gjitha niveleve) të përfshihen edhe fonde për elemente ndërtimore që garantojnë heqjen e barrierave (nënkalime, panduse, ashensorë, vendqëndrime, parapete, etj ) | 2007 - 2014 | MPPTT, MSH, MASH, MPÇS, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Çdo spital në nivel rajonal apo bashkie të sigurojë dhe të kompletojë mjedise të përshtatura sipas standardeve europiane, për trajtimin e PAK. | 2005 - e në vazhdim | MSH, NJQV | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë |
| | 1.3 Përshtatshmëria e mjediseve të 100 shkollave dhe 90 kopshteve. | 2004 - 2014 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.4 Përshtatja e mjediseve publike, qendrave të votimit, etj, të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të PAK në jeten shoqërore. | 2005 e në vazhdim | MB, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë |
| **II. Fusha e shërbimeve** | | | | |
| 1. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet perkatese publike e private i sherbimeve per PAK, ne perputhje me grupmoshat dhe nevojat per rehabilitim dhe integrim. | 1.1 Ngritje e shërbime të reja të përkujdesjes, si: ditore, në familje, strehëza, me synim që PAK të qëndrojnë sa më pranë mjedisit familjar ose në mjedise të ngjashme me familjen. | 2006 e në vazhdim | MPÇS, SHSSH, ISSH, NJPV | Buxheti i shtetit dhe i NJPV, donatorë, OJF |
| | 1.2 Pilotim i modeleve të reja të shërbimeve dhe vlerësim i efektshmërise dhe shtrirjes së tipeve të ndryshme të shërbimeve për PAK. | 2004 - 2007 | MPÇS, SHSSH, NJPV MSH, OJF Bashkia e Tiranës | Buxheti i shtetit, BB, donatorë, OJF, Bashkia e Tiranës. |
| | 1.3 Rishikim i kritereve dhe rregulloreve të institucioneve rezidenciale publike, për PAK dhe të moshuar, për të parashikuar masa për PAK të rëndë që nuk u sigurohet shërbimi pranë familjes. | 2006 e në vazhdim | MPÇS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, NJPV Donatorë, OJF |
| | 1.4 Të përcaktohen tarifa të diferencuara për sherbimet publike ndaj PAK. | 2005 - 2006 | NJPV | Buxheti i NJPV |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Brendshme + Pushteti Vendor

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2. Zbutja dhe riaftësimi i kufizimeve funksionale, fizike, psikike, sociale dhe ekonomike qe vijnë nga aftësitë e kufizuara, aksidentet apo sëmundjet për të siguruar integrimin e PAK në jetën e familjes dhe komunitetit. | 2.1 Krijim i strukturave nga qendra në bazë, përfshirë dhe njësite vendore, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, MB, MPÇS, MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |
| ***III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe formimi profesional*** | | | | |
| 1. Mundesimi i shkollimit per femijet me aftesi te kufizuara | 1.1 Mbështetje për transportin e fëmijeve me AK drejt shkollave rurale | 2006 - 2016 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 2. Krijimi dhe shtrirja graduale e shkollave e kopshteve te integruara. | 2.1 Të pilotohet ngritja e 12 kopshteve dhe 12 shkollave integruese në gjashtë qytete, qendra qarku, ku ka universitete, | 2004 - 2006 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2.2 Të plotësohen të gjitha qytetet dhe rrethet e mëdha me kopshte dhe shkolla të integruara, duke arritur në 100 shkolla dhe 90 kopshte të integruara. | 2006 - 2014 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 3. Të sigurohet mbështetje për tërheqjen e PAK në veprimtaritë kulturore e sportive dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. | 3.1 Të parashikohet një buxhet i vecantë që të mundësojë zbatimin e ligjit për subvensionimin e aktiviteteve kulturore e artistike për PAK dhe organizatat e tyre. | 2005 – 2006 | MTKRS, NJPV. | Buxheti i shtetit, donatore. |
| | 3.2 Të ketë një kalendar të veçantë për veprimtaritë sportive të PAK dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. | Çdo vit | MTKRS, NJPV, OJF. | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |
| | 3.3 Të rritet numri i veprimtarive zbavitëse për grupe të ndryshme PAK. Dhe kur është e mundur të kombinohet zbavitja e tyre me rehabilitimin. | 2005 e ne vazhdim | MTKRS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |
| | 3.4 Sigurimi i financimit të programeve sportive publike të përbashkëta, për personat me dhe pa AK. | Sipas kalendarit vjetor | MTKRS, NJPV | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Brendshme + Pushteti Vendor

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të mundësohet ngritja e një institucioni shtetëror të veçantë në mbrojtje të të drejtave të PAK. | 2005 - 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MB, MD, MF. | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Të bëhet një studim për të gjithë legjislacionin që mbulon problemet e aftësisë së kufizuar, krahasuar me standardet dhe konventat ndërkombëtare. | 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MTKRS, MB, MD, MF. | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.3 Të synohet hartimi i një ligji integral për aftësinë e kufizuar. | 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 2. Të lehtësohen procedurat e trajtimit të PAK nëpërmjet përmirësimeve ligjore. | 2.1 Të sigurohet baza ligjore për financimin e trajnimit të kujdestarëve të PAK të rëndë dhe të studiohet mundësia e sigurac ionit për kujdestarët . | 2006 | MPÇS, SHSSH, NJPV, ISKSH | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 3. Sigurimi i informacioneve, të dhënave për numrin e personave me aftësi të kufizuara (PAK), llojet e AK, situatën social-ekonomike, programe mbështetese, shërbime etj. | 3.1 Krijimi dhe rifreskimi i të dhënave statistikore për PAK. | 2005 | MPÇS, MSH, INSTAT, MB/NJQV, OJF-të Institucionet akademike | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 4. Mbështetje e programeve të kërkimit rreth çeshtjeve ekonomike, sociale, pjesëmarrjes etj, që prekin jeten e PAK dhe familjeve të tyre, llojet e AK, frekuencën, pershtatshmërine dhe efikasitetin e programeve ekzistuese, nevojat etj. | 4.1 Publikimi i Listës se Aftësive të Kufizuara dhe kategorizimi e tyre lidhur me kufizimet potenciale të mundësive sociale. | 2006 e në vazhdim | MASH, MPÇS, MSH, MB, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, donatorë, OJF-të |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Brendshme + Pushteti Vendor

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 5. Pergatitje dhe shperndarje sistematike e informacionit, ne nivel kombetar, rajonal e lokal, per AK. Sigurimi i aksesit te PAK, ne kete informacion, permes pershtatjes. | 5.1 Botimi i broshurave periodike me materiale në ndihmë të PAK dhe strukturave që trajtojnë ata, per rehabilitimin dhe integrimin; përmbledhje te legjislacionit me interes për PAK; të drejtat dhe lirite e tyre etj. | 1 herë në vit, i përvitshëm | Institucionet , OJF-të | Institucionet, donatorë, OJF-të |
| 6. Mbeshtjetje e programeve te edukimit kundër diskriminimit të PAK. | 6.1 Bashkëpunim me mediat për të ndërtuar një strategji të transmetimit të problematikes se AK, duke krijuar edhe alternativa për akses informacioni për PAK me probleme dëgjimi (gjuha e shenjave, titrat, orare të veçanta për problemet e AK, të drejtat e tyre, si një formë ndërgjegjësimi për MEDIA-n dhe publikun. | 2005 e në vazhdim | Strukturat shtetërore, OJF-të, MEDIA | Donatorë, OJF, Media |
| | 6.2 Promovimi dhe inkurajimi i inisiativave te PAK. Organizimi i një panairi vjetor dhe panaire rajonale me punime të PAK. | Çdo vit | NJQV, OJF-të | Donatorë, buxheti i NJPV, OJF |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Ministria e Drejtësisë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit** | | | | |
| 1. Të sigurohet barazia dhe të gjitha të drejtat e PAK nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale, të arsimimit, të strehimit, telekomunikacionit etj. | 1.1 Të mundësohet ngritja e një institucioni shtetëror të vecantë në mbrojtje të të drejtave të PAK. | duke filluar nga 2006 | MPÇS | Buxheti i shtetit, donatore |
| | 1.2 Të bëhet një studim për të gjithë legjislacionin që mbulon problemet e aftësisë së kufizuar, krahasuar me standardet dhe konventat ndërkombëtare. | 2005 - 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MB, MD, MF. | Buxheti i shtetit, donatore |
| | 1.3 Të synohet hartimi i një ligji integral për aftësinë e kufizuar.<br><br>Të drejtat dhe detyrimet mund të përfshihen në legjislacionin e përgjithshëm ose të mblidhen në një legjislacion të vecantë. Legjislacioni i vecantë për PAK mund të vendoset në disa mënyra:<br><br>a) Krijimi i një legjislacioni qe lidhet vetëm me çështje të aftësisë se kufizuar<br><br>b) Përfshirja e disa çështjeve të aftësisë se kufizuar brenda legjislacionit. | 2006 | MPÇS, MSH, MASH, MTKRS, MB, MD, MF | Buxheti i shtetit, donatore |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Bashkia Tiranë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **I. Përshtatshmëria e mjedisit** | | | | |
| 1. Të sigurohet jetesa pa pengesa për PAK, duke hequr gradualisht pengesat ekzistuese arkitektonike, urbanistike dhe të transportit dhe të parandalohet shfaqja e pengesave të reja. | 1.1 Në planifikimin e fondeve publike (infrastrukture e objekte sociale – rrugë e mjedise publike, në institucionet shëndetësore, në shërbimet publike, në shkollat e të gjitha niveleve) të përfshihen edhe fonde për elemente ndërtimore që garantojnë heqjqn e barrierave (nënkalime, panduse, ashensorë, vendqëndrime, parapete, etj ) | 2007 - 2014 | MPPTT, MSH, MASH, MPÇS, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 1.2 Në planifikimin e fondeve publike (infrastrukturë e objekte sociale) të përfshihen edhe fonde për elemente ndërtimore që garantojnë heqjen e barrierave për projektin pilot "Tirana pa barriera" | 2005 - 2007 | MPPTT, Bashkia e Tiranës | Donatorë, buxheti i Bashkisë së Tiranës, buxheti i shtetit. |
| | 1.3 Përshtatshmëria e mjediseve publike, qendrave te votimit, etj, per të siguruar pjesemarrjen e drejtpërdrejte të PAK | 2005 e në vazhdim | MB, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatore |
| | 1.4 Të punohet për përshtatshmerinë e mjeteve të transportit publik | duke filluar nga 2006 | Bashkia e Tiranës | Donatorë, buxheti i Bashkisë së Tiranës, buxheti i shtetit. |
| **II. Fusha e shërbimeve** | | | | |
| 1. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet perkatëse publike e private i shërbimeve për PAK, në përputhje me grupmoshat dhe nevojat për rehabilitim dhe integrim. | 1.1 Ngritje e shërbime të reja të përkujdesjes, si: ditore, në familje, strehëza, me synim që PAK të qëndrojnë sa më pranë mjedisit familjar ose në mjedise të ngjashme me familjen. | 2005 - 2006 e vazhdimisht | MPÇS/SHSSH, ISSH, NJPV | Buxheti i shtetit dhe i NJPV, donatorë, OJF |
| | 1.2 Pilotim i modeleve te reja të shërbimeve dhe vleresim i efektshmerise dhe shtrirjes se tipeve të ndryshme të shërbimeve per PAK. | 2004 ( pilotim ) - 2007 | MPÇS, SHSSH, NJPV MSH, OJF. Bashkia e Tiranës | Buxheti i shtetit, BB, donatorë, OJF, Bashkia e Tiranës |
| | 1.3 Rishikim i kritereve dhe rregulloreve të institucioneve rezidenciale publike, për PAK dhe të moshuar, për të parashikuar masa për PAK të rëndë që nuk u sigurohet shërbimi pranë familjes. | 2005- e në vazhdim | MPÇS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, NJPV Donatorë, OJF |
| | 1.4 Të përcaktohen tarifa të diferencuara për sherbimet publike ndaj PAK | 2005 - 2006 | NJPV | Buxheti i NJPV |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Bashkia Tiranë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| 2. Zbutja dhe riaftësimi i kufizimeve funksionale, fizike, psikike, sociale dhe ekonomike që vijnë nga aftësitë e kufizuara, aksidentet apo sëmundjet për të siguruar integrimin e PAK ne jeten e familjes dhe komunitetit. | 2.1 Krijim i strukturave nga qendra në bazë, përfshirë dhe njësitë vendore, për trajtimin e PAK dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme për ta. | 2005 e në vazhdim | MSH, NJPV, MB, MPÇS, MASH | Buxheti i shtetit, i NJPV, donatorë, OJF |
| ***III. Fusha e arsimimit, punësimit dhe formimi profesional*** | | | | |
| 1. Të përmirësohet dhe modernizohet procesi mësimor edukativ në shkollat speciale. | 1.1 Sigurimi i lehtësirave, si transport, etj. për fëmijët me AK nga zonat më të largëta për të ndjekur shkollat speciale. | 2006 - 2010 | MASH/DA, NJPV, MPPTT | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 2. Krijimi dhe shtrirja graduale e shkollave e kopshteve te integruara. | 2.1 Të pilotohet ngritja e 12 kopshteve dhe 12 shkollave integruese në gjashtë qytete, qendra qarku, ku ka universitete, | 2004 - 2006 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 2.2 Të plotësohen të gjitha qytetet dhe rrethet e mëdha me kopshte dhe shkolla të integruara, duke arritur në 100 shkolla dhe 90 kopshte të integruara. | 2006 - 2014 | MASH, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| 3. Të sigurohet mbështetje për tërheqjen e PAK në veprimtaritë kulturore e sportive dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. | 3.1 Të parashikohet një buxhet i vecantë që të mundësojë zbatimin e ligjit për subvencionimin e aktiviteteve kulturore e artistike për PAK dhe organizatat e tyre. | 2005 – 2006 | MTKRS, NJPV | Buxheti i shtetit, donatorë |
| | 3.2 Të ketë një kalendar të veçantë për veprimtaritë sportive të PAK dhe të lehtësohet pjesëmarrja e tyre në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. | Çdo vit | MTKRS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |
| | 3.3 Të rritet numri i veprimtarive zbavitëse për grupe të ndryshme PAK. Dhe kur është e mundur të kombinohet zbavitja e tyre me rehabilitimin. | 2005 e ne vazhdim | MTKRS, NJPV, OJF | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |
| | 3.4 Sigurimi i financimit të programeve sportive publike të përbashkëta, për personat me dhe pa AK. | Sipas kalendarit vjetor | MTKRS, NJPV | Buxheti i shtetit, njësive vendore, donatorë |

## PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUARA

### Plani i Veprimit për vitin 2006 - Bashkia Tiranë

| Objektivat | Masat | Afatet kohore | Institucioni zbatues | Mbulimi financiar |
|---|---|---|---|---|
| **V. Fusha e legjislacionit dhe e kërkimit** | | | | |
| 1. Të lehtësohen procedurat e trajtimit të PAK nëpërmjet përmirësimeve ligjore. | 1.1 Të sigurohet baza ligjore për financimin e trajnimit të kujdestarëve të PAK të rëndë dhe të studiohet mundësia e sigura-cionit për kujdestarët. | 2006 | MPÇS, SHSSH, NJPV, ISKSH | Buxheti i shtetit, buxheti vendor ISSH |
| 2. Sigurimi i informacioneve, te dhenave per numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet e AK, situatën social-ekonomike, programet mbështetëse, shërbimet etj. | 2.1 Krijimi dhe rifreskim i te dhenave statistikore per PAK.<br><br>2.2 Studime periodike lidhur me PAK, nevojat dhe sherbimet | 2006 e në vazhdim<br><br>Çdo vit | MPÇS, MSH, INSTAT, MB, NJQV, OJF<br><br>MPÇS, MSH, INSTAT, MB, NJQV, OJF | Buxheti i shtetit, donatorët<br><br>Buxheti i shtetit, donatorët |
| 3. Mbështetje e programeve të kër-kimit rreth çeshtjeve ekonomike, sociale, pjesëmarrjes etj, që prekin jetën e PAK dhe familjeve të tyre, llojet e AK, frekue-ncën, përshtatshmerinë dhe efikasitetin e programeve ekzistuese, nevojat etj. | 3.1 Publikimi i Listës se Aftësive të Kufizuara dhe kategorizimi i tyre lidhur me kufizimet potenciale të mundësive sociale. | 2006 e në vazhdim | MASH, MPÇS, MSH, MB, NJPV, OJF Institutet. | Buxheti i shtetit, donatorët, OJF |
| 4. Mbështjetje e programeve të edukimit kundër diskriminimit të PAK. | 4.1 Promovimi dhe inkurajimi i inisiativave të PAK. Organizimi i një panairi vjetor dhe panaire rajonale me punime të PAK. | Çdo vit | Institucionet, NJPV, OJF-të | Donatorë, buxheti i NJPV, OJF |

**Rekomandime**

Bazuar në vlerësimin e rezultateve të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara gjatë 2005, në prioritetet e vitit 2006 të përcaktuara në Planin Veprimit të SKPAK si dhe duke konsideruar edhe rezultatet e dala nga takimet dhe diskutimet me institucionet shtetërore dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile (si aktorët kryesorë përgjegjës për implementimin e SKPAK ), kanë dalë rekomandimet e mëposhtme :

- Përcaktimi i saktë dhe në kohën e duhur i buxheteve për të bërë të mundur realizimin e masave të përcaktuara në planin e veprimit të SKPAK. Ky është një nga prioritetet më kryesore që duhet të konsiderohet me kujdes nga cdo institucion përgjegjës, i cili duhet të parashikojë dhe të përfshijë një fond për aftësinë e kufizuar në planifikimin buxhetor të cdo viti.
  Rezulton që nuk ka patur parashikime buxhetore për vitin 2005 për objektivat dhe masat e përcaktuara në Planin e Veprimit dhe aktualisht shumë pak institucione kanë bërë parashikime për vitin 2006.

- Krijimi dhe funksionimi normal i strukturave monitoruese për implementimin e SKPAK. Ngritja e kapaciteteve të këtyre strukturave, shtrirja e tyre në të gjitha nivelet qëndrore dhe lokale, është një nga prioritetet, moszbatimi i të cilit pengon implementimin e SKPAK.
  Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta realizoi, nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 196, dt. 12.12.2005, ngritjen e Këshillit Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar, si një nga prioritetet e Strategjisë. Eshtë e rendësishme që kjo strukture të shtrihet dhe forcohet deri në nivel lokal. Krahas ngritjes së Këshillit Kombëtar, është i rëndësishëm funksionimi dhe fuqizimi i Sekretariatit Teknik të tij. Eshtë diskutuar gjerë për këtë problem gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të SKPAK. Në ndryshim me atë që është parashikuar në Strategji, shoqëria civile vazhdon të insistojë në kërkesën që kjo strukturë të mos funksonojë pranë SHSSH, por pranë Presidencës ose Këshillit të Ministrave. Ngritja e kapaciteteve në të gjitha institucionet e linjës përbën një prioritet të një rëndësie të veçantë në situatën aktuale të zhvillimit të strukturave dhe burimeve njerëzore në të gjitha institucionet shtetërore.

- Rishikimi dhe studimi i legjislacionit të aftësisë së kufizuar, në përputhje me standartet dhe konventat ndërkombëtare, për të mundësuar hartimin e një ligji integral për AK, mbetet një prioritet që do të mundësojë zgjidhje të qëndrueshme në fushën e të drejtave të AK, duke shmangur diskriminimin dhe zgjidhjet e pjesëshme. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 195, dt. 12.12.2005, ngriti grupin e punës që do të analizoje ligjin ekzistues dhe do të përgatisë rekomandimet përkatëse.

Në prioritet tjetër i një rëndësie të vecantë është rishikimi dhe ristrukturimi i komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe procedurave përkatëse.
Prioritetet për vitin 2006, të specifikuara për cdo institucion, janë të domosdoshme për t'u zbatuar me qëllim realizimin e një jetese pa barriera për PAK, edukimin, trajnimin professional dhe punësimin e tyre,

shërbimet mjekësore dhe shoqërore si edhe ngritjen e kapaciteteve, realizimin e kerkimeve dhe ndërhyrjeve në legjislacion.

Por nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme që shoqëria civile, e cila ka dhënë prova gjatë procesit të miratimit të Strategjisë që është në gjendje të marrë pjesë, të ofrojë ekspertizë, të advokojë për të drejtat e PAK, të vazhdojë fushatat e  avokatisë e  lobimit në nivel qendror e lokal me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së procesit për arritjen e përmirësimit të jetesës së PAK në Shqipëri.

Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit institucione - shoqëri civile, por njëkohësisht edhe forcimi i pozicionit të oponencës që shoqëria civile duhet të kete gjate gjithë procesit, duhet të jenë elementë dominues për të patur arritje pozitive.

Dokumenti i  Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara duhet të  shoqërohet vazhdimisht nga procesi i rishikimit e përmirësimit, bazuar në eksperiencën që do të fitohet gjatë zbatimit të saj dhe duke iu përgjigjur zhvillimeve të përgjithshme progresive shoqërore që do të duhet të pasqyrohen në të.

## Konferenca e Parë Ministrore për Aftësinë e Kufizuar

Më datë 30 Qershor 2006 u mbajt në Tiranë Konferenca e Parë Ministrore për Aftësinë e Kufizuar e organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri.

Qëllimi i kësaj Konference ishte analiza njëvjetore e progresit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara (SKPAK), evidentimi i problemeve dhe nevojave për angazhimin institucional në nivel qendror e vendor si dhe të aktorëve të tjerë për zbatimin e kësaj Strategjie.

Në këtë Konferencë mori pjesë Zëvendëskryeministri z. Ilir Rusmali, në funksionin e Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, i themeluar së fundmi. Gjithashtu në konferencë morën pjesë ministrat e linjës që kanë detyrime të drejtpërdrejta për zbatimin e objektivave të SKPAK, si dhe përfaqesues të organizatave të huaja dhe të organizatave të fushës së aftësisë së kufizuar.

**Konferenca u hap nga z.Koço Barka,**
**Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.**

Ministri Barka falënderoi Zv.Kryeministrin Rusmali, si dhe kolegët Ministra dhe Ambasadorin e Prezencës së OSBE në Shqipëri z.Pavel Vacek për mbështetjen e dhënë në procesin e hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Z.Barka gjithashtu falënderoi të gjitha organizatat që punojnë me PAK, për kontributin e tyre thelbësor përgjatë këtij procesi.

Duke vazhduar më tej, z.Barka theksoi se shoqëria në tërësi dhe institucionet në vecanti, janë angazhuar për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe morale në mënyrë që Personat me Aftësi të Kufizuara të mos shihen si grup i veçantë i shoqërisë por si pjesë e natyrshme e saj.

Shteti dhe shoqëria janë obliguar të projektojnë dhe ndërtojnë një mjedis të përshtatur, të sigurojnë akses dhe shërbime sociale dhe shëndetësore, të planifikojnë arsimin gjithpërfshirës dhe punësimin sipas ligjit, të garantojnë strehim në përputhjet me nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë informacion dhe komunikim të përshtatshëm. Tashmë këto synime janë parashikuar në Strategjinë e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të gjithë së bashku po punojmë për realizimin e tyre.

MPÇSSHB, si institucioni që drejtoi proçesin e hartimit të Strategjisë së PAK tashmë ka marrë të gjitha përgjegjësitë për të ndjekur proçesin e zbatimit të objektivave të kësaj strategjie. Ministri Barka informoi të pranishmit lidhur me Urdhrin e Kryeministrit nr 196 dt. 12.12.2005, me të cilin u ngrit Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar dhe Sekretariati Teknik për Personat me Aftësi të Kufizuara. Sekretariati përbëhet nga tre punonjës, njeri prej tyre është përzgjedhur të jetë PAK, i cili do të përcjellë në mënyrë të

natyrshme të gjitha shqetesimet dhe zgjidhjet që PAK mendojnë për të përmiresuar jetën e tyre.

Sekretariati do të monitorojë zbatimin e Strategjisë nga institucionet që ngarkohen me detyra prej saj si ministritë e linjës dhe strukturat e varësisë, njësite e qeverisjes vendore, qarqet, bashkitë, komunat etj. Sekretariati ka krijuar rrjetin e tij të pikave të kontaktit, në të gjitha ministritë, dikasteret qendrore, dhe ndërkohë do të vazhdojë të krijojë pika kontakti edhe në njësitë e qeverisjes vendore dhe aktorët e tjerë përgjegjës.

Sekretariati Teknik për PAK, do të mbështesë veprimtarinë e Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, do të përgatisë mbledhjet dhe do të formulojë materialet e nevojshme për këtë Këshill. Mbledhja dhe përpunimi i informacioneve për PAK mbetet padyshim një nga prioritetet e Strategjisë, pasi vetëm kështu MPÇSSHB, krijon mundësi për ndërhyrje dhe për të zgjidhur problemet që kanë aktualisht PAK.

Ministri Barka u shpreh se PAK tashmë shihen si njëri nga prioritetet e punës së Qeverisë. Kjo ishte arsyeja që Aftësia e Kufizuar, për vitin 2006, ka në dispozicion 16% më shumë fonde se një vit më parë. Gjatë këtij viti, Ministria e Punës ka vlerësuar në mënyrë të vazhduar kërkesat e ardhura nga personat me aftësi të kufizuara. Janë marrë parasysh mjaft nga kërkesat që lidhen me përmirësime ligjore, strukturore, me zbatimin e detyrimeve nga statuset aktuale të PAK, në përputhje me mundësitë e buxhetit të shtetit.

Në mbyllje Ministri Barka, nënvizoi se përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Plani i Veprimit i Strategjisë së PAK, do të jetë një prioritet i punës së Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Më pas z. Barka ja dha fjalën z. Rusmali, Zëvendëskryeminištër.

### Z.Ilir Rusmali, Zëvendëskryeminištër

Z.Ilir Rusmali, Zëvendëskryeminištër dhe Kryetar i Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, pasi falënderoi Ministrat, Ambasadorin Vacek dhe pjesëmarrësit në konferencën e parë ministrore për aftësinë e kufizuar, vlerësoi organizimin e kësaj konference dhe shprehu angazhimet e Qeverisë dhe të ministrive për implementimin e kësaj Strategjie.

Në programin e Qeverisë, theksoi Zv.Kryeministri Rusmali, ekziston dëshira dhe angazhimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Personave me Aftësi të Kufizuara, në perputhje me standardet evropiane të sherbimeve sociale për këtë kategori. Shteti dhe shoqëria angazhohen për realizimin e të drejtave për Personat me Aftësi të Kufizuara, njëlloj si për të gjithë qytetarët e tjerë.

Gjatë kësaj periudhe Qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë në përmirësimin e legjislacionit që garanton arsimim më të mirë për personat me aftësi të kufizuara, janë hequr pagesat suplementare në kuotat dytësore. Janë ofruar shpërblime për PAK, shpërblimi i fundvitit, kuotat financiare për veshmbathje për fëmijët në arsimin special, si dhe reduktimi i kostos së aktiviteteve të tyre kulturore, vizitat në muzeumet publike.

Zv.Kryeministri Rusmali informoi të pranishmit se para disa muajve janë miratuar standartet e përgjithshme të shërbimeve shoqërore dhe standartet e shërbimeve për fëmijët në institucionet rezidenciale, të cilat do të sigurojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre kategorive.

Z. Rusmali trajtoi në hollësi rolin e Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar. Ai informoi të pranishmit se në muajin dhjetor të vitit 2005 me urdhër të Kryeministrit është ngritur Këshilli Kombëtar për Çështjet e Aftësise së Kufizuar, si organi më i lartë politikbërës në fushën e aftësisë së kufizuar.

Keshilli Kombëtar do të mbështesë instucionet e ndryshme në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej Strategjisë Kombëtare dhe do të paraprijë me politika për integrimin social të personave me aftësi të kufizuara, në jetën shoqërore. Ngritja e këtij Këshilli është një hap i rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të konventave nderkombetare dhe Kushtetutës së Shqipërisë. Misioni i Këshillit reflekton rregullat dhe standardet e Organizates së Kombeve të Bashkuara për pjesmarrjen e plotë dhe barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuara.

Më tej Zv. Kryeministri Rusmali theksoi se prioritetet kryesore të Këshillit Kombëtar janë:

- Të përcaktojë politikat për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për aftësinë e kufizuar, ta monitorojë dhe vlerësojë atë.
- Të bashkërendojë programet dhe shërbimet për AK duke siguruar qëndrueshmërinë e zbatimit të Strategjisë në kuadrin afatgjatë duke përputhur SKPAK me strategjinë e re të zhvillimit dhe integrimit.
- Të lehtësoje zhvillimin e politikave për AK në programet e ministrive dhe të ndjekë zbatimin e tyre.
- Të minimizojë dublikimet e sherbimeve dhe të sigurojë shpërndarjen gjeografike të tyre.
- Të lehtësojë informimin dhe nxitjen e mëtejshme të praktikave të mira që ekzistojne në vend për të nxitur ndryshimin social.
- Të fuqizojë kapacitetin pjesëmarrës të PAK në hartimin dhe monitorimin e politikave për AK në nivel kombëtar.
- Të identifikojë nevojat për shërbim në nivel kombëtar dhe të formulojë rekomandimet për të gjithë sektorin qeveritar.
- Të shërbejë si pikë fokale ku organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare të marrin informacion për AK në Shqipëri dhe të nxisë fushatat ndërgjegjësuese për të drejtat dhe vlerat e PAK.

Në mbyllje të fjalës së tij z. Rusmali falënderoi të gjithë aktorët në fushën e aftësisë së kufizuar për angazhimin dhe kontributin e dhënë në procesin e hartimit dhe tashmë edhe për zbatimin e Strategjisë së PAK.

### Ambasadori Pavel Vacek, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Ambasadori Pavel Vacek, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, përshëndeti Zv.Kryeministrin Rusmali, Ministrin Barka, Ministrat dhe të pranishmit, dhe përgëzoi Qeverinë e Shqipërisë për angazhimin dhe progresin e arritur në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Në mënyrë të veçantë, z. Vacek përgëzoi Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për përgjegjësinë që mori përsipër për hartimin e kësaj strategjie dhe angazhimin për zbatimin e saj.

Ambasadori Vacek vlerësoi, midis të tjerash, hapat pozitivë të ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë në zbatim të Strategjisë Kombëtare të PAK, si: (i) Krijimin e Këshillit Kombëtar për Çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara; (ii) Krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar si dhe (iii) Përpjekjet e Qeverisë për të përcaktuar prioritete qeveritare në zbatimin e SKPAK. Ambasadori Vacek e konsideroi si tepër të rëndësishme pjesëmarrjen e organizatave të shoqerise civile në diskutimin e prioriteteve të kësaj strategjie.

Ambasadori Vacek informoi të pranishmit lidhur me mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri për hartimin e SKPAK gjatë vitit 2004, nëpërmjet mundësimit të asistencës teknike gjermane. Në dhjetor të vitit 2005, Prezenca e OSBE vazhdoi mbështetjen për zbatimin e SKPAK duke kontraktuar znj.Bardhylka Kospiri, për të punuar me ministritë e linjës për përcaktimin në detaj të prioriteteve të zbatimit të kësaj strategjie. Për vitin 2006, në mbështetje të zbatimit të SKPAK, OSBE do të mundësojë buxhetimin e planit të veprimit të SKPAK, si dhe konsulencën për zhvillimin organizativ të mekanizmit të monitorimit të SKPAK. Kohët e fundit Prezenca e OSBE ka mbështetur Këshillin Kombëtar të Organizatave të Personave të Aftësisë së Kufizuara nëpërmjet një donacioni kompjuterash, në mënyrë që të fuqizojë koordinimin dhe kontributin e shoqërisë civile në zbatimin e kësaj strategjie të rëndësishme kombëtare.

### Z. Genc Pollo, Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Në fjalën e tij z. Genc Pollo, Ministër i Arsimit dhe Shkencës, pasi falënderoi Zv.Kryeministrin Rusmali, Ambasadorin Vacek, kolegët Ministra dhe pjesemarrësit e tjerë në Konferencë, theksoi se objektivi kryesor në fushen e arsimit për PAK, është shtrirja graduale e arsimit gjithpërfshirës, përmirësimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre në qendra burimore për arsimin e zakonshëm.

Synimi i Ministrise është që institucionet ku arsimohen PAK të mos mbeten të veçuar, por të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në institucionet arsimore të përgjithshme. Ministri informoi për shtrirjen e shërbimit psikologjik nëpër shkolla, i cili ka në vëmendjen e tij PAK dhe personat e tjerë në nevojë.

Ministri Pollo siguroi të pranishmit se në standartet e ndërtimit të shkollave të reja dhe të atyre që do të restaurohen, po mbahet parasysh edhe përshtatshmëria ndërtimore për nxënësit me AK. Po ashtu po punohet për krijimin e një strukture njerëzore të aftë për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të PAK. Në çdo drejtori rajonale apo zyrat arsimore, janë vendosur specialistë që mbulojnë problemet e arsimit special. Hartimi i një kurrikulumi të integuar të shkollës së zakonshme synon edhe favorizimin e proçeseve gjith-

përfshirës dhe perfshirjen me të madhe të PAK në sistemin arsimor.
Ministri Pollo u shpreh se së shpejti do të rishikohen dispozitat normative, që kanë të bëjnë me fushën e arsimit special. Bazuar në aftësitë dhe mundësite konkrete të çdo fëmije, Ministria e Arsimit ka mundësuar regjistrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat artistike dhe profesionale.

Sipas Ministrit Pollo, në Insitutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, nga 1963 deri në vitin që shkoi, kanë mbaruar arsimin e detyruar 122 nxënës, nga të cilët 40% kanë vijuar dhe mbaruar arsimin e lartë. Në këtë vit shkollor me një urdhër të veçantë kanë shkuar në shkollat e mesme pa konkurim 10 nxënës të verbër dhe 2 persona që nuk dëgjojnë.

Ministri Pollo informoi gjithashtu për miratimin e një VKM për uljen e tarifave të shkollimit për arsimin e lartë, kuotat dytësore, për personat që nuk shikojnë, për paraplegjikët. Ai u shpreh se po studiohet mundësia për reduktimin në zero të të gjitha tarifave të shkollimit për këtë kategori.

Në mbyllje të fjalës se tij, Ministri Pollo informoi të pranishmit se MASH po përgatit kushtet që në shtator të këtij viti të pilotohen 12 kopshte dhe 12 shkolla integruese në 6 qytete dhe qendra qarku ku ka universitete. MASH është duke hartuar një platformë për trajnimin e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave ku do të pilotohet të mësuarit e integruar dhe masat e tjera përkatëse për këtë qëllim.

**Znj. Arenca Trashani, Ministre e Integrimit**

Ministrja e Integrimit znj. Arenca Trashani, përgëzoi organizatorët e konferences dhe u shpreh se tashmë Republika e Shqipërisë është pjesë e një sërë dokumentash ndërkombëtare të rëndësishëm, të cilat janë ratifikuar nga Parlamenti shqiptar dhe puna ka nisur për implementimin e tyre.

Ministrja Trashani u shpreh se harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE dhe zbatimi i tij në favor të PAK do të jetë një nga prioritetet e Ministrisë së Integrimit. Kjo Ministri është koordinuesja, monitoruesja, raportuesja e progresit të përafrimit të legjislacionit dhe ky proces është një nga shtyllat kryesore të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Ministrja Trashani u shpreh se Ministria e Integrimit ndan me të gjithë kabinetin qeveritar dhe në të njëjtën kohë, me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm në këtë proçes të integrimit, sensibilitetin e madh ndaj PAK, dhe shpreh predispozicionin e saj për të integruar në legjislacionin shqiptar standartet evropiane, me të cilët, të gjithë shtetet anëtarë të BE, trajtojnë këtë grup përfituesish.

Së fundi, Ministrja Trashani siguroi se Zyra për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Integrimit do të trajtoje me vemendje çështjet e PAK duke e parë angazhimin e saj në këtë fushe si një kontribut të rëndësishëm për integrimin e vendit.

**Z. Jemin Gjana, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Z. Jemin Gjana, theksoi se vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet jo vetëm PAK, por edhe familjarëve të tyre. Më tej ai theksoi se personat me aftësi të kufizuara në zonat rurale dhe zonat e largeta malore, që jetojne në kushtet e varferise, vuajnë mungesen e shërbimeve sociale.

Ministri Gjana tërhoqi vëmendjen e pjesëmarrësve lidhur me nje grup specifik të personave me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për mbështetje, sic jane viktimat nga minat dhe armët, të aksidentuar gjatë vijës kufitare me Kosovën dhe kërkoi që ky grup të mbeshtetet me projekte konkrete nga të gjithe aktoret përgjegjës, që operojnë në këtë fushë.

**Znj.Marjeta Zaçe, Zv.Ministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**

Zv.Ministrja e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, znj.Marjeta Zaçe, theksoi se pas miratimit të Strategjisë, Ministria bashkëpunoi me OSBE për botimin e Strategjisë dhe për njohjen e saj nga të gjitha strukturat dhe aktorët në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet konferencave, tavolinave të rrumbullakta, takimeve të ndryshme, si dhe seminareve rajonale.

Gjate kësaj kohe, Ministria e Punës punoi për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik për PAK. Në fund të vitit 2005, Sekretariti përgatiti prioritetet e vitit 2006, të cilat ju dërguan ministrive të linjës, për t'i përfshirë në planet dhe buxhetin e tyre për vitin 2006.

Znj.Zaçe vuri në dukje se për personat me aftësi të kufizuara, për vitin 2006 jane akorduar 7.1 miliardë lekë për invalidët e punës, invalidët para dhe tetrapelgjike, si PAK mendorë e fizikë. Ndërkaq janë ngritur shërbime të reja sociale për PAK me mbështetjen e Projektit "Shpërndarja e shërbimeve sociale në komunitet" për PAK në 8 qarqe të vendit.

Zv.Ministrja Zaçe informoi se për PAK janë zgjeruar hapësirat e përfitimit, kështu: (i) PAK përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar pavarësisht nga mosha, pra hiqet kufiri i moshës deri në 21 vjeç, që ka ekzistuar deri tani; (ii) Të gjithë PAK që sipas vendimit të Komisionit Mjekësor kanë nevojë për shërbimin e një kujdestari, këtej e tutje do ta përfitojnë atë edhe në rastet kur familja nuk është përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike; (iii) Për invalidët para dhe tetraplegjikë zgjerohet fusha e përfitimit dhe për ata persona që janë bërë të tillë pavarësisht shkakut të dëmtimit.

Znj.Zaçe përfitoi nga rasti të kërkonte një angazhim më të madh nga përfaqësuesit e ministrive për zbatimin e objektivave të Strategjisë dhe për marrjen e masave për të raportuar progresin e tyre pranë Sekretarit Teknik për PAK në Ministrine e Punës.

Zv.Ministrja Zaçe u shpreh se përveç 6 qendrave rezidenciale publike të zhvillimit për PAK, një kontribut të madh në ofrimin e sherbimeve për PAK japin edhe organizatat jofitimprurëse. Ato janë përfshirë edhe në

ngritjen e shërbimeve të reja në bashkëpunim me strukturat lokale, në katër qarqe pilot, sipas projektit të Bankës Boterore. Faza e dytë e këtij projekti mbështeti edhe disa shërbime të reja, për personat me aftësi të kufizuara.

Zv. Ministrja Zaçe informoi se është përgatitur një projekt-VKM, ku përveç indikatorëve për vlerësimin e varfërisë dhe të programeve të tjera të mbrojtjes sociale, janë përcaktuar tregues të detajuar për personat me aftësi të kufizuara, të cilët do të shërbejnë për vlerësimin e problematikës reale të kësaj kategorie dhe formulimin e politikave të reja për mbështetjen e tyre.

Në mbyllje znj.Zaçe theksoi se Sekretariati Teknik, i ngritur pranë Ministrise së Punës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së PAK, do të përpunojë periodikisht indikatorët e progresit dhe do të dërgojë analiza dhe vlerësime, rekomandime për përmirësimin e politikave dhe legjislacionit për PAK në Këshillin Kombëtar për Çeshtje të Aftësisë së Kufizuar.

**Znj.Zamira Sinoimeri, Zv.Ministre e Shendetesisë**

Znj.Zamira Sinoimeri, Zv.Ministre e Shëndetësisë, i renditi problemet e PAK ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë. PAK në Shqipëri përbëjnë rreth 2.7 % të popullsisë. Por kjo shifër ka prirje në rritje. Kështu në vitin 2005 rreth 0.8% e fëmijëve ose rreth 307-310 fëmijë nga numri total i fëmijëve ka lindur me anomali kongjenitale. Një fenomen tjetër me të cilin perballet Shqipëria, jane traumat dhe aksidentet në rritje, që arrijne deri në 400 për 100 mijë banorë të shtruar në spitale.

Znj.Sinoimeri u ndal në reformën që po ndërmerret në spitalet psikiatrike. Kështu nga 840 persona të shtruar në keto spitale, vetëm 50% janë të sëmurë kronikë, ndërsa të tjerët kërkojnë shërbime alternative të cilat janë parashikuar në strategjitë e Ministrisë së Shëndetësisë. Për shëndetin mendor po punohet për: (i) krijimin e shërbimeve moderne të shëndetit mendor dhe (ii) ngritjen e shërbimeve të rehabilitimit fizik të tyre. Ndërkaq po punohet për rajonalizimin dhe decentralizimin e sherbimit shendetsor.

Znj.Sinoimeri informoi të pranishmit se PAK po adresohen në tre drejtime: (i) Për krijimin e një programi për trajtimin multidisiplinor të PAK; (ii) Zgjerimin e shërbimeve të riaftësimit veçanërisht për fëmijët dhe adoleshentët; (iii) Përmirësimin e asistencës në lindje, duke startuar një program për reanimacionin e të porsalindurve; (iv) Krijimin e kabineteve të riaftësimit, në 12 spitale, ku do të synohen standartet evropiane.

Zv.Ministrja Sinojmeri i siguroi organizatat e AK se Ministria e Shëndetësisë do të ofrojë jo vetëm bashkëpunim institucional, por do të kerkoje edhe mbështetjen e qeverisë për të rritur përqindjen e buxhetit për këtë kategori, ashtu siç edhe do të koordinojë punën për sensibilizimin e donatorëve.

**Znj.Suzana Turku, zv.Ministre e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**

Znj.Suzana Turku, zv.Ministre e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, theksoi se shkalla e perfshirjes dhe integrimit të PAK në shoqëri është një tregues mjaft domethënës i qyteterimit të saj. Në këtë kuadër, MKRTS ka mbështetur një numër projektesh, artistike, kulturore, sportive, me pjesëmarrjen e PAK, aktivitete të cilat do të mbeten prioritet i programeve të ministrisë, për zbatimin e Strategjisë në vitet 2006 – 2010.

Znj.Turku informoi të pranishmit se ministria po merr masa që në hotelet e kategorisë së lartë të garantohet mundësia e lëvizjes për PAK, sipas standarteve të hoteleve me vendet e tjera. Gjithashtu do të mbështetet TOB-i, TK, Pallati i Sportit, stadiumet për të krijuar lehtësirat e nevojshme në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e PAK në veprimtarite kulturore dhe sportive. Në planet e MKRTS është dhe organizimi i festivalit të këngës dhe të recitimit të të rinjve me AK, i cili do të zhvillohet në kuadrin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë.

Në mbyllje znj.Turku premtoi se MKRTS në zbatim të Strategjisë Kombëtare të PAK, dhe në bashkëpunim të plotë me organizatat jofitimprurëse, do të bëjë të mundur që të publikohen në mënyrë sistematike, aktivitetet e planifikuara artistike, kulturore dhe sportive, për personat me aftësi të kufizuar, për të mundësuar një pjesëmarrje sa më të madhe të tyre në shoqeri.

**Z.Stavri Ristani, Zëvendësministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**

Z.Stavri Ristani, Zëvendësministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, informoi të pranishmit në lidhje me vështirësitë për lëvizjen e lirë të PAK. Në sektorin e punëve publike, dhe në atë të transportit, nuk është bërë aq sa duhet në drejtim të zbatimit të parimit të jetesës pa barriera të PAK, megjithëse, në sajë të një bashkëpunimi me disa organizata të AK është miratuar një VKM për rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për këtë kategori personash. Z.Ristani u shpreh se MPPTT, është e angazhuar të implementoje këto vendime dhe obligimet e tjera që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për PAK për të garantuar një jetesë pa barriera për këtë kategori.

Z.Ristani informoi të pranishmit se në formatin e lejes së veprimtarisë së çertifikatës së mjeteve të transportit të udhëtarëve, është pasqyruar detajimi dhe detyrimi i shoqërive të transportuesve, të udhëtarëve ndaj kategorise se PAK. Në kuadrin e planit të mësipërm, MPPTT ka programuar një sërë detyrash për zbatimin e kësaj strategjie, të cilat kanë të bëjnë me përshtatjen e infrastrukturës, sinjalistikës, ndërtimeve urbane, dhe tregon angazhimin e saj në përmbushjen e normave evropiane. Ministria ka filluar hartimin e ligjit të ri të urbanistikës, si dhe përshtatjen e standarteve e kodeve të projektimit me standartet e kodeve evropiane.

Zv.Ministri Ristani tha se tashmë është bërë një metodë pune që të gjithë ndryshimet në legjislacion të kalojnë testin e diskutimeve nëpërmjet përfshirjes së të gjithë palëve të interesuara dhe të grupeve të interesit. Në përmbyllje të fjales së tij, Zv.Ministri Ristani u shpreh se MPPTT do të marrë përsipër të gjitha përgjegjësite e saj për të rritur aksesin e PAK në shërbime.

**Z. Sherefedin Shehu, Zëvendësministër i Financave**

Z. Sherefedin Shehu, Zëvendësministër i Financave, informoi të pranishmit se mbështetja financiare për PAK ka ardhur në rritje. Ai theksoi se në buxhetin e vitit 2006, kjo mbështetje është rritur më shumë se në të gjitha buxhetet e viteve të mëparshëm dhe në të ardhmen do të mbulohen më mirë me buxhete të gjitha kategoritë në nevojë.

Zv.Ministri Shehu siguroi të pranishmit se MF do të bëjë të mundur përdorimin më mirë të fondeve të dispozicion të PAK. Njëkohësisht MF do të nxisë edhe komercializimin shërbimeve për PAK, me qëllim që shteti të jetë një partner i rëndësishëm në këtë proçes, duke inkurajuar edhe mbështetjen nga ana e biznesit.

Sipas z.Shehu, Ministria e Financave do të marrë të gjitha përgjegjësitë lidhur me krijimin dhe monitorimin e standardeve të shërbimit, të kompensimit financiar dhe të formave të tjera të mbështetjes së kësaj shtrese të popullsisë. Brenda këtyre standarteve, Ministria e Financave do të nxisë pjesëmarrjen e të gjithë faktorëve të tjerë dhe sidomos të biznesit, edhe pse përgjegjësia për garantimin dhe përmirësimin e standardeve gjithmonë do të mbetet e shtetit.

**Z.Ndrek Ismailaj, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Organizatave të Aftësisë së Kufizuar**

Z.Ndrek Ismailaj, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Organizatave të Aftësisë së Kufizuar, informoi pjesëmarrësit lidhur me krijimin e Këshillit Kombëtar të Organizatave të AK, i cili përbëhet nga 5 organizata kombëtare që përfaqesojnë interesat e komunitetit të PAK. Aktualisht në këtë Keshill aderojnë: Shoqata e Personave që nuk Dëgjojnë, Shoqata e të Verbërve të Shqiperisë, Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë, Shoqata e Invalidëve të Punës dhe Shoqata Në Ndihmë të Handikapëve Mendorë.

Z.Ismailaj u shpreh se Këshilli i Organizatave të PAK i vlerëson prioritetet e Qeverisë për PAK. Ai theksoi se sfidat kryesore lidhen me trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të PAK, rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, e cila mund të arrihet nëpërmjet bashkërendimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile. Z.Ismailaj u shpreh se Keshilli Kombetar i Organizatave të PAK respekton parimin e pluralizmit dhe ekzistencës së çdo lloj organizimi të motivuar nga bindje apo interesa, por gjykon se është i dëmshem kaosi aktual brenda organizatave të PAK. Për këtë arsye, Këshilli propozon që: (i) Qeveria të vendosë në themel të politikave të saj parimin e përbotshëm "Asgjë për ne pa ne"; (ii) Të mbështesë partneritetin me organizatat Kombëtare të AK duke nxitur krijimin e organizatave kombëtare të atyre kategorive që kanë vështirësi për t'i krijuar; (iii) Të konsiderojë të dëmshëm çdo qëndrim subjektiv të administrates që mund të çojë në përçarjen e këtyre organizatave.

Z.Ismailaj propozoi që Qeveria të pranojë si anëtarë në Këshillin Kombëtar të Aftësisë se Kufizuar të drejtuar nga zv.Kryeministri vetëm organizatat kombëtare që përfaqësojnë interesat e komuniteteve të PAK, duke e rritur numrin e tyre nga 4 në 5 me qëllim që në këtë Këshill të përfshihen edhe Shoqata e Personave që nuk Dëgjojne dhe ato të PAK Mendorë. Z.Ismailaj e mbylli fjalen e tij duke garantuar se organizatat e personave me aftësi të kufizuara do të jenë kurdoherë partnerë konstruktivë me Qeverinë.

**Bardhylka Kospiri, Konsulente e OSBE**

Znj.Bardhylka Kospiri, Koordinatore e Programit të Avokatisë FSHDPAK dhe Konsulente e OSBE për mbështetjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, theksoi se puna për zbatimin e Strategjisë se PAK ka rifilluar pas zgjedhjeve të 3 Korrikut të vitit 2005, kur Qeveria e re mori përsipër të mbështesë angazhimet e qeverisë së mëparshme, si dhe të përballet me sfidat e problematikës së aftësisë së kufizuar në Shqipëri.

Znj.Kospiri u shpreh se ndryshimet strukturore në institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë diktuan në fund të vitit 2005 nevojën e ndërhyrjeve për: (i) ritheksimin edhe një herë të prioriteteve për vitin 2006, të çdo institucioni pergjegjës dhe (ii) ribotimin dhe shpërndarjen e dokumentit të Strategjisë.

Në këtë proces, znj. Kospiri vlerësoi mbeshtetjen e OSBE, e cila ka luajtur një rol aktiv në përgjatë hartimit dhe miratimit të Strategjisë.

Më tej znj. Kospiri vlerësoi punën e MPÇSSHB dhe Qeverisë për: (i) Ngritjen e Këshillit Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar, si një nga prioritetet e Strategjisë dhe më tej, Sekretariatin Teknik të tij dhe (ii) Ngritjen e grupit të punës që do të analizojë legjislacionin ekzistues në fushën e aftësisë së kufizuar dhe do të përgatisë rekomandimet përkatëse.

Znj.Kospiri shprehu nevojën e përshpejtimit të zbatimit të objektivave të përcaktuara në Strategji dhe theksoi se duhet të bëhen edhe disa përmirësime që lidhen me: (i) Procedurat e vlerësimit të PAK, duke përfshirë edhe vlerësimin e aftësisë dhe mundësitë e tyre për gjithëpërfshirje. Kjo do të kërkonte rishikimin dhe ristrukturimin e komisioneve dhe menyrave të vlerësimit; (ii) Eliminimin e diskriminimit të kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, duke përshpejtuar procesin e rishikimit dhe studimit të legjislacionit të aftësisë së kufizuar, në përputhje me standartet dhe konventat ndërkombëtare, për të mundësuar hartimin e një ligji integral për AK; (iii) Mbulimin më mirë me buxhete të objektivave të Strategjisë dhe
(iv) Nxitjen e strukturave monitoruese për implementimin e SKPAK, krijimin dhe fuqizimin e këtyre strukturave në nivel lokal si dhe fuqizimin e kapaciteteve të strukturave monitoruese.

Së fundi znj. Kospiri shprehu besimin se shoqatat e aftësisë së kufizuar do të vazhdojnë të luajnë rolin e tyre në procesin e monitorimit të zbatimit të SKPAK jo vetëm si oponent ndaj institucioneve por edhe duke ofruar bashkëpunimin, ekspertizën dhe kapacitetet e tyre në këtë proces.

## Konkluzionet e Konferencës së Parë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara

Në mbyllje të Konferencës, ministrat iu përgjigjën pyetjeve të pjesëmarrësve dhe në fund Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z. Koço Barka konkludoi se:

(i) Prezantimet e vunë theksin tek përfshirja e institucioneve në zbatimin e Strategjisë së PAK;

(ii) Objektivat strategjikë për PAK janë bërë pjesë e programit qeveritar në të gjithë sektorët: arsim, shëndetësi, kulturë, infrastrukturë, ndërtim, komunikim, strehim, shërbime sociale etj;

(iii) Njësia e monitorimit, e cila është plotësuar si strukturë e MPÇSSHB, do të mbajë kontakte institucionale me Ministritë e tjera dhe qeverisjen vendore.

(iv) Monitorimi nuk do të ketë sukses pa qarkullim informacioni mes pushtetit qendror dhe vendor dhe pa komunikim funksional mes vetë institucioneve qendore;

(v) Në Konferencë u prezantua Këshilli Kombëtar i PAK, mbledhja e parë e të cilit do të përcaktojë detyrat dhe misionin e tij;

(vi) Bashkëpunimi me shoqërinë civile të përfaqësuar nga vetë organizatat e PAK u theksua si domosdoshmëri për përmbushjen e objektivave të Strategjisë.

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# KUVENDI

# LIGJ

**Nr. 9355, datë 10.03.2005**
**Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore**

Në mbështetje të nenit 78, 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

## KREU I

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.
2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirë-simin e jetesës së tyre.

### Neni 2

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri.

### Neni 3

Parimet bazë, mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, janë:

a) respekti dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;

b) universaliteti;
c) barazia e mundësive;
d) e drejta për të përfituar;
e) partneriteti;
f) trasparenca dhe paanshmëria;
g) decentralizimi;
h) pavarësi, integrim shoqëror dhe pjesë-marrje në jetën e komunitetit;
i) mosdiskriminimi;
j) karakteri subvencionues.

**Neni 4**

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Ndihmë ekonomike" kuptohet mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë.
2. "Pagesë për personat me aftësi të kufizuar" kuptohet pagesa mujore, në lekë, që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të këtij ligji.
3. "Person me aftësi të kufizuar (PAK)" kuptohet individi, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko/mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.
4. "Invalid pune" kuptohen individët që janë deklaruar të tillë me vendim të KMCAP që përfitojnë nga ligji Nr. 7889, dt. 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidëve" i ndryshuar.
5. "Shërbime shoqërore" kuptohet tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore, për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente apo kronike.
6. "Njësi e pushtetit vendor" kuptohet bashkia/ komuna, ku subjektet përfituese, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensimin e të ardhurave materiale ose/dhe monetare, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për shërbime shoqërore.
7. "Administrator shoqëror" kuptohet nëpunësi civil i organeve të pushtetit vendor, i cili administron shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët në nevojë.
8. "Familje", kuptohet një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë.
9. "Familje kujdestare", kuptohet një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 266 të ligjit nr. 9062, dt. 08.05.2003.
10. "Kryetar të familjes", kuptohet personi sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.
11. "Familje të varfra", kuptohen familjet, që nuk kanë të ardhura materiale ose/dhe monetare, ose i kanë të pamjaftueshme, nga veprimtaria ekonomike, programe të tjera të mbrojtjes shoqërore dhe kapitali.
12. "Familje bujqësore" kuptohet familja, që ka në pronësi tokë të punueshme, pavarësisht nga vendndodhja e familjes apo e tokës.
13. "Të ardhura të familjes" kuptohen të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, nga çdo lloj burimi, duke përfshirë dhe ata që përkohësisht jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuara mendore, fizike, të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët, përfitimet e invalidëve

sipas Statusit të Invalidit të Punës, si dhe pagesat për fëmijët e lindur si trinjakë a më shumë.

14. "Jetim" kuptohet fëmija pa prindër, deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në statusin e jetimit.
15. "Shërbime shoqërore në komunitet" kuptohen të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore, publike dhe jopublike, që kryhen në nivel vendor, në territorin, në juridiksionin e bashkisë/komunës.
16. "Person i moshuar" kuptohet personi, që ka arritur moshën e pensionit të pleqërisë, sipas legjislacionit në fuqi.
17. "Vendbanim" kuptohet vendi ku familja ose personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.
18. "Vendqëndrim" kuptohet vendi ku banohet për një kohë të caktuar për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak apo vuajtjeje dënimi, si dhe raste të tjera të kësaj natyre.
19. "Burime jetese" kuptohen të gjitha mjetet monetare ose të ardhurat në natyrë, të cilat bëjnë të mundur jetesën.
20. "Veprimtari ekonomike" kuptohet çdo veprimtari, në formën e punësimit, të vetëpunësimit, të punës që kryhet pa pagesë pranë një anëtari të vetëpunësuar të familjes, si dhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme, që sjell të ardhura për individët dhe familjet e tyre.
21. "Kapital" kuptohet çdo lloj prone/pasurie që mund të sjellë të ardhura.
22. "Veprim i qëllimshëm" kuptohet çdo veprim që synon të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe për mundësi punësimi, trajtimin mjekësor në rastet e përdoruesit të drogës ose të përdoruesit me tepri të alkoolit, mospërdorimin e kapitalit atje ku është mundësia për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, dhënies reale të të ardhurave, si dhe çdo veprim që nxit ndarjen e familjeve, që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë, për përfitim nga ndihma ekonomike.

## KREU II

## PËRFITUESIT E NDIHMËS DHE TË SHËRBIMIT SHOQËROR

### Neni 5

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
2. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari;
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

### Neni 6

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, vajzat në nevojë, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë.

### Neni 7

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

1. Të verbrit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcakti-

mit të Verbërisë (KMPV).

2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë bërë të tillë pavarësisht nga shkaku dhe mosha.
3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, sipas Statusit të invalidit të punës.

**Neni 8**

Personat përfitues që përcaktohen në pikën 1, 2, 3 të nenit 7 të këtij ligji, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

**Neni 9**

**Nga ky ligj nuk përfitojnë:**

1. Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të personave dhe të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtare.
2. Azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilantit.
3. Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave.

**KREU III**

**LLOJET E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**Neni 10**

Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor, në natyrë për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 11**

1. Pagesa për personat me aftësi të kufizuara jepet në formën e një kësti mujor, në lekë. Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Përfituesit e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, të klasifikuar me vendim të komisioneve mjekësore të aftësisë, në grupet e dyta të paaftësisë, humbasin të drejtën e pagesës së aftësisë së kufizuar, në çastin e punësimit të tyre.

**Neni 12**

Shërbimet shoqërore, sipas natyrës, ndahen në:

1. shërbime të përkujdesit shoqëror;
2. shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

### Neni 13

1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë, komuniteteve, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, për plotësimin e nevojave të tyre jetësore.
2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror-mjekësor ofrohen nga personeli i specializuar, në qendra riintegruese dhe rehabilituese rezidenciale, qendra ditore apo në familje, për individët, të cilët nuk janë në gjendje të jetojnë normalisht, për shkak të përkeqësimeve, të përkohshme apo të përhershme, fizike, psikike, mendore dhe sensore.

### Neni 14

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe të funksionimit, janë:

1. shërbime të përkujdesit rezidencial;
2. shërbime të përkujdesit komunitar.

### Neni 15

1. Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit ose përfaqësuesit e tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij.
2. Shërbimet e përkujdesit komunitar ofrohen në qendra ditore, shtëpitë e individëve, apo në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të grupeve përfituese.

### Neni 16

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe shërbime private.

### Neni 17

1. Shërbimet shoqërore publike, përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në institucionet rezidenciale, ditore apo në shtëpi, për grupet në nevojë.
   Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore:
   a) Bashkitë/komunat, administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individë, që janë banorë të atij qyteti apo komune.
   b) Qarku, administron shërbime kur ato ofrohen për individë, që u përkasin disa njësive vendore në atë qark.
2. Shërbimet shoqërore private, përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore a në shtëpi, të financuara privatisht.

### Neni 18

1. Personat juridikë, publikë dhe personat juridikë, privatë, që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, licensohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.
   Kriteret dhe procedurat për licensimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shërbimet shoqërore publike që financo-hen me fondet e buxhetit qendror apo vendor, prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.
3. Organet e pushtetit vendor lidhin kontratë

me personat juridikë, privatë fitues, për shërbimet që ato ofrojnë në juridiksionin e territorit të tyre.

4. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton standardet e shërbimeve shoqërore dhe kontrollon zbatimin e tyre. Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## KREU IV

## KRITERET E PËRFITIMIT DHE PROCEDURA E DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

### Neni 19

Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet në nevojë, është e plotë ose e pjesshme.

1. Ndihmë ekonomike të plotë përfitojnë familjet ose individët, që nuk kanë të ardhura nga:
a) veprimtaria ekonomike;
b) programet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore ose ndonjë sistem tjetër i mbrojtjes shoqërore;
c) kapitali;
ç) pjesëtarët e familjes që janë në emigracion.
2. Ndihma ekonomike është e pjesshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga:
a) toka;
b) bagëtia, shpendët, bletët, vreshtaria e kopshtaria;
c) pensionet dhe të ardhura të tjera.
3. Vlerësimi në koeficient i të ardhurave, të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike, të plotë apo të pjesshme, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 20

1. Ndihma ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar, shpërndahen një herë në muaj me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.
2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të saj. Aplikantët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori shoqëror, pranë njësisë së pushtetit vendor. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesë për personat me aftësi të kufizuara paraqiten te administratori shoqëror, në njësitë e pushtetit vendor. Kriteret për përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror paraqiten te administratori shoqëror, në njësitë e pushtetit vendor. Kriteret e pranimit në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe për shërbimet në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 21

Këshilli i bashkisë/komunës ka të drejtë të miratojë kritere specifike për të dhënë ndihmë ekonomike apo për të ofruar shërbime të përkujdesit me fondet e buxhetit lokal, për familjet me shumë pjesëtarë apo familjet e varfra.

**Neni 22**

Personat, që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pranohen në institucionet rezidenciale, publike, pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shpenzimet e tyre mbulohen nga buxheti i shtetit.

**Neni 23**

1. Personat që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, dhe kanë të ardhura personale, pranohen në institucionet publike të përkujdesit, kundrejt një pagese në raport me të ardhurat e tyre mujore ose të ardhurat e individëve të tjerë përgjegjës. Masa e kontributit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, nuk përfshihet në llogaritjen e të ardhurave personale të personave që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror.
3. Përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror që vendosen në institucionet e përkujdesit, u jepen në dorë një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 24**

Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

**Neni 25**

Aplikuesi, të cilit i refuzohet kërkesa për përfitim të ndihmës ekonomike, pagesë për aftësinë e kufizuar ose të shërbimit shoqëror me vendim të këshillit të njësisë së pushtetit vendor, ka të drejtë për apelim në gjykatë.

**KREU V**

**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMËS SË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**Neni 26**

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion publik në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.
2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ i cili është organi më i lartë vendimmarrës.
4. Funksionet dhe anëtarësia e Këshillit Administrativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet për zbatimin e politikave të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për:

a) programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuara dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror;
b) hartimin e standardeve të shërbimeve dhe propozimin për miratim të shërbimeve të reja;
c) përcaktimin e dokumentacionit unik, të nevojshëm, për aplikuesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji.

### Neni 27

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave, qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat.
2. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ngre Inspektoriatin e Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili kontrollon veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit në strukturat dhe institucio-net në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komunë, si dhe miraton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 26 pika 5 shkronja "c" të këtij ligji.
3. Procedura e kryerjes së kontrollit nga këto inspektoriate përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, arritjen e standardeve për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale grumbullon informacione, statistika dhe raporte nga njësitë e pushtetit vendor. Përmbajtja, periodiciteti dhe treguesit statistikor përcaktohen me VKM.

### Neni 28

Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton dhe paraqet pranë Ministrisë së Financave, nevojat për fonde nga buxheti për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuara dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror.

### Neni 29

Këshilli i bashkisë/komunës ka këto përgjegjësi:

1. Miraton fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.
2. Miraton fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuara.
3. Miraton fondin për shërbimet e përkujdesit shoqëror.
4. Harton planin për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror bazuar në burimet, nevojat dhe prioritetet vendore.
5. Miraton dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit në bazë të vlerësimit të nevojave e prioriteteve vendore.
6. Merr vendime për personat, familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në:
   a) vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve të bëra nga administratori shoqëror;
   b) mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve.
7. Vendos, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të drejtën dhe masën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen, si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta, të parashikuara me ligj.
8. Autorizon strukturat e njësisë së pushtetit vendor të kontraktojnë me ofrues shërbimesh private të licensuara në rastet kur ato shërbime ofrohen nga shërbime shoqërore publike.
9. Me fondet e veta, në bazë të kritereve specifike, mbështet me ndihmë ekonomike, apo forma të tjera ndihme të menjëhershme, familjet e varfra.
10. Miraton programet për kushtëzimin e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet. Kriteret për kushtëzimin e ndihmës me punë e shërbime në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
11. Miraton strukturat e institucione në varësi të

saj që merren me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe realizimin e shërbimeve të përkujdesit në juridiksionin e saj.

12. Miraton programe bashkëpunimi me OJF-të, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

**Neni 30**

Për administrimin e skemës së ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, pranë qarqeve dhe bashkive/ komunave, ngrihen strukturat përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 31**

Administratorët shoqërorë në bashki/komuna kanë për detyrë:

a) të identifikojë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;

b) të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) të propozojë në Këshillin e Bashkisë/ Komunës familjet në nevojë për të përfituar ndihmë ekonomike;

d) të ndihmojë në përgatititjen e dokumentacionit, për personat që aplikojnë për përfitimin e: ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror;

e) të marrë pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, të listës së personave me aftësi të kufizuara dhe personave që do të trajtohen me shërbime të përkujdesit shoqëror;

f) të llogarisë dhe të propozojë për miratim, në seksionin e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të bashkisë/ komunës, masën e ndihmës ekonomike;

g) të hartojnë kërkesën për bllok ndihme dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuara, çdo dymujor për njësinë e pushtetit vendor;

h) të bashkëpunojnë për hartimin e planeve, vendore dhe rajonale, në mbështetje të personave në nevojë;

i) të vlerësojë nevojat e individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, përgatit dokumentacionin dhe propozimet për aprovim në këshillin e bashkisë/ komunës;

j) të grumbullojë dhe të hartojë informacione, statistika, dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuara dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;

k) të grumbullojë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë/komunës.

## KREU VI

## FINANCIMI I NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

### Neni 32

Shteti ofron shërbime të përkujdesit shoqëror dhe forma të tjera të mbështetjes për personat në nevojë, sipas mundësive të buxhetit të shtetit.

### Neni 33

Financimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, përballohet nga buxheti i shtetit dhe buxhetet e pushtetit vendor.

### Neni 34

Burimet e financimit të ndihmës dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar përbëhen nga:

a) Fondet e Buxhetit qendror të shtetit;

b) Fondet nga taksat dhe tarifat vendore.

### Neni 35

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale programon fondet për bllokndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe një herë në dy muaj i transferon ato në bashki ose komunë.
2. Kriteret dhe treguesit, që përdoren për programimin e bllokndihmës, propozohen nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 36

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale delegon një herë në 4 muaj fondin e bllok-ndihmës ekonomike në bashki/komuna, të cilat dhënien e ndihmës ekonomike e kushtëzojnë me punë e shërbime të përkujdesit shoqëror në komunitet.
2. Teprica e fondeve të ndihmës ekonomike, e krijuar si rezultat i menaxhimit më të mirë të bllokndihmës, pas miratimit nga MPÇS, i mbetet njësive vendore. Këto fonde shërbejnë për të mbështetur programe, që zbatohen për punë ose shërbime në komunitet brenda vitit.

### Neni 37

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet, publike dhe jopublike, në nivel qarku ose bashki/komunë, në institucionet rezidenciale, në qendrat ditore, në familje apo shërbime të lëvizshme në komunitet, përbëhen nga:

a) Fondet e deleguara nga Buxheti qendror i shtetit;

b) Fondet e caktuara nga taksat dhe tarifat vendore;

c) Të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe aktivitete të tjera të bashkisë/komunës;

d) Kontributet e përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;

e) Dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizata, persona, fizikë a juridikë, apo individë të tjerë, që nuk përfshihen në shkronjat "a","b","c","d" të këtij neni.

### Neni 38

Fondet nga Buxheti qendror për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, delegohen nga MPÇS në bashki/komunë, qark që në fillim të vitit,

në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e buxhetit të shtetit. Metodologjia e llogaritjes dhe e shpërndarjes së këtyre fondeve, përcaktohet nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 39**

Për mbështetjen e shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale, MPÇS krijon Fondin Shoqëror, i cili përbëhet nga:

a) një pjesë e fondeve të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror;
b) Financime jashtëbuxhetore nga organizata, persona, fizikë a juridikë, apo individë të tjerë;
c) të ardhurat e tjera, që sigurohen nga zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, që Republika e Shqipërisë lidh me shtetet e tjera;
ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron MPÇS.

Rregullat e përdorimit të Fondit Shoqëror, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 40**

Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror bëhet nga organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me ligjin "Për auditimin e brendshëm dhe kontrollin financiar".

**KREU VII**

**Neni 41**

**Sanksionet**

Çdo shkelje e këtij ligji dhe e akteve nënligjore në zbatim të tij quhet kundërvajtje adminis-trative, në mbështetje të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993, "Për kundërvajtjet administrative".

**Neni 42**

Dispozitat kalimtare

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton programin e kalimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor.
2. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton dhe ndjek procedurat e trasferimit të shërbimeve shoqërore dhe kalimin e institucioneve në varësi të qeverisjes vendore, duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2007.
3. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale merr masat për trasferimin e fondeve për të gjitha institucionet që trasferohen në varësi të qeverisjes vendore.
4. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale krijon Inspektoriatin e Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore brenda vitit 2006.
5. Qarqet, bashkitë ose komunat ngarkohen të krijojnë e të plotësojnë strukturat për administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, sipas nevojave, brenda vitit 2006.

### Neni 43

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 10, 11, 18, 19, 20, 23, 26, 27, 29, 30, 35, 38 dhe 39 të këtij ligji.

### Neni 44

Ligji nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", i ndryshuar, vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij dhe neni 2 i ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" shfuqizohen.

### Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Servet PËLLUMBI**

# Falenderim

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, Planit Kombëtar të Veprimit, si dhe gjithë dokumentacionit mbështetës që përbën këtë publikim, është mbështetur mbi kontributin e një numri të madh individësh, institucionesh shtetërore, grupesh dhe organizatash të shoqërisë civile të cilët i falënderojmë përzemërsisht për angazhimin, ndihmesën dhe pjesëmarrjen e tyre:

Nexhmedin Dumani, Natasha Pepivani, Etleva Murati, Anila Selmani, Raina Kovaçi, Lolita Hoxha, Loreta Çollaku, Anola Shala, Maksim Bozo, Fatmir Bezati, Xhelil Cibaku, Shpresa Leka, Genci Lubonja, Margarita Çaçi, Daklea Shtylla, Bardhylka Kospiri, Ndrek Ismajli, Sinan Tafaj, Abdulla Omuri, Flora Kalemi, Nasi Duka, Aferdita Seiti, Vera Minga, Merita Myftari, Rajmonda Prifti, Vera Paja, Mimoza Ceca, Artan Muca, Muharrem Mullaj, Zela Koka, Ismail Hysenllari, Tasim Kullolli, Engjellushe Bejtja, Eduart Ajazi, Albana Dimraj, Nikoleta Spahi, Llazar Dako, Shqipe Zekthi, Majlinda Brahaj.

Mbështetje dhe konsulencë për dokumentin e Strategjisë Kombëtare të PAK:

Zyra e Komisionerit të Lartë Federal për Çështje të Personave me Aftësi të Kufizuara, Ministria Federale e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Republika Federale e Gjermanisë: Karl-Hermann Haack, Ulrike Geith

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri: Caroline Milow, Elton Lelo, Karin Fällman, Rezart Xhelo